



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 427 Akti

Nr. 606 Vendimi  
Tiranë, më 21.12.2022

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Etleda Çiftja</b>	Kryesuese
<b>Roland Ilia</b>	Relator
<b>Pamela Qirko</b>	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Amela Idrizi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Willem Brouwer, në datën 5.12.2022, ora 11:30, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Znj. Mariola Mërtiri**, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, e ndryshuar;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2012**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

**TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoji relatorin e çështjes, komisionerin Roland Ilia, dëgjoji subjektin e rivlerësimit, vëzhguesin ndërkombëtar, pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Mariola Mërtiri, e cila në seancën dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë,

## V Ë R E N:

### I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në paragrafin 5 të nenit 179/b të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në pikën 5 të nenit 3 dhe në pikën 1 të nenit 5 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
2. Subjekti i rivlerësimit Mariola Mërtiri, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është subjekt i rivlerësimit që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio* në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) ka hedhur shortin në muajin dhjetor të vitit 2019, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit Mariola Mërtiri do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 1, i përbërë nga komisionerët Pamela Qirko, Roland Ilia dhe Etleda Çiftja.
4. Për këtë subjekt rivlerësimi u caktua me mirëkuptim kryesuese e trupit gjykues komisionere Etleda Çiftja, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit.
5. Në referim të pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit Mariola Mërtiri nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.
6. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016 dhe, veçanërisht, në nenin 30 të këtij ligji, kishte për objekt të vlerësimit deklarin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.
7. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK); dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP). Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.
8. Në përputhje me nenet 30-33 të ligjit nr. 84/2016 u administrua akti i kontrollit me nr. \*\*\* prot., datë 18.10.2018, i ILDKPKI-së, protokolluar pranë Komisionit me nr. \*\*\* prot., datë 25.11.2018, ku është kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit.
9. DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport për subjektin e rivlerësimit, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 24.1.2022 (deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. \*\*\* , datë 21.1.2022, të KDZH-së), në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

**10.** KLP-ja ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në të dhënat e rezultuara nga tri dokumentet ligjore të përzgjedhura nga subjekti, pesë dokumentet ligjore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe nga të dhënat arkivore të këtij Këshilli. Raporti nr. \*\*\* prot., datë 9.5.2022, i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, është protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 13.5.2022.

**11.** Në vijim, relatori i çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm për të tria kriteret e vlerësimit: të pasurisë, të kontrollit të figurës; si dhe të aftësive profesionale.

**12.** Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për të tria kriteret e vlerësimit – vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale – në datën 1.11.2022 vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për të tria kriteret e vlerësimit për subjektin e rivlerësimit Mariola Mërtiri; (ii) njoftimin e subjektit për t’u njohur me materialet e dosjes; si dhe (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

**13.** Subjekti i rivlerësimit u njoftua në datën 1.11.2022 mbi të drejtën e saj për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti, pasi u njoh me aktet e dosjes, ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja deri më 25.11.2022.

**14.** Subjekti i rivlerësimit, pasi u njoh me dosjen dhe ka marrë një kopje të saj, ka dërguar shpjegimet në rrugë zyrtare. Për dhënien e përgjigjeve subjekti kërkoi kohë, e cila iu akordua nga Komisioni. Shpjegimet e subjektit u paraqitën pranë Komisionit në datën 25.11.2022. Trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim shpjegimet e paraqitura dhe provat mbështetëse mbi rezultatet e hetimit në datën 30.11.2022, vendosi të ftojë znj. Mariola Mërtiri në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

**15.** Subjekti i rivlerësimit Mariola Mërtiri u ftua në seancën dëgjimore të datës 5.12.2022, me njoftimin e bërë në rrugë elektronike.

**15.1** Seanca dëgjimore me subjektin u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në datën 5.12.2022, ora 11:30.

**15.2** Seanca e dytë dëgjimore ishte planifikuar të zhvillohej në datën 7.12.2022. Trupi gjykues, në mbledhjen e datës 6.12.2022, vendosi riçeljen e hetimit administrativ dhe njoftimin e subjektit të rivlerësimit Mariola Mërtiri. Subjekti u njoftua me *email*-in e datës 6.12.2022.

**16.** Seanca e radhës me subjektin u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 21.12.2022, ora 9:50, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar.

**17.** Subjekti i rivlerësimit mori kohën e kërkuar për të shprehur dhe për të parashtruar shpjegimet dhe opinionet e saj në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer. Në përfundim të shpjegimeve dhe të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit Mariola Mërtiri kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

### III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

18. Znj. Mariola Mërtiri ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj, duke u përgjigjur, kur është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ ka zbatuar afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur i janë kërkuar. Subjekti ka qenë korrekte dhe e gatshme për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

### IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

19. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues që mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

20. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016 kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

20.1 Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

20.2 Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

20.3 Ndërsa, sipas kreut VI të ligjit nr. 84/2016, parashikohet objekti i rivlerësimit të aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

21. Referuar vendimit nr. 2/2017<sup>1</sup> të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

22. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* dhe deklaratat periodike vjetore të dorëzuara ndër vite nga subjekti në ILDKPKI;

---

<sup>1</sup>“41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: ‘Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit’. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se: ‘Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë’. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

- ç) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- d) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja;
- dh) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLP-ja;
- e) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të depozituar nëpërmjet postës elektronike, si dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit;
- ë) gjetjet e vëzhguesit ndërkombëtar.

## **A. VLERËSIMI I PASURISË**

**23.** Bazuar në ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave ka paraqitur pranë Komisionit raportin e vlerësimit për subjektin Mariola Mërtiri.

**24.** Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja, në përputhje me pikën 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, është konstatuar se:

- deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- nuk ka kryer deklarim të rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

**25.** Znj. Mariola Mërtiri është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2008, me nr. indeksi \*\*\* dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, ka dorëzuar ndër vite deklaratat e interesave private, si vijon:

- para fillimit të detyrës 2008;
- periodike/vjetore për vitet 2008 - 2017;
- deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, për efekt të ligjit nr. 84/2016.

### **A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni**

**26.** Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) provat shkresore/dokumentet të/e administruara nga organet publike dhe private në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (ç) deklarinimet e subjektit me anë të komunikimit elektronik; si dhe (d) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit.

**27.** Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni nisi shqyrtimin e deklarinimeve të interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë te ky institucion, duke i krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit Mariola Mërtiri, pas:

- a) shqyrtimit të të dhënave të deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, me nr. indeksi \*\*\*, për subjektin e rivlerësimit;

- b) krahasimit të deklaratave të pasurive të dorëzuara në ILDKPKI për periudhën 2008 – 2016, në raport me të dhënat në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*;
- c) shqyrtimit të të dhënave nga të gjitha bankat e nivelit të dytë, institucionet financiare dhe jofinanciare, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, organet tatimore, organet e tjera shtetërore, personat juridikë, individët, si dhe likuiditeteve - gjendje *cash*;
- ç) hetimit të kryer lidhur me të dhënat e vetëdeklaruara nga subjekti gjatë plotësimit të pyetësorëve të dërguar nga Komisioni.

**Në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, të dorëzuar pranë ILDKPKI-së, subjekti i rivlerësimit Mariola Mërtiri dhe personat e lidhur kanë deklaruar pasuritë si vijojnë:**

### **1. Apartament banimi**

**1.1** Subjekti ka deklaruar apartament në bashkëpronësi me sipërfaqe ndërtimore 83.88 m<sup>2</sup>, i ndodhur në lagjen “\*\*\*”, Fier, i përfituar sipas kontratës noteriale datë 24.6.2011, në vlerën 4,500,000 lekë.

**1.2** Lidhur me likuidimin dhe burimin e kësaj pasurie, subjekti ka deklaruar se: *“Kësti i parë për blerjen e këtij apartamenti në vlerën 2,260,000 lekë është likuiduar në datën 24.6.2011, nga të cilat 1,000,000 lekë i janë dhuruar bashkëshortit tim nga vëllai M.M dhe shuma tjetër prej 1,260,000 lekësh është dhuruar nga vjehri im (T.M) nga kursimet e tij nga puna dhe emigracioni.*

*Kësti i dytë prej 2,240,000 lekësh është likuiduar në datën 2.8.2011 në momentin që është mundësuar kredia nga ‘Banka Kombëtare Tregtare’, dega Fier.*

*Në lidhje me dhurimin e lekëve që na janë bërë nga vjehri dhe kunati im (përkatësisht T dhe M.M), fakti konfirmohet prej tyre në deklaratat noteriale të lëshuara prej tyre”.*

**1.3** Më tej, në deklaratën *Vetting*, subjekti ka shpjeguar se: *“Si burim krijimi të të ardhurave nga vjehri janë të ardhura të tij si kursime familjare dhe nga emigracioni për vitet 1992 - 1998 në shtetin grek. Po ashtu të ardhura dhe nga punësimi në blegtori në rrethin e Gjirokastrës e në transportin e udhëtarëve. Periudhë punësimi informale.*

*Në lidhje me këtë është bashkëlidhur kontrata e huas e datës 26.11.1994, nga ku rezulton se shtetasi T.M (vjehri im) i jep hua shtetasit F.L shumë prej 960,000 lekësh. Për të provuar shërbimin e transportit të udhëtarëve, si dhe të ardhurat që vjehri T.M ka pasur, paraqes kontratën e shitblerjes së mjetit furgon, me nr. \*\*\*, datë 17.11.1999, të noter Z.B, nga ku vjehri T.M blen nga shtetasi A.K makinën tip ‘\*\*\*’, i llojit mikrobus, në vlerën 2,000,000 lekë.*

*Si burim krijimi i shumës 1,000,000 lekë që bashkëshortit tim E.M i është dhuruar nga vëllai i tij M.M janë të ardhura që rrjedhin nga paga e biznesi i tij. Në lidhje me këtë po ju paraqesim një kontratë shitjeje të kuotave të shoqërisë ‘\*\*\*’ sh.p.k.”.*

**1.4** Për të provuar deklaratimet e saj, subjekti ka paraqitur dokumentacion:

- Certifikatë për vërtetim pronësie me datë 24.5.2012, për pasurinë apartament, regjistruar me nr. \*\*\*, sip. 83.88 m<sup>2</sup>, në lagjen “\*\*\*”, Fier. Pasuria është në emër të shtetasve E.M dhe Mariola Mërtiri.
- Kontratë shitblerjeje (pasuri e paluajtshme) nr. \*\*\*, datë 17.4.2012, nënshkruar ndërmjet palës shitëse M.G dhe E.G, përfaqësuar me prokurë nga shtetasi V.Z dhe palës blerëse E.M, të një apartamenti me sip. 83.88 m<sup>2</sup>, në lagjen “\*\*\*”, Fier, kundrejt vlerës 4,500,000 lekë. Kjo vlerë është likuiduar tërësisht jashtë zyrës noteriale nëpërmjet bankës.
- Kontratë shitjeje sendi në të ardhmen, me nr. \*\*\*, datë 24.6.2011, nënshkruar ndërmjet palës shitëse të ardhshme E.B dhe palës blerëse të ardhshme E.M, të një apartamenti me

sip. 95 m<sup>2</sup>, kundrejt vlerës 4,500,000 lekë. Kësti i parë prej 2,260,000 lekësh është shlyer ditën e nënshkrimit të kësaj kontrate jashtë zyrës noteriale. Kësti i dytë prej 2,240,000 lekë do të likuidohet kur të mundësohet marrja e një kredie bankare nga shtetasi E. M pranë BKT-së.

### **Hetimi i kryer nga Komisioni**

**1.5** Subjekti e ka deklaruar këtë pasuri edhe në DPV/2011 dhe si burim për këstin e parë ka deklaruar dy dhurimet e marra dhe për këstin e dytë kredinë nga BKT-ja. Subjekti ka bërë deklarata të njëjta si në DPV/2011 ashtu edhe në deklaratën *Vetting*, lidhur me vlerën, këstet dhe burimin e krijimit të kësaj pasurie.

**1.6** ZVRPP-ja Fier, me shkresën datës 9.10.2017<sup>2</sup>, konfirmon se në emër të shtetasve Mariola Mërtiri dhe E.M figuron pasuria nr. \*\*\*, e llojit “apartament”, me sip. 83.88 m<sup>2</sup>.

**1.7** Kjo pasuri rezultoi se është fituar me kontratë shitblerjeje (pasuri e paluajtshme) nr. \*\*\*, datë 17.4.2012, nënshkruar ndërmjet palës shitëse M.G e E.G, përfaqësuar me prokurë nga shtetasi V.Z dhe palës blerëse E.M, kundrejt vlerës 4,500,000 lekë.

**1.8** Për objektin ku ndodhet pasuria e blerë nga subjekti i rivlerësimit figuron leje ndërtimi nr. \*\*\*\*, datë 27.2.2006, me subjekt ndërtues “\*\*\*\*” sh.p.k., për shtetasit M. G, M.N, J.S, N e A.L, si dhe vendimin nr. \*\*\*, datë 28.12.2005, të KRT Bashkia Fier, me objekt “2 godina, 2 kate, 8 kate, 10 kate, ½ kate, bodrum”. Dokumentacioni i paraqitur dhe i administruar për ndërtimin e objektit përmban: blerjen e truallit datë 28.6.2007, nga shtetasi E.B tek shtetasit M.G dhe M.N; kontratën e sipërmarrjes datë 9.7.2007, nënshkruar ndërmjet palës investitore E.B dhe palës pronare të truallit familja “\*\*\*\*”, në të cilën janë përcaktuar ndarjet e apartamenteve të banimit; si dhe kontratën e shkëmbimit datë 16.2.2012.

**1.9** Fillimisht për këtë pasuri është lidhur një kontratë me kusht “Shitje sendi në të ardhmen” nr. \*\*\*, datë 24.6.2011, dhe më pas është hartuar kontrata e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 17.4.2012. Bazuar në këtë kontratë me kusht rezultoi se kësti i parë prej 2,260,000 lekësh është shlyer ditën e nënshkrimit të kësaj kontrate.

**1.10** Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar se: “*Nga muaji dhjetor 2011 deri në qershor 2016 vendbanimi ka qenë në lagjen “\*\*\*\*”, shkalla \*\*\*, kati \*\*\*, ap. \*\*\*, Fier. Apartament i blerë nga ana e subjektit dhe e bashkëshortit sipas kontratës noteriale nr. \*\*\*, datë 17.4.2012 (porositur në datën 24.6.2011, sipas kontratës nr. \*\*\*, datë 24.6.2011).*

*Me kontratën noteriale nr. \*\*\*, datë 24.6.2011, kam prenotuar blerjen e një sendi në të ardhmen, ndërkohë finalizimi i blerjes së apartamentit është kryer në vitin 2012. Konkretisht, apartamenti me sip. 83.88 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe të përbashkët 6.40 m<sup>2</sup>, në vlerën 4,500,000 lekë. Si burim financiar për likuidimin e këtij apartamenti ka shërbyer: dhuratë, në vlerën 1,260,000 – bashkëshortit nga babai i tij (T.M); dhuratë në vlerën 1,000,000 – bashkëshortit nga vëllai i tij (M.M). Shuma prej 2,260,000 lekësh i është paguar z. E.B në datën 24.6.2011, me lidhjen e kontratës së blerjes së një sendi në të ardhmen (bashkëlidhur kontratën për shitjen e një sendi në të ardhmen)”.*

**1.11** Për dhurimet e përfituara nga subjekti rezultuan dy deklarata noteriale, dhe konkretisht:

- a. deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 7.7.2012, nga shtetasi M.M, i cili deklaroi se i ka dhuruar pa kundërshtim vëllait të tij E.M shumën 1,000,000 lekë në prill të vitit 2011, jashtë zyrës noteriale, me qëllim blerjen e një apartamenti në qytetin e Fierit – të ardhurat kanë si burim biznesin e shtetasit M.M;

---

<sup>2</sup>Shihni përgjigjen e ZVRPP-së Fier në dosjen e ILDKPKI-së.

- b. deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 13.9.2012, nënshkruar nga shtetasi T.M, ku deklarohet se në prill të vitit 2011 i ka dhuruar djalit të tij shumën 1,260,000 lekë, me qëllim plotësimit e vlerës që i nevojitet për blerjen e apartamentit të ndodhur në lagjen “\*\*\*\*”, Fier.

**1.12** Komisioni hetoi lidhur me pagimin e kështit të parë për blerjen e kësaj pasurie, burimin e krijimit dhe mundësitë financiare të dhuruesve. Sipas deklaratimit të subjektit kështit i parë prej 2,260,000 lekësh është likuiduar në datën 24.6.2011, nga të cilat 1,000,000 lekë janë dhuruar nga vëllai i bashkëshortit M.M dhe shuma tjetër është dhuruar nga vjehri T.M.

**1.13** Lidhur me mundësitë e dhuruesit M.M të shumës prej 1,000,000 lekësh deri në datën 24.6.2011, u krye një hetim bazuar në përcaktimet e nenit 32/4, si person me cilësinë e dhuruesit. Ligji i sipërpërmendur kërkon që këto kategori subjektsh (në rastin në fjalë dhurues) kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.

- QKB-ja, me shkresën e datës 7.8.2017<sup>3</sup>, konfirmon aktivitetet në emër të shtetasit M.M dhe ka bashkëlidhur ekstraktet historike, për sa vijon:

- 1) shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., pajisur me NIPT \*\*\*, M.M (atësia nuk mund të verifikohet), figuron ortak me 25% të kuotave;
- 2) shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., pajisur me NIPT \*\*\*, figuron ortak me 100% të kuotave;
- 3) shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., pajisur me NIPT \*\*\*, M.M (atësia nuk mund të verifikohet), figuron ortak me 20% të kuotave;
- 4) shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., pajisur me NIPT \*\*\*, M.M (atësia nuk mund të verifikohet), figuron ortak me 16% të kuotave;
- 5) shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., pajisur me NIPT \*\*\*, M.M (atësia nuk mund të verifikohet), figuron ortak me 100% të kuotave;
- 6) shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., pajisur me NIPT \*\*\*, M.M (atësia nuk mund të verifikohet), figuron ortak me 33% të kuotave;
- 7) shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., pajisur me NIPT \*\*\*, M.M (atësia nuk mund të verifikohet), figuron administrator;
- 8) shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., pajisur me NIPT \*\*\*, M.M (atësia nuk mund të verifikohet), figuron ortak me 20% të kuotave prej datës 2.4.2009 dhe është larguar në datën 19.5.2010;
- 9) shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., pajisur me NIPT \*\*\*, M.M (atësia nuk mund të verifikohet), figuron ortak me 100% të kuotave prej datës 25.9.2008 dhe është larguar në datën 25.2.2010;
- 10) shoqëria “\*\*\*\*” sh.a., regjistruar me vendim gjykate nr. \*\*\*, datë 14.5.2004, figuron ortak me 40% të kuotave.

**1.14** DPT-ja, me shkresën e datës 3.8.2017<sup>4</sup>, konfirmon aktivitetet të regjistruara pranë DRT-së Tiranë në emër të shtetasit M.M, me NIPT \*\*\*, \*\*\* dhe \*\*\*. Për informacione të mëtejshme, DPT-ja i është drejtuar Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, në të cilën ndodhen dosjet përkatëse. DRT Tiranë, me shkresën e datës 16.8.2017, konfirmon se shtetasi M.T.M është i regjistruar si tatimpagues në datën 7.11.2013 në DRT Tiranë, me NIPT \*\*\*.

**1.15** Në përgjigje të pyetësorit nr. \*\*\*, subjekti ka deklaruar se vëllai i bashkëshortit dhe bashkëjetuesja e tij (znj. S. G) kanë lidhur martesë në kishë në vitin 2007, ndërkohë që bashkëjetojnë prej vitit 2004. Kjo për të sqaruar se pjesë e burimit të të ardhurave në shumën e dhuruar janë edhe të ardhurat e realizuara nga punësimi dhe biznesi nga znj. S.G. Më tej subjekti ka renditur burimet e krijimit të shumës së dhuruar prej 1,000,000 lekësh<sup>5</sup>, si vijon:

<sup>3</sup>Shihni përgjigjen e QKB-së në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>4</sup>Shihni përgjigjen e DPT-së në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>5</sup>Shihni përgjigjen e subjektit dhe dokumentacionin shkresor të paraqitur në përgjigje të pyetësorit nr. \*\*\*.



- punësimi në shoqërinë “\*\*\*\*”, viti 2004;
- punësimi në shoqërinë “\*\*\*\*” prej vitit 2005 deri në dhjetor 2010;
- të ardhura të realizuara nga shitja e kuotave të shoqërisë “\*\*\*\*” (S. G);
- të ardhura të realizuara nga punësimi i znj. S. G.

**1.16** Komisioni hartoi analizën financiare lidhur me mundësitë e dhurimit të shumës prej 1,000,000 lekësh nga shtetasi M.M. Bazuar në analizën financiare dhe të ardhurat e deklaruara nga subjekti, dukej se personi tjetër i lidhur M.M nuk ka pasur mundësi financiare për dhurimin e shumës 1,000,000 lekë subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj, mbulimin e shpenzimeve të jetesës dhe investimeve në kapitalin e shoqërive “\*\*\*\*” dhe “\*\*\*\*”.

**1.17** Në analizën financiare janë përfshirë të ardhurat nga punësimi të shtetasve M.M dhe S.G që nga viti 2004, sipas vërtetimeve mbi bazën e vlerësueshme për pagat e tyre nga Drejtoria e Arkivit Qendror.

- Në analizën financiare nuk janë përfshirë të ardhurat nga shitja e aksioneve të shtetasve S.G tek shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. në vitet 2007 dhe 2008, pasi nuk është vërtetuar burimi i ligjshëm i krijimit të këtyre aksioneve.
- Shpenzimet e jetesës janë llogaritur për dy persona deri në lindjen e fëmijës së shtetasit M.M (në vitin 2008) dhe më pas këto shpenzime janë llogaritur për 3 persona.
- Në analizë financiare janë përfshirë edhe shpenzimet për blerjen e aksioneve nga shtetasi M.M në vlerën 4,000,000 lekë në “\*\*\*\*” dhe 6,000,000 lekë në shoqërinë “\*\*\*\*”<sup>6</sup>.

**1.18** Lidhur me mundësitë e dhuruesit T.M të shumës prej 1,260,000 lekësh deri në datën 24.6.2011, u krye një hetim bazuar në përcaktimet e nenit 32/4, si person me cilësinë e dhuruesit. Ligji i sipërpërmendur kërkon që këto kategori subjektësh (në rastin në fjalë dhurues) kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.

**1.19** Për të provuar mundësitë e dhuruesit, subjekti ka paraqitur:

- Deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 3.2.2016, nga ku shtetasi T.M deklaroi se ka përfituar të ardhura nga emigracioni i paligjshëm në Greqi në vitet 1992 – 1998, në shumën 6,000,000 lekë deri në 7,000,000 lekë. Në vitin 1999 ka blerë një automjet furgon me të cilin ka punuar si transportues udhëtarësh deri në vitin 2009 (punësim informal). Gjatë kësaj periudhe ka punuar së bashku me djalin E.M dhe të ardhurat kanë qenë të përbashkëta. Një pjesë e të ardhurave të siguruar nga ky aktivitet janë përdorur nga djali E.M për çeljen e aktivitetit të tij tregtar “\*\*\*\*”.
- Kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 17.11.1999, nënshkruar ndërmjet palës shitëse A. K dhe palës blerëse T.M, të një automjeti mikrobus, kundrejt vlerës 2,000,000 lekë.
- Kontratë huaje, nënshkruar në datën 26.11.1994, ndërmjet palës huadhënëse T.M dhe palës huamarrëse F.L, të shumës 960,000 lekë, me afat kthimi 1 vit dhe me kusht përfitimin mujor të shumës 30,000 lekë nga huamarrësi.

**1.20** Në përgjigje të pyetësorit nr. \*\*\*<sup>7</sup> subjekti ka deklaruar se burim për dhurimin e babait të bashkëshortit (T.M) kanë shërbyer kursimet familjare të përbëra nga:

- të ardhurat nga emigracioni (në pamundësi objektive për të siguruar dokumentacion);
- kthimi i vlerës së huas nga shtetasi F. L. në vitin 2009, sipas kontratës së huas;
- të ardhura nga dhënia me qira e mjetit autobus për periudhën 2002 – 2007;
- të ardhura nga punësimi i vjehrrit pranë shoqërive “\*\*\*\*”, “\*\*\*\*” dhe \*\*\*;

<sup>6</sup>Shihni gjetjet e vëzhguesit ndërkombëtar të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, të datës 6.10.2022.

<sup>7</sup>Shihni përgjigjen e subjektit të datës 2.11.2021.

- të ardhura nga punësimi i vjehrrës (mësuese);
- të ardhura të realizuara nga blegtoria prej vitit 2008;
- të ardhura të realizuara nga shitja e automjetit autobus në vlerën 250,000 lekë në vitin 2007.

**1.21** Komisioni hartoi analizën financiare lidhur me mundësitë e dhurimit të shumës prej 1,000,000 lekësh nga shtetasi T.M. Bazuar në analizën financiare dukej se personi tjetër i lidhur T.M nuk ka pasur mundësi financiare për dhurimin e shumës prej 1,260,000 lekësh subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj, mbulimin e shpenzimeve të jetesës dhe investimit në kapitalin e “\*\*\*”.

**1.22** Analiza financiare e hartuar nga Komisioni u bazua:

- Të ardhurat nga punësimi i shtetasve T dhe A.M që nga viti 2004, të cilat janë përfshirë në analizën financiare sipas vërtetimeve të pagave të sjella nga organet e Sigurimeve Shoqërore.
- Të ardhurat nga qiraja e autobusit në pronësi asokohe të shtetasit T.M, të cilat janë përfshirë në analizën e mësipërme. Sipas vërtetimit nga DPT-ja me nr. \*\*\* prot., të datës 13.2.2020, provohet pagesa e tatimit mbi qiranë vetëm për vitet 2004 - 2005, por nuk provohet në vitet pasuese deri në vitin 2007.
- Nga dokumentacioni tatimor i paraqitur nga subjekti në përgjigje pyetësori, duket se mes qiradhënësit T.M dhe shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k. vërtetohet marrëdhënia e qirasë lidhur me automjetin me targa FR \*\*\*, me kontratë fillestare të cituar me nr. \*\*\*, datë 19.11.2002.
- Gjithashtu, nga organet tatimore paraqitet edhe kontrata nr. \*\*\*, datë 21.3.2006, me të njëjtin objekt kontrate, ku qiraja mujore është 10,000 lekë/muaj.
- Sipas gjithë informacionit tatimor të paraqitur, shoqëria “\*\*\*” sh.p.k. ka qenë pagues i rregullt i të gjithë detyrimeve tatimore për gjithë periudhën në shqyrtim.
- Bazuar në përgjigjen e DPT-së, Drejtoria Ligjore dhe Teknike, Sektori Teknik, me nr. \*\*\* prot., datë 6.4.2018: *“Në rastin e kontratave të qiradhënies ndërmjet një individi dhe një personi të tatueshëm të regjistruar në një nga mënyrat e parashikuara ligjore (QKB, gjykatë, Tatime) dhe i pajisur me numër identifikimi të subjektit të tatueshëm (NIPT), detyrimin për llogaritjen, deklarimin dhe pagimin në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 8438 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, e ka ky i fundit, por shuma e tatimit do të mbahet nga të ardhurat bruto që përfiton individi sipas përcaktimit ligjor në nenin 8 të po këtij ligji”.*
- Meqenëse sipas ligjit agent tatimor në kontratat e qiradhënies është qiramarrësi person juridik, atëherë detyrimin për derdhjen e këtij tatimi ishte mbi palën qiramarrëse (shoqëria “\*\*\*” sh.p.k.) dhe jo mbi qiradhënësin T.M. Prandaj në analizën financiare janë përfshirë të dhënat nga kjo marrëdhënie qiraje nga viti 2004 deri në tetor të vitit 2007, pasi në nëntor të këtij viti shtetasi T. M e ka shitur automjetin në fjalë.
- Të ardhurat nga shitja e autobusit me targa FR \*\*\* në vitin 2007 nga shtetasi T.M, sipas kontratës së shitjes së automjetit nr. \*\*\*, datë 6.11.2007, janë përfshirë në analizën financiare.
- Të ardhurat nga emigracioni nuk janë përfshirë në analizën financiare, pasi nuk provohet burimi i ligjshëm i tyre.
- Të ardhurat në vlerën prej 960,000 nga shtetasi T. M nuk janë përfshirë në analizën financiare, pasi nuk provohet kthimi i huas së shtetasit F.L në vitin 2009, bazuar në prova shkresore të periudhës përkatëse apo ndonjë veprimi bankar.

- Të ardhurat nga aktiviteti blegtoral nuk janë përfshirë në analizën financiare, pasi nuk provohet vlera e tyre të fituara ndër vite nga vjehri i subjektit. Në përgjigje të pyetësorit nr. \*\*\*, subjekti ka paraqitur vërtetimin nr. \*\*\* prot., datë 13.2.2020, nga \*\*\*, i cili vërteton se shtetasi T.K.M me kod ferme \*\*\*, ka fermë blegtorale dhe ushtron aktivitetin e regjistruar në sistemin Ruda me \*\*\* Vlorë, me 250 krerë të leshta, me adresë: rrethi Gjirokastër, Njësia Administrative L, fshati E.

**1.23** Gjithashtu, në analizën financiare më sipër nuk është përfshirë vlera e blerjes së truallit dhe pasuria objekt ndërtimor i shtetasit T.M në qytetin e Fierit, pasuri të cilat janë vënë si kolateral /hipotekë në kredinë e marrë në bankë nga subjekti dhe bashkëshorti i saj. Për këtë iu kërkua subjektit që të paraqesë dhe të provojë me dokumentacion vlerën e blerjes së truallit, vitin dhe shpenzimet e ndërtimit të objektit ndërtimor nga personi tjetër i lidhur T. M.

**1.24** Lidhur me burimin e krijimit të këstit të dytë për blerjen e kësaj pasurie rezultoi:

- Kësti i dytë prej 2,240,000 lekësh është likuiduar në datën 2.8.2011, duke përdorur si burim kredinë e marrë nga “Banka Kombëtare Tregtare”, dega Fier.
- Kontrata e kredisë bankare nr. \*\*\*, datë 2.8.2011, është nënshkruar ndërmjet BKT-së dhe kredimarrësve E.M dhe M.M. Vlera e kredisë së akorduar është 2,240,000 lekë.
- Dorëzanës rezultuan prindërit e bashkëshortit të subjektit T.M dhe A.M. Kredimarrësit dhe dorëzanësit sigurojnë bankën me anë të garancisë së vendosur mbi pasurinë “truall + ndërtesë” me sipërfaqe totale 419.5 m<sup>2</sup>, nga kjo ndërtesë me sip. 128.7 m<sup>2</sup>, regjistruar me nr. \*\*\*, Fier, në emër të shtetasit T.M.
- Dorëzanësit garantojnë bankën pa rezerva deri në momentin e kalimit të titullit të pronësisë për pronën objekt kreditimi “apartament me sip. 95 m<sup>2</sup>” në emër të blerësit E.M, sipas kontratës shitje sendi në të ardhmen me nr. \*\*\*, datë 24.6.2011.
- Kontrata e hipotekimit nr. \*\*\*, datë 2.8.2011, është nënshkruar ndërmjet hipotekuesve T.M dhe A. M dhe kreditorit BKT, për pasurinë “truall + ndërtesë” me sipërfaqe totale 419.5 m<sup>2</sup>, regjistruar me nr. \*\*\*, Fier, në emër të shtetasit T.M. Bashkëlidhur certifikata për vërtetim pronësie datë 13.6.2011 dhe kartela e pasurisë në emër të shtetasit T. M.
- Nxjerrje llogarie e shtetasit E.M pranë BKT-së, në të cilën evidentohet disbursimi i kredisë në datën 24.8.2011, në vlerën 2,217,600 lekë dhe transferimi në datën 25.8.2011 i shumës 2,207,800 lekë në favor të shtetasit E. B, për “likuidim blerje apartamenti”.
- Lëvizjet e llogarisë në emër të shtetasit T.Më pranë BKT-së, për periudhën 1.1.2011 – 3.6.2011.

**1.25** Komisioni konstatoi përfitimin nga subjekti dhe bashkëshorti të një kredie bankare me terma lehtësuese, kredi e cila ka shërbyer për blerjen e pasurisë apartament në qytetin e Fierit. Për të vlerësuar mënyrën e përfitimit të kredisë dhe plotësimin e kriterëve ligjore për marrjen së saj u pyet subjekti i rivlerësimit.

**1.26** Në përgjigje të pyetësorit<sup>8</sup>, subjekti deklaroi: *“Në datën 2.8.2011 është lidhur kontrata e kredisë bankare me palë E.M dhe Mariola Mërtiri, në cilësinë e kredimarrësit, ‘Bankës Kombëtare Tregtare’ në cilësinë e kredihënësit, me objekt kreditimin në shumën 2,240,000 lekë sipas objektit referuar në aneksin e çeljes dhe përdorimit të kredisë, bashkëlidhur kontratës.*

*Në kohën e përfitimit të kredisë lehtësuese ka qenë në fuqi ligji nr. 9232, datë 13.5.2004, “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane’. Qëllimi i këtij ligji ishte*

<sup>8</sup>Shihni përgjigjet e subjektit mbi pyetësorin nr. \*\*\* ne dosjen e Komisionit.

*përcaktimi i rregullave dhe procedurave administrative për mënyrat e sigurimit, të shpërndarjes, të administrimit dhe të planifikimit të programeve sociale për strehimin, me qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përbalueshëm, brenda juridiksionit të bashkisë përkatëse të Republikës së Shqipërisë.*

*Në nenin 4 të këtij ligji listohen kriteret për familjet që përfitojnë nga programet e strehimit dhe në nenin 18 të këtij ligji përcaktohen kriteret mbi bazën e të cilëve përfitonin familjet.*

*Në kohën që unë kam paraqitur kërkesën për përfitim banese kam qenë e martuar me z. E.M dhe kemi pasur një vajzë. Nuk kemi përfituar nga ligji nr. 7652, datë 23.12.1992, 'Për privatizimin e banesave shtetërore', nuk kemi pasur në pronësi asnjë banesë, nuk kemi pasur detyrime ndaj institucioneve financiare dhe nuk kemi pasur të ardhura nga aktivitete fitimprurëse private, kemi qenë familje e re dhe prej disa vitesh banonim në banesë me qira.*

*Duke iu referuar kriterëve ligjore për përfitimin e kredisë, familja ime i ka plotësuar tërësisht kriteret e përcaktuara në ligjin e sipërcituar dhe kredia është përdorur për qëllimin e kërkuar, duke u finalizuar blerja nga ana jonë e banesës brenda juridiksionit të Bashkisë Fier”.*

**1.27** Përgjigjet e subjektit të rivlerësimit në pyetësin nr. \*\*\* nuk shpjegonin nëse gjendja e saj financiare dhe ekonomike, në funksion të të ardhurave mujore të familjes (përfshirë bashkëshortin) dhe investimit të bashkëshortit prej 4,000,000 lekësh tek “\*\*\*\*” sh.a., duke përbërë gati dyfishin e shumës së kërkuar për kredinë e butë (2,400,000 lekë), e bëri atë kandidatë të pranueshme për kredinë e butë sipas kërkesave specifike të ligjit për banesat sociale nr. 9232/2004. Një ligj i tillë parashikon kategori të veçanta vulnerabël (shihni nenet 5 dhe 19 të ligjit) dhe me nivel të ulët të të ardhurave familjare (si ato të konsideruara nga Bashkia Fier në disa raste në vitin 2011<sup>9</sup>). Gjithashtu, dispozitat e ligjit për banesat sociale, që ndalojnë pronarët e pronave të fituara me kredi të buta t'i shesin ato para një periudhe 15-vjeçare dhe me një çmim më të lartë se ai i blerë, ngrenë pikëpyetje mbi ligjshmërinë e veprimeve nga subjekti i rivlerësimit, duke shitur apartamentin në vitin 2017 me një çmim prej 5,500,000 lekësh. Sipas subjektit, paratë që ajo ka fituar nga kjo shitje (në kundërshtim me dispozitat e ligjit për banesat sociale) janë përdorur për blerjen e apartamentit në Tiranë.

**1.28** Është marrë informacion nga Bashkia Fier përmes shkresës nr. \*\*\* prot., datë 4.10.2022, lidhur me të drejtën e subjektit të rivlerësimit për përftimin e një kredie të butë. Sipas dokumenteve të paraqitura, me vendimin \*\*\*, datë 1.7.2010, Këshilli Bashkiak Fier e ka përfshirë subjektin e rivlerësimit në listën e pritjes së familjeve që përfitonin kredi të butë. Bashkia Fier ka dorëzuar kopje të praktikës përkatëse<sup>10</sup>.

**1.29** E pyetur në pyetësin e katërt për deklarimin dhe evidentimin e plotësimit të kriterëve ligjore për marrjen e kredisë së butë, subjekti i rivlerësimit është përgjigjur duke iu referuar kontratës së kredisë me bankën, datë 2.8.2011, dhe neneve 4, 5 dhe 8 të ligjit të banesave sociale, duke saktësuar se nuk kishte banesë, nuk përfitonte nga ligji për privatizimin e ndërtesave shtetërore, ishte e martuar dhe kishte një vajzë të lindur më 26.7.2010, jetonte dhe punonte në Fier, nuk kishte detyrime financiare ndaj institucioneve financiare, nuk kishte të ardhura nga aktivitete private fitimprurëse dhe familja e saj duhej të kualifikohet si e re. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në datën 29.7.2022 provat përkatëse<sup>11</sup>.

<sup>9</sup>Shihni *linkun*: vendime.al I Arkiva kombëtare e vendimeve të këshillave bashkiake; vendim-i-Këshillit-Bashkiak-Fier-nr.\*\*\*-dt-21.7.2011.pdf (vendime.al) kualifikohet për një kredi të butë një familje prej 6 anëtarësh me të ardhura mujore të deklaruara 65,000 lekë; vendim-i-Këshillit-Bashkiak-Fier-nr.\*\*\*-dt-21.7.2011.pdf (vendime.al) e kualifikuar për një kredi të butë një familje prej 3 anëtarësh me të ardhura mujore të deklaruara 40,000 lekë; etj. Ndërsa vetëm të ardhurat e subjektit të rivlerësimit për periudhën janë 120,763 lekë/muaj ose *neto* 96,851 lekë/muaj.

<sup>10</sup>Shihni dokumentacionin e paraqitur nga Bashkia Fier.

<sup>11</sup>Shihni provat e paraqitura nga subjekti në përgjigje të pyetësit nr. \*\*\*.

**1.30** Në vijim të sa më sipër konstatohet se nuk është dorëzuar asnjë dokument aplikimi nga subjekti i rivlerësimit për të justifikuar ligjërisht përfshirjen e saj në listën e pritjes me datë 1.7.2010. E pyetur për të shpjeguar dhe evidentuar ligjshmërinë e përshtatshmërisë së saj, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur informacion dhe dokumentacion vetëm për vitin 2011, pa përmendur asnjë aplikim para atij viti.

**1.31** Në përgjigjet e saj në pyetësonin nr. \*\*\*, në korrik të vitit 2022, subjekti ka deklaruar se: *“Në momentin kur parashtrova kërkesën time për të përfituar një banesë isha e martuar me E. M dhe kisha një vajzë të quajtur..., e datëlindjes 26.7.2010 (f. 8 e shkresës)”*. Kjo deklaratë nuk është në përputhje me kualifikimin e saj të ligjshëm para lindjes së vajzës, përkatësisht me vendimin nr. \*\*\*, datë 1.7.2010.

**1.32** Në dokumentet e paraqitura nga bashkia rezulton se paga e saj (100,000 - 120,000 lekë/muaj) së bashku me bashkëshortin (73,000 lekë/muaj) janë të ardhura shumë të larta familjare, krahasuar me të ardhurave e familjeve të tjera përfituese (40,000 – 65,000 lekë/muaj të ardhura familjare sipas vlerësimit të Këshillit Bashkiak në korrik të vitit 2011<sup>12</sup>). Të dhënat e INSTAT-it tregojnë se paga mesatare në Shqipëri për vitet 2010 - 2011 vlerësohej të ishte rreth 43,627 - 46,655 lekë/muaj<sup>13</sup>. Ndërsa ligji “Për strehimin social” parashikonte një nivel maksimal të të ardhurave familjare jo më të lartë se 120% e pagës mesatare referuese për rajonin, që do të thotë një maksimum përafërsisht 56,000 lekë/muaj të ardhura familjare.

**1.33** Subjekti i rivlerësimit nuk iu referua kriterëve të të ardhurave, sipas nenit 19 të ligjit “Për banesat sociale” në përgjigjet e saj në pyetësonin nr. \*\*\*\*, si dhe nuk ka shpjeguar se si mund të kenë ndikuar aksionet e bashkëshortit të saj tek “\*\*\*\*” sh.a. në shumën 4,000,000 lekë në atë kohë, në kualifikimin e saj për kredi të butë.

**1.34** Për gjetjet e mësipërme lidhur me përfitimin e kredisë së butë dhe shitjen më pas të apartamentit të përfituar nga kjo kredi, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit në rezultatet e hetimit, në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

**1.35** Bazuar në shkresën nr. \*\*\* prot., datë 28.10.2021, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe shkresën nr. \*\*\*\* prot., datë 27.10.2021, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, subjekti nuk rezulton të ketë ndjekur materiale kallëzuese apo procedime penale që kanë lidhje me palën shitëse të pasurisë apartament banimi në qytetin e Fierit.

**1.36** Komisioni hetoi lidhur me çmimin e blerjes së kësaj pasurie në raport me çmimet e përcaktuara për ndërtimet në qytetin e Fierit. Bazuar në Udhëzimin nr. 3, datë 3.2.2010, të Këshillit të Ministrave, rezultoi se vlera e tregut të lirë të apartamenteve në qytetin e Fierit është në vlerën 56,094 lekë për m<sup>2</sup>. Sipërfaqja e ndërtimit të apartamentit të blerë nga subjekti i rivlerësimit është 83.88 m<sup>2</sup> + 6.40 m<sup>2</sup> (sipërfaqe të përbashkëta) dhe kostoja llogaritet në vlerën (83.88+6.40 x 56,094) prej 5,064,166 lekësh. Subjekti e ka blerë këtë pasuri në vlerën 4,500,000 lekë, pra më pak se vlera e tregut.

**1.37** Në përfundim të hetimit Komisioni hartoi analizën financiare lidhur me mundësitë e blerjes së pasurisë apartament. Nga analiza financiare dukej se subjekti dhe bashkëshorti nuk kishin burime të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e pasurisë apartament me sip. 83.88 m<sup>2</sup> në Fier, në vitin 2011.

**1.38** Në analizën financiare të kësaj pasurie nuk janë përfshirë dhurimet nga shtetasit T. dhe M. M, pasi siç është trajtuar më sipër nuk janë provuar mundësitë e tyre financiare të tyre si dhurues të shumave të deklaruara.

<sup>12</sup>Shihni gjetjen e vëzhguesit ndërkombëtar, datë 6.10.2022, për subjektin e rivlerësimit Mërtiri.

<sup>13</sup>Shihni f. \*\*\* të raportit sipas [linkut - Shqipëria në shifra 2013.pdf \(instat.gov.al\)](#).

**1.39** Në përfundim të hetimit Komisioni konstatoi se subjekti nuk arriti të provojë burimin e ligjshëm për blerjen e kësaj pasurie apartament në qytetin e Fierit, si dhe mundësinë financiare të personave të tjerë të lidhur si dhurues.

**1.40** Për të gjitha gjetjet<sup>14</sup> e bëra nga Komisioni subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet dhe paraqitur provat e saj për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga ana e Komisionit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**1.41** Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti parashtroi<sup>15</sup>:

- Konstatimi se personi tjetër i lidhur (vëllai i bashkëshortit) rezulton në pamundësi për të justifikuar me burime të ligjshme shumën 1,000,000 lekë, nuk qëndron. Në analizën financiare janë përfshirë investime të kryera në shoqëri tregtare nga personi tjetër i lidhur shumë kohë përpara marrjes së cilësisë si dhurues e, për rrjedhojë, gjithë pasuritë e këtij të fundit. Analiza ekonomike e hartuar në të tillë mënyrë nuk ka logjikë financiare, pasi një investim i kryer në vitin 2002 apo 2004 nuk mund të llogaritet si shpenzim në vitin 2011.

Analiza financiare e kryer është shtrirë në të gjitha pasuritë e tjera të personit tjetër të lidhur, tej parashikimit ligjor dhe qëndrimin të Kolegjit, duke përfshirë si shpenzim investimin e kryer nga dhuruesi M. M. në shoqërinë “\*\*\*\*”.

- Burimi i shumës së dhuruar prej 1,260,000 lekësh nga vjehri T.M kanë qenë të ardhurat nga emigracioni, kthimi i huas, të ardhura nga qiratë, të ardhurat nga punësimi dhe blegtoaria.

Në analizën e hartuar nga Komisioni nuk janë përfshirë të ardhurat e realizuara nga kthimi i huas në vitin 2009. Po ashtu, në analizën financiare nuk janë përfshirë të ardhurat nga aktiviteti blegtoral, pasi nuk provohet vlera e tyre e fituar ndër vite nga dhuruesi. Me vërtetimin e ARSHVMB Vlorë vërtetohet se T. M. ka fermë blegtorale dhe ushtron aktivitetin e regjistruar në sistemin Ruda, me 250 krerë të leshta me adresë: rrethi Gjirokastër, Njësia Administrative L, fshati E. Në funksion të provueshmërisë së të ardhurave të krijuara nga ky aktivitet, gjeni raportin e një eksperti të fushës përkatëse<sup>16</sup>, që ka përlllogaritur fitimin e mundshëm për periudhën 2008 – 2011, duke përlllogaritur të ardhurat e mundshme për secilin vit.

Në analizën financiare të personit tjetër të lidhur T. M., është llogaritur një investim i kryer në vitin 2004 në shoqëri, duke e kryer analizën njësoj si për subjektin e lidhur. Kjo përlllogaritje, përveçse nuk ka logjikë financiare, nuk është bërë në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016.

Në lidhje me vlerën e blerjes së truallit, vitin dhe shpenzimet e ndërtimit të objektit ndërtimor nga personi tjetër i lidhur T. M., konstatohet se pasuria me nr. \*\*\*, truall + ndërtesë, me sipërfaqe totale 419.5 m<sup>2</sup>, regjistruar në emër të shtetasit T. M. (hipotekuar në funksion të marrjes së kredisë bankare, sipas kontratës së hipotekimi nr. \*\*\*, datë 2.8.2011), është një pasuri e trashëguar me testament nga prindërit e dhuruesit.

- Kreditë me kushte lehtësuese është përfituar në përputhje me ligjin nr. 9232, datë 13.5.2004, “Për programet sociale të strehimit për banorët e zonave urbane”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore.

Kushtet dhe kriteret ligjore për përfitimin e kredisë sipas këtij ligji janë:

- a. kushtet e strehimit, mospasja e një banese në pronësi;

<sup>14</sup>Shihni rezultatet e hetimit dërguar subjektit të rivlerësimit.

<sup>15</sup>Shihni parashtrimet e plota të subjektit në përgjigje të rezultateve të hetimit.

<sup>16</sup>Shihni raportin e ekspertit në dokumentacionin e paraqitur nga subjekti në përgjigje të rezultateve të hetimit.

- b. kushtet familjare te kategorizuara nga ligji;
- c. gjendja ekonomike.

Këto kushte dhe kriteret janë verifikuar, kontrolluar dhe pranuar nga institucionet përkatëse shtetërore. Zyrat përkatëse në bashki kryejnë verifikimet sipas legjislacionit në fuqi për dokumentacionin e paraqitur si më sipër dhe marrin konfirmim nga Zyra Qendrore dhe Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për pasuri, të regjistruar në emër të të gjithë anëtarëve të familjes. Miratimi me vendim të Këshillit Bashkiak nuk e bën familjen automatikisht përfituese. Banka mund të kërkojë dokumente plotësuese për të mbështetur informacionin e dhënë mbi nivelin e të ardhurave të familjes.

Të ardhurat mesatare mujore të familjes kanë qenë brenda kufijve që përcaktohen nga Ministria që mbulon fushën e strehimit, në bashkëpunim me bankën që ka dhënë kredinë, e cila ka ushtruar një kontroll të plotë pasi ka kërkuar dhe verifikuar edhe dokumente shtesë dhe ka konkluduar sigurinë e saj që të ardhurat e deklaruara përmbushin kriteret ligjore dhe janë të arsyeshme për të përballuar kredinë e lehtësuar.

Banesa nuk është siguruar nëpërmjet programeve sociale, por është siguruar nëpërmjet blerjes në tregun e lirë dhe një pjesë e çmimit të blerjes prej 2,240,000 lekësh është përfituar me kredi hipotekore me kushte lehtësuese, ndaj për përcaktimin e nivelit të të ardhurave të familjes për efekt përfitimi të kësaj kredie nuk është i zbatueshëm paragrafi i parë, por paragrafi 2 i nenit 19 i ligjit nr. 9232. Kjo parashikuar edhe në udhëzimin nr. 6257/2008.

Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 7.11.2022, të Bashkisë Fier, është vënë në dispozicion e gjithë dokumentacioni që ky organ publik disponon në lidhje me trajtimin e aplikimit për kredi të lehtësuar. Këto dokumente nga ky organ publik i cili i ka administruar ato për efekt të procedurës së ndjekur. Deri në datën 30.3.2011 familja ka qenë në statusin e listës e pritjes dhe jo përfitues.

- Subjektet që mbartin detyrimin ligjor për të mos e shitur për një periudhë 15-vjeçare banesën, i përkufizuar nga ligjvënësi si kufizim, janë vetëm familjet që kanë përfituar banesë me kosto të ulët.

Banesa e përfituar është një banesë e blerë në tregun e lirë dhe jo banesë me kosto të ulët. Shitja e saj është bërë në vitin 2017 dhe shuma e përfituar është përdorur për blerje banese në qytetin e ushtrimit të detyrës për shkak të transferimit të vendit të punës.

- Konstatimi se çmimi i blerjes së apartamentit është më pak se vlera e tregut të lirë, nuk qëndron, pasi në përlllogaritje e bërë është përfshirë edhe sipërfaqja e përbashkët. Për efekt të ligjit sipërfaqja e përbashkët është një sipërfaqe që nuk i nënshtrohet përlllogaritjes së tatimit mbi të ardhurat në rastet e kontratave të shitblerjes.

## **Vlerësimi i Komisionit**

**1.42** Komisioni, pasi administroi përgjigjet e subjektit dhe provat e paraqitura në përgjigje të rezultateve të hetimit lidhur me këtë pasuri, vlerëson si vijon:

**1.43** Lidhur me mundësitë financiare të personit tjetër të lidhur M. M. për dhurimin e shumës 1,000,000 lekë në vitin 2011, trupi gjykues hartoi analizën financiare të paraqitur në tabelën si vijon:

## Analiza e mundësisë së dhurimit të vlerës 1,000,000 lekë nga z. M.M - mars 2011

Përshkrimi	Vlera (në lekë)
Të ardhura nga paga M. M 2005 - mars 2011	2,910,591
Të ardhura nga paga S. G 2005 - mars 2011	2,770,931
<b>Të ardhura totale M. M + S.G</b>	<b>5,681,522</b>
Shpenzime jetese 2005 - 2011	1,997,973
Dhurim 1,000,000 lekë subjektit - mars 2011	1,000,000
<b>Total shpenzime dhe dhurim</b>	<b>2,997,973</b>
<b>Mundësia financiare</b>	<b>2,683,549</b>

**1.44** Nga analiza financiare duket se dhuruesi dhe bashkëjetuesja e tij kishin mundësi financiare të mjaftueshme për dhurimin e vlerës 1,000,000 lekë subjektit në mars të vitit 2011, si dhe për mbulimin e shpenzimeve të jetesës nga viti 2005 deri në mars të vitit 2011.

Në këtë analizë u përfshinë vetëm të ardhurat nga paga të dhuruesit dhe bashkëjetueses së tij për periudhën 2005 – mars 2011. Investimet e kryera nga dhuruesi në vitet 2002 dhe 2004 nuk janë përfshirë në këtë analizë financiare. Mospërfshirja e këtyre investimeve nga dhuruesi për krijimin e kapitalit të dy shoqërive “\*\*\*\*” dhe “\*\*\*\*”, ndër të tjera, është bërë për faktin se këto investime janë bërë shumë vite para dhurimit të shumës subjektit të rivlerësimit. Nëse do të përfshihen në vlerësimin dhe analizën përfundimtare edhe investimet e dhuruesit në këto vite, atëherë do ishte e nevojshme të bëhej hetimi dhe vlerësimi i të gjithë pasurive dhe të ardhurave të dhuruesit që nga momenti i fillimit të marrëdhënieve të punës dhe krijimit të këtyre të ardhurave financiare të tij.

**1.45** Bazuar në vendimet e konsoliduara të Kolegjit, trupi gjykues shprehet se në rastet kur subjekti i rivlerësimit gjendet para situatës së parashikuar prej pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, ai duhet të ketë detyrimin të provojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të kësaj pasurie, e cila është objekt dhurimi apo huaje, pa u shtrirë ky detyrim mbi të gjitha pasuritë që kanë personat e tjerë të lidhur. Interpretimi në të kundërt i kësaj dispozite konsiderohet se shkel parimin e proporcionalitetit, pasi e ngarkon subjektin me një barrë përtej asaj që ligjërisht i është ngarkuar të mbajë dhe barazon statusin e një shtetasi tjetër, personit tjetër të lidhur, që, përgjithësisht, nuk ka figuruar të ketë qenë subjekt deklarues me atë të vetë subjektit të rivlerësimit, një mision që del jashtë qëllimit të ligjit dhe, për më tepër, duket edhe i pamundur.

**1.46** Trupi gjykues vlerësoi se shtrirja e kontrollit mbi gjithë pasuritë e personave që kanë marrëdhënie interesi me subjektin e rivlerësimit, do të përbënte një barrë disproporcionale për subjektin, edhe në rastin kur personat e tjerë të lidhur janë njëkohësisht edhe persona të lidhur me subjektin e rivlerësimit.

**1.47** Trupi gjykues vlerëson dhe verifikon burimin e ligjshëm të pasurisë nga subjekti i rivlerësimit bazuar në deklaratën *Vetting*, në DPV, si dhe në përgjigjet e pyetësorit të paraqitur nga subjekti gjatë fazës së hetimit administrativ. Subjekti, në deklaratat dhe përgjigjet e pyetësorit, ka qenë konstante, duke deklaruar se burim i dhurimit janë të ardhurat e dhuruesit dhe bashkëjetueses së tij nga paga e biznesit.

**1.48** Lidhur me mundësitë financiare të personit tjetër të lidhur T. M. për dhurimin e shumës 1,260,000 lekë në vitin 2011, trupi gjykues hartoi analizën financiare, paraqitur në tabelën si vijon:



## Analiza e mundësisë së dhurimit të vlerës 1,260,000 lekë nga z. T.M - mars 2011

Përshkrimi	Vlera (në lekë)
Të ardhura nga paga T.M 2005 - mars 2011	1,495,654
Të ardhura nga paga A.M 2005 - mars 2011	1,393,066
Të ardhura nga qiraja e autobusit T.M 2005 - tetor 2007	306,000
Të ardhura nga shitja e autobusit T. M - 2007	250,000
<b>Të ardhura totale T dhe A.M</b>	<b>3,444,720</b>
Shpenzime jetese 2004 - 2011	1,599,498
Dhurim 1,260,000 lekë subjektit - mars 2011	1,260,000
<b>Total shpenzime dhe dhurim</b>	<b>2,859,498</b>
<b>Mundësia financiare</b>	<b>585,222</b>

**1.49** Nga analiza financiare duket se dhuruesi dhe bashkëshortja e tij kishin mundësi financiare të mjaftueshme për dhurimin e vlerës 1,260,000 lekë subjektit në mars të vitit 2011, si dhe për mbulimin e shpenzimeve të jetesës nga viti 2005 deri në mars të vitit 2011.

Në këtë analizë u përfshinë vetëm të ardhurat e përfituara nga paga e dhuruesit dhe bashkëshortes së tij për periudhën 2005 – mars 2011, si dhe të ardhura të tjera të provuara si burime të ligjshme. Investimi i kryer nga dhuruesi në vitin 2004 nuk është përfshirë në këtë analizë financiare. Mospërfshirja e këtij investimi nga dhuruesi për krijimin e kapitalit të një shoqërie, ndër të tjera, është bërë për faktin se ky investim është bërë shumë vite para dhurimit të shumës subjektit të rivlerësimit. Trupi gjykues mban të njëjtin qëndrim lidhur me hetimin e burimit të dhuruesit, që është përmendur në pikën 1.43 në këtë vendim. Interpretimi në të kundërt i dispozitave ligjore në fuqi konsiderohet se shkel parimin e proporcionalitetit, pasi e ngarkon subjektin me një barrë përtej asaj që ligjërisht i është ngarkuar të mbajë dhe barazon statusin e një shtetasi tjetër, personit tjetër të lidhur, që, përgjithësisht, nuk ka figuruar të ketë qenë subjekt deklarues me atë të vetë subjektit të rivlerësimit, një mision që del jashtë qëllimit të ligjit dhe, për më tepër, duket edhe i pamundur.

**1.50** Trupi gjykues vlerësoi se shtrirja e kontrollit mbi gjithë pasuritë e personave që kanë marrëdhënie interesi me subjektin e rivlerësimit do të përbënte një barrë disproporcionale për subjektin e rivlerësimit edhe në rastin kur personat e tjerë të lidhur janë njëkohësisht edhe persona të lidhur me subjektin e rivlerësimit.

**1.51** Trupi gjykues vlerëson dhe verifikon burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë nga subjekti i rivlerësimit bazuar në deklaratën *Vetting*, në DPV, si dhe përgjigjet e pyetësorit të paraqitur nga subjekti gjatë fazës së hetimit administrativ. Subjekti, në deklaratat dhe përgjigjet e pyetësorit, ka deklaruar se burim i dhurimit janë të ardhurat e dhuruesit dhe bashkëshortes, duke i renditur në mënyrë të detajuar ato<sup>17</sup>.

**1.52** Në analizën financiare, trupi gjykues përfshiu vetëm ato të ardhura të deklaruara për dhuruesin, për të cilat u provua burimi i ligjshëm i krijimit. Si rrjedhojë, në analizën financiare u përfshinë të ardhurat nga paga e dhuruesit dhe bashkëshortes për periudhën 2005 – 2011, të ardhura nga dhënia me qira e autobusit për vitet 2005 – 2007 dhe të ardhurat nga shitja e autobusit në vitin 2007.

**1.53** Në analizën financiare nuk u përfshinë të ardhurat e pretenduara nga kthimi i huas në shumën 960,000 lekë dhe të ardhurat e pretenduara nga aktiviteti blegtoral. Lidhur me shumën e pretenduar për kthimin e huas të dhuruesi në vitin 2009, trupi gjykues arriti në përfundimin

<sup>17</sup>Shihni deklaratën *Vetting*, DPV/2011 dhe përgjigjet e pyetësorëve të subjektit.

se subjekti i rivlerësimit nuk arriti ta provojë atë. Bazuar në dokumentacion origjinal (kontratë), të vënë në dispozicion nga subjekti, rezultoi se shtetasi T. M. (në cilësinë e dhuruesit ndaj subjektit të rivlerësimit) në vitin 1994 i ka dhënë hua një personi shumë prej 960,000 lekësh. Bazuar në këtë kontratë shuma prej 960,000 lekësh do të kthehet pas një viti, pra në vitin 1995. Subjekti pretendoi se kjo shumë është kthyer në vitin 2009 dhe për këtë duhet të përfshihet si e ardhur në analizën financiare të bërë për dhuruesin T. M. Këtë deklaramin subjekti e provon me deklaratë noteriale<sup>18</sup>. Deklarata noteriale e lëshuar shumë kohë pas afatit të përcaktuar në kontratën e shlyerjes së detyrimit (viti 1995), por edhe disa vite më vonë se afati i pretenduar (viti 2009), nuk provon kthimin e kësaj shume në periudhën e pretenduar nga subjekti, përderisa nuk ka një akt të shkruar të kohës (kontratë të nënshkruar nga palët) që vërteton shlyerjen e detyrimit dhe as ndonjë evidencë (mandat, transfertë bankare). Neni 690 i Kodit Civil, përcakton: *“Kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët. Ajo mund të prishet ose të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë të palëve ose për shkak të parashikuara me ligj”*.

**1.54** Lidhur me të ardhurat e pretenduara të dhuruesit nga aktiviteti blegtoral, trupi gjykues vendosi mos t'i përfshijë këto të ardhura në analizën financiare, pasi nuk provohet shuma e përfituar dhe burimi i ligjshëm i krijimit. Subjekti ka paraqitur si provë për të vërtetuar të ardhura nga aktiviteti blegtoral vetëm një aktekspertim të një subjekti të licensuar, i cili ka bërë një vlerësim hipotetik lidhur me të ardhurat e mundshme të krijuara nga ky aktivitet. Ky raport nuk është shoqëruar me asnjë dokumentacion shkresor provues të ndonjë institucioni shtetëror, për të konfirmuar një aktivitet të tillë ndër vite, kohën dhe periudhën përkatëse, të dhënat për fermën blegtorale, numrin e krrëve, etj.

**1.55** Lidhur me kredinë e butë, trupi gjykues konstatoi se ajo është përfituar nga subjekti bazuar në ligjin nr. 9232 të vitit 2004. Subjekti ka përfituar kredi të butë për mbulimin e një pjese të pasurisë apartament të blerë prej saj në tregun e lirë.

**1.56** Kreditë me kushte lehtësuese përfshihen në programin e banesave me kosto të ulët, si një nga programet sociale të strehimit, të parashikuara në këtë ligj. Në nenin 4 të ligjit të sipërpërmendur janë përcaktuar kushtet e përfitimit nga programet sociale. Procedura për përzgjedhjen e familjeve përfituese ndiqet nga bashkia dhe miratohet nga Këshilli Bashkiak përkatës. Përzgjedhja e subjekteve dhe familjeve përfituese bëhet nëpërmjet një sistemi pikëzimi, i cili miratohet dhe publikohet për çdo program nga njësia e vetëqeverisjes vendore, bazuar në parimet e parashikuara në këtë ligj, si dhe kriteret e bëra publike përpara fillimit të procesit të aplikimit. Trupi gjykues konstatoi se kjo procedurë përzgjedhëse e subjektit për përfitimin e kredisë ka kaluar të gjitha fazat dhe është miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak Fier. Deri më sot nuk ka rezultuar ndonjë revokim i miratimit të kredisë së butë për subjektin e rivlerësimit nga organet kompetente miratuese dhe kontrolluese apo dhe nga gjykata. Trupi gjykues nuk konstatoi as problematikë lidhur me shitjen më pas të apartamentit në qytetin e Fierit, pasi subjekti nuk ndodhej në kushtet kufizuese të parashikuara nga neni 20 i ligjit nr. 9232/2004, i ndryshuar. Për këtë pasuri apartament nuk është vendosur ndonjë kufizim në kartelën përkatëse të pasurisë të lëshuar nga ASHK-ja.

**1.57** Trupi gjykues nuk konstatoi konflikt interesi me palën shitëse të pasurisë apartament në qytetin e Fierit. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 28.10.2011, konfirmoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka ndjekur materiale kallëzuese apo procedime që kanë lidhje me palën shitëse të pasurisë apartament banimi në qytetin e Fierit.

**1.58** Në përfundim, trupi gjykues hartoi analizën financiare lidhur me mundësitë e subjektit dhe personit të lidhur për blerjen e pasurisë apartament me sipërfaqe ndërtimore 83.88 m<sup>2</sup>, i ndodhur në lagjen “\*\*\*”, Fier.

---

<sup>18</sup>Shihni deklaratën noteriale të paraqitur nga subjekti në dosjen e Komisionit.

## Analiza e mundësisë së blerjes së apartamentit në vlerën 4,500,000 lekë - viti 2011

Përshkrimi	Vlera (në lekë)
Dhurim nga T. M	1,260,000
Dhurim nga M.M	1,000,000
Kredi në BKT	2,240,000
<b>Totali i burimeve</b>	<b>4,500,000</b>
Blerje apartamenti 83.88 m <sup>2</sup> - 2011	4,500,000
<b>Mbulimi</b>	<b>100%</b>

**1.59** Nga analiza financiare rezultoi se subjekti dhe bashkëshorti i saj kishin burime të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e apartamentit me sip. 83.88 m<sup>2</sup> në Fier në vitin 2011.

### Konkluzion i Komisionit

**1.60** Në përfundim sa më sipër, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të saktë për këtë pasuri, ka pasur burimeve financiare të ligjshme për blerjen e saj dhe nuk janë konstatuar problematika.

### 2. Automjet tip “\*\*\*\*”

**2.1** Subjekti ka deklaruar blerjen e një automjeti tip “\*\*\*\*”, i regjistruar në datën 26.8.2004.

**2.2** Vlera e blerjes është deklaruar në shumën 4,800 euro dhe pasuria është blerë në datën 10.2.2004.

**2.3** Si burim të ardhurash janë deklaruar të ardhura nga paga e administratorit të shoqërisë “\*\*\*\*” dhe të ardhura familjare. Subjekti ka deklaruar se ky automjet është blerë nga bashkëshorti përpara fillimit të detyrës si prokurore.

**2.4** Bazuar në vërtetimin nr. \*\*\* prot., datë 14.10.2016, lëshuar nga DPSHTRR, Drejtoria Fier, për automjetin tip “\*\*\*\*” me targa FR \*\*\*, rezultoi se kjo pasuri është regjistruar në pronësi të shtetasit E.M në datën 26.8.2004. Bashkëlidhur ndodhet fatura e blerjes së automjetit nga shtetasi E.M pranë shoqërisë “\*\*\*\*”, në datën 10.2.2004, kundrejt vlerës 4,800 euro.

**2.5** DPSHTRR-ja, me shkresat e datës 7.8.2017, 15.9.2017 dhe shkresën nr. \*\*\* prot., datë 2.7.2020, konfirmon se në emër të shtetasit E. M ka qenë i regjistruar automjeti me targa FR \*\*\*. Pjesë e praktikës së këtij automjeti është edhe fatura e blerjes së tij nga shtetasi E.M pranë shoqërisë “\*\*\*\*”, në datën 10.2.2004, kundrejt vlerës 4,800 euro. Ky automjet aktualisht është me statusin “çregjistrim i përhershëm”.

**2.6** Për të provuar burimin e ligjshëm për blerjen e kësaj pasurie, Komisioni pyeti subjektin e rivlerësimit.

**2.7** Në përgjigje të pyetsorit<sup>19</sup> subjekti deklaroi: “Sqaroj se automjeti tip ‘\*\*\*’, me targa FR \*\*\*, është regjistruar në datën 26.8.2004.

*Si burim të ardhurash për blerjen e këtij automjeti, sipas shpjegimeve të bashkëshortit, ka shërbyer paga e tij në vlerën 70,000 lekë si administrator i shoqërisë ‘\*\*\*’ sh.a. Sigurimet e derdhura si kontribute kanë qenë ato të pagës minimale, por në fakt një pjesë e pagës është paguar cash nga ana e shoqërisë.*

<sup>19</sup>Shihni përgjigjet e subjektit mbi pyetësorin nr. 4 në dosjen e Komisionit.

*Si burim krijimi kanë shërbyer edhe të ardhura që bashkëshorti ka përfituar nga puna si oficer i policisë gjyqësore në Komisionin e Policisë Vlorë për periudhën 2001 - 2002, konsideruar kjo si e ardhur familjare.*

*Sjell në vëmendjen tuaj se mjete të mësipërme është blerë nga bashkëshorti 4 vite përpara detyrës time dhe 4 vite përpara se unë të njihesha dhe të lidhja martesë me z. E.M.*

*Pasuria është krijuar përpara periudhës së rivlerësimit tim, në kuptim të pikës 12 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016. Në kohën e plotësimit të deklaratës Vetting kjo pasuri nuk ka qenë në përdorim të familjes time, pasi, sikurse unë më sipër sqarova, prej vitit 2011 mjete nuk ka qenë më në përdorim”.*

**2.8** Në deklaratën Vetting subjekti ka deklaruar se burim për blerjen e kësaj pasurie kanë shërbyer të ardhurat e përfituara nga bashkëshorti si administrator në shoqërinë “\*\*\*\*” sh.a. në vlerën 70,000 lekë. Bazuar në të dhënat e sigurimeve shoqërore kontributet e derdhura nga shoqëria nuk i përkojnë kësaj page të deklaruar nga subjekti, por pagës minimale për efekt fiskal.

**2.9** Në përfundim të hetimit për këtë pasuri Komisioni doli në konkluzionin se:

- Subjekti nuk ka deklaruar saktë të ardhurat mujore të bashkëshortit të përfituar si administrator i shoqërisë “\*\*\*\*” sh.a.
- Subjekti duhet të provojë mundësitë financiare të bashkëshortit për blerjen e kësaj pasurie automjet.

**2.10** Për gjetjet e mësipërme subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet dhe për të paraqitur provat e saj për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga ana e Komisionit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**2.11** Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti parashtroi: *“Në deklaratën Vetting kam deklaruar automjeti tip ‘\*\*\*’, blerë në vlerën 4,800 euro. Si burim të ardhurash kam deklaruar: të ardhura nga paga e administratorit të shoqërisë ‘\*\*\*’ dhe të ardhura familjare. Ky automjet është blerë nga bashkëshorti im përpara fillimit të detyrës sime si prokurore.*

*Në shpjegimet e mia kam sqaruar se si burim krijimi i kësaj pasurie sipas shpjegimeve të bashkëshortit ka shërbyer paga e tij në vlerën e 70,000 lekë si administrator i shoqërisë ‘\*\*\*’ sh.a. Sigurimet e derdhura si kontribute kanë qenë ato të pagës minimale, por në fakt një pjesë e pagës është paguar cash nga shoqëria.*

*Sa më sipër, rezulton se pasqyrimi në lidhje me të ardhurat e pagës të bashkëshortit tim në deklaratën Vetting nuk ka mospërputhje, por është i saktë. Pavarësisht faktit se një pjesë e asaj page është marrë në cash nga bashkëshorti im përpara se të kishte statusin e personit të lidhur për efekt të ligjit ‘Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike’, ajo është një e ardhur e përfituar prej tij. Deklarimi im ka qenë korrekt dhe i saktë, pasi unë në asnjë moment nuk e kam deklaruar pagën në vlerën 70,000 lekë si pagë për të cilën janë derdhur kontributet, përkundrazi kam sqaruar se vërtetimi nga sigurimet shoqërore ka të përcaktuara vetëm sigurimet e derdhura.*

*Konstatimi juaj për sa i përket kontributeve shoqërore që i referohen pagës minimale për efekt fiskal qëndron, por unë në asnjë moment nuk e kam deklaruar vlerën 70,000 lekë si pagë për të cilën janë derdhur kontributet shoqërore, përkundrazi kam sqaruar se një pjesë e kësaj page është marrë cash. Në sqarimet e mia në pyetësonin nr. \*\*\*, kam sqaruar në atë periudhë kohe se bashkëshorti im ka qenë në punë të ndryshme, por ka qenë punësim informal. Ky punësim i bashkëshortit ka qenë përpara se unë të krijoja lidhje me të dhe se të ardhurat e krijuara nga*

ky punësim nuk kanë shërbyer për të krijuar kursime apo për të kontribuar në blerjen e ndonjë pasurie gjatë bashkësisë ligjore.

*Për sa bashkëshorti kujton se si burim krijimi përveç të ardhurave apo kursimeve familjare kanë shërbyer edhe të ardhura që bashkëshorti ka përfituar nga puna si oficer i policisë gjyqësore në Komisariatit e Policisë Vlorë për periudhën 2001 - 2002, për të cilën unë kam vënë në dispozicion kopje të librezës së sigurimeve që dispononte bashkëshorti, të konsideruara këto si pjesë e të ardhurave familjare.*

*Nga ana e familjes time nuk është përfituar asnjë e ardhur nga kjo pasuri. Kjo është një pasuri që ka qenë në pronësi të plotë të bashkëshortit tim para martesë dhe në asnjë rast nuk kanë shërbyer si burim për krijimin e saj të ardhura e realizuara nga ana ime. Në kohën e blerjes së kësaj pasurie unë kam qenë 18 vjeçe, në vit të parë të Shkollës së Lartë - studente dhe nuk e njihja z. E.M”.*

### **Vlerësimi i Komisionit**

**2.12** Komisioni, pasi administroi përgjigjet e subjektit dhe provat e paraqitura në përgjigje të rezultateve të hetimit lidhur me këtë pasuri, vlerëson si vijon:

- Automjeti tip “\*\*\*\*” me targa FR \*\*\* është regjistruar në emër të bashkëshortit të subjektit në datën 26.8.2004. Ky automjet është hequr nga qarkullimi përfundimisht më datën 28.8.2017<sup>20</sup>.
- Kjo pasuri rezultoi e krijuar disa vite para martesës së subjektit dhe para fillimit të detyrës së saj si magjistrate. Kodi i Familjes përcakton se çdo pasuri e fituar nga bashkëshortët gjatë martesës i nënshtrohet regjimit të bashkësisë ligjore (neni 74 i Kodit të Familjes), përfshirë këtu edhe të ardhurat e secilit bashkëshort nëse nuk janë konsumuar deri në mbarimin e bashkëpronësisë. Nga ana tjetër, Kodi i Familjes përcakton edhe kuptimin e asaj pasurie që nuk i përket bashkësisë dhe që konsiderohet “pasuri vetjake”. Si e tillë, në germën “a” të nenit 77 përcaktohet edhe pasuria e cila përpara lidhjes së martesës ishte në bashkëpronësi të bashkëshortit me persona të tjerë ose kundrejt së cilës ai ishte titullar i një të drejte reale.
- Rezultoi se kjo pasuri automjet nuk ka sjellë asnjë përfitim apo shtim të pasurisë bashkëshortore gjatë martesës së subjektit të rivlerësimit. Por subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë pagën e bashkëshortit si administrator i shoqërisë “\*\*\*\*” sh.a., pagë e cila ka shërbyer si burim të ardhurash për blerjen e këtij automjeti në vitin 2004.

### **Konkluzion i Komisionit**

**2.13** Trupi gjyqësor vlerëson se problematikat të cilat lidhen me pasuritë e personit të lidhur të krijuara para martesës me subjektin e rivlerësimit nuk konsiderohen se mund të mjaftojnë si shkaqe objektive dhe proporcionale të vendosura në këtë proces për të ngarkuar drejtpërdrejt me masë disiplinore subjektin e rivlerësimit.

### **3. Llogari rrjedhëse**

**3.1** Subjekti ka deklaruar llogari rrjedhëse në emër të Mariola Mërtiri (page, Prokuroria e Rrethit Tiranë) në “Credins Bank”. Gjendja aktuale: 432,897 lekë.

**3.2** Bazuar në ekstraktin nxjerrje llogarie në emër të subjektit Mariola Mërtiri pranë “Credins Bank”, gjatë periudhës 3.5.2016 – 16.1.2017, gjendja në këtë llogari është në vlerën 364,786 lekë.

<sup>20</sup>Shihni vërtetimin nr. \*\*\* prot., datë 28.8.2017, në dosjen e Komisionit.

3.3 “Credins Bank”, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 10.8.2017 dhe shkresën nr. \*\*\* prot., datë 29.10.2020, konfirmon llogari page në emër të znj. Mariola Mërtiri, me gjendje 364,786 lekë.

3.4 Gjatë hetimit rezultoi se kjo është një llogari page e subjektit ku kanë kaluar të ardhurat ndër vite nga marrëdhëniet e punës.

3.5 Trupi gjykues nuk konstatoi problematika lidhur me këtë llogari bankare (rrjedhëse) të subjektit.

#### **4. Llogari rrjedhëse**

4.1 Subjekti ka deklaruar llogari rrjedhëse pranë “Raiffeisen Bank” në emër të saj, ku janë të depozituara edhe kursimet që kanë qenë gjendje *cash* të deklaruara ndër vite në ILDKPKI. Gjendja aktuale: 687,915.10 lekë.

4.2 Bazuar në *statement*-in “nxjerrje llogarie” në emër të znj. Mariola Mërtiri pranë “Raiffeisen Bank”, gjendja në llogari në datën 23.1.2017 është në shumën 687,915 lekë.

4.3 “Raiffeisen Bank”, me shkresat nr. \*\*\* prot., datë 14.7.2017, dhe nr. \*\*\* prot., datë 13.7.2020, konfirmon llogari rrjedhëse në emër të znj. Mariola Mërtiri me gjendje 670,068 lekë.

4.4 ILDKPKI-ja ka konstatuar se: *“Ndryshimi midis vlerës së deklaruar nga subjekti dhe asaj të konfirmuar nga ‘Raiffeisen Bank’ ka ndodhur për shkak të paraqitjes në dy data të ndryshme, dhe konkretisht deklarimi i përket datës 23.1.2017, ndërsa kërkesa dhe konfirmimi i bankës i përket datës 25.1.2017”*.

4.5 Trupi gjykues nuk konstatoi problematika mbi këtë llogari rrjedhëse dhe duket se subjekti ka bërë deklaram të saktë mbi këtë llogari.

#### **5. Apartament me qira**

5.1 Në përgjigje të pyetësorit standard subjekti ka deklaruar: *“Nga muaji korrik 2016 deri në qershor 2017 vendbanimi (vendqëndrimi) im ka qenë: bulevardi ‘\*\*\*’, hyrja \*\*\*, apartamenti \*\*\* (marrë me qira shtetasit E.H kundrejt vlerës 24,000 lekë/muaj). Pagesa është bërë njëherësh për 8 muaj 192,000 lekë në vitin 2016”*.

5.2 Për këtë deklaram subjekti ka paraqitur një kontratë noteriale qiraje, datë 27.6.2016, me palë E.M dhe qiradhënës E.H.

5.3 Bazuar në kontratën nr. \*\*\*, datë 27.6.2016, nënshkruar ndërmjet palës qiradhënëse E.H dhe palës qiramarrëse E.M rezultoi marrja me qira e një apartamenti me sip. 94 m<sup>2</sup>, ndodhur në bulevardin “\*\*\*\*”. Afati i kontratës: 8 muaj. Vlera e qirasë mujore 24,000 lekë, pagesë e cila është bërë parapagim për të gjithë periudhën 8-mujore të kontratës.

5.4 Për apartamentin me sip. 94 m<sup>2</sup>, në bulevardin “\*\*\*\*” Tiranë (apartament i marrë me qira nga subjekti) rezultoi certifikatë për vërtetim pronësie datë 13.6.2016, në emër të qiradhënësit E.H.

5.5 Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar se burim për pagimin e qirasë janë të ardhurat nga pagat.

5.6 Trupi gjykues nuk konstatoi problematika mbi këtë deklaram dhe shpenzime të subjektit lidhur me qiranë. Në analizë financiare janë përfshirë të gjitha shpenzimet e qirasë për periudhën përkatëse.

#### **Deklarimi i bashkëshortit të subjektit E.M**

Deklarimi i pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme është i njëjtë me deklaramin e bërë nga subjekti i rivlerësimit. Ndërkohë bashkëshorti i subjektit ka deklaruar edhe likuiditetet si vijon:

## **6. Llogari rrjedhëse**

**6.1** Bashkëshorti i subjektit ka deklaruar llogari rrjedhëse page në “Credins Bank” në emër të tij. Gjendja në llogari sipas *statement*-it datë 19.1.2017 është 965.47 lekë.

**6.2** ILDKPKI-ja ka konstatuar se: *Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar, si dhe me përgjigjen e ardhur nga “Credins Bank”.*

**6.3** Bazuar në *statement*-in “nxjerrje llogarie” në emër të z. E.M pranë “Credins Bank”, gjatë periudhës 30.4.2010 – 19.1.2017, gjendja në llogari është në vlerën 965.47 lekë.

**6.4** “Credins Bank”, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 10.8.2017 dhe shkresën nr. \*\*\* prot., datë 29.10.2020, konfirmon llogari page në emër të z. E.M me gjendje 965 lekë.

**6.5** Trupi gjykues nuk konstatoi problematika mbi këtë llogari page dhe duket se bashkëshorti i subjektit ka bërë deklarim të saktë mbi këtë llogari.

## **7. Llogari rrjedhëse**

**7.1** Bashkëshorti i subjektit ka deklaruar llogari rrjedhëse në “Raiffeisen Bank” në emër të tij, gjendja aktuale e së cilës sipas *statement*-it bankar në datën 19.1.2017 është 1,120,809.22 lekë.

**7.2** Sipas bashkëshortit të subjektit derdhjet në këtë llogari rrjedhëse janë kursime nga paga dhe të deklaruara si të tilla ndër vite në ILDKPKI.

**7.3** Bazuar në *statement*-in “nxjerrje llogarie” në emër të z. E.M pranë “Raiffeisen Bank”, gjendja në llogari në datën 19.1.2017 është në shumën 1,120,809 lekë.

**7.4** “Raiffeisen Bank”, me shkresat nr. \*\*\* prot., datë 14.7.2017 dhe nr. \*\*\* prot., datë 13.7.2020, konfirmon llogari rrjedhëse në emër të z. E. M me gjendje 1,100,809 lekë.

**7.5** ILDKPKI-ja ka konstatuar se: *“Ndryshimi midis vlerës së deklaruar nga subjekti dhe asaj të konfirmuar nga ‘Raiffeisen Bank’ ka ndodhur për shkak të paraqitjes në dy data të ndryshme, dhe konkretisht deklarimi i përket datës 19.1.2017, ndërsa kërkesa dhe konfirmimi i bankës i përket datës 25.1.2017”.*

**7.6** Trupi gjykues nuk konstatoi problematika mbi këtë llogari rrjedhëse dhe duket se bashkëshorti i subjektit ka bërë deklarim të saktë mbi këtë llogari.

## **8. Aksione të shoqërisë “\*\*\*\*”**

**8.1** Në deklaratën e interesave privatë periodikë/vjetorë të vitit 2008 është deklaruar zotërimi nga bashkëshorti i subjektit të 40% të aksioneve të shoqërisë “\*\*\*\*”, në vlerën 4,000,000 lekë.

**8.2** Në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2008, në deklaratat e tjera periodike vjetore (2010 – 2016) dhe në deklaratën *Vetting* subjekti nuk i ka deklaruar këto aksione në pronësi të bashkëshortit të saj.

**8.3** Lidhur me këtë mosdeklarim të aksioneve në deklaratën *Vetting* dhe mundësitë financiare të krijimit të pronësisë me 40% të aksioneve të shoqërisë “\*\*\*\*” në vlerën 4,000,000 lekë nga bashkëshorti, subjektit iu kërkuan sqarime.

**8.4** Në përgjigje të pyetësorit nr. \*\*\*, subjekti ka deklaruar<sup>21</sup>: *“Sjell në vëmendje se unë dhe bashkëshorti im kemi lidhur martesë ligjore më 29.1.2008, ndërkohë që jam dekretuar dhe kam filluar punë si prokurore në datën 6.11.2008.*

*Deklarata e interesave privatë përpara fillimit të detyrës është plotësuar nga ana ime në datën 2.12.2008 (një muaj pas marrjes së detyrës). Mosdeklarimi i vlerës së aksioneve në deklaratën përpara fillimit të detyrës nuk ka pasur për qëllim fshehjen e saj, por ka ardhur si pasojë e*

<sup>21</sup>Shihni përgjigjet e subjektit sipas pyetësorit nr. \*\*\*në dosjen e Komisionit.

*mungesës së njohurive mbi plotësimin e deklaratës së pasurisë (duke konsideruar këtu faktin se është deklarata e parë e plotësuar prej meje).*

*Në cilësinë e subjektit deklarues nga ana ime në mars 2009, është dorëzuar deklarata periodike/vjetore. Në këtë deklaratë, në rekuizitat e parashikuara nga ligji për t'u plotësuar nga bashkëshorti i subjektit deklarues, ky i fundit (plotësuar me shkrimin e tij) ka deklaruar: '...zotëroj 40% të aksioneve të shoqërisë '\*\*\*', regjistruar me vendimin e gjykatës nr. \*\*\* datë 14.5.2004, duke saktësuar se kjo shoqëri nuk kryhen aktivitetet që prej muajit maj 2007 dhe të ardhurat e saj janë 0 (zero)'.  
Shoqëria ka status pasiv që prej datës 6.5.2016.*

*Referuar legjislacionit tatimor të zbatueshëm deri në vitin 2006, specifikisht ligjit nr. 9920 datë 19.5.2008, 'Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë', respektivisht nenit 104 të tij, administrata tatimore ka pasur detyrimin ligjor për të kërkuar në gjykatë fillimin e procedurës së falimentimit për këtë shoqëri, pasi, sikurse rezultoi, shoqëria nuk ka kryer aktivitetet tregtar për një periudhë prej të paktën 2 vitesh nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.*

*Nga investimi që ai ka kryer në këtë shoqëri nuk ka pasur asnjë fitim.*

*Nën frymën e ligjit të sipërcituar, shoqëria duhet të ishte likuiduar që prej vitit 2007. Gjithsesi, statusi i kësaj shoqërie është pasiv prej datës 6.5.2016. Ka qenë kjo arsyeja që kjo pasuri nuk është deklaruar nga ana ime në deklaratat periodike vjetore, si dhe në deklaratën Vetting. Pra është pasuri pa asnjë fryt.*

*Theksoj se kjo është një pasuri individuale e bashkëshortit tim, e krijuar 4 vite përpara martesë (në vitin 2004), në një kohë që nga ana ime bashkëshorti nuk njihej, pasi, siç sqarova më sipër, martesa ligjore është lidhur në vitin 2008.*

*Në lidhje me burimin e kësaj pasurie, sqaroj se investimi nga ana e bashkëshortit tim në këtë shoqëri e ka burimin nga të ardhurat familjare të tij, të realizuara nga emigracioni i babait të tij, pavarësisht puna e kryer nga bashkëshorti im. Në vitin 1999 vjehri im ka pasur një mjet transporti autobus, me të cilin ka punuar linjën Fier-Tiranë. Ndërkohë që sipas shpjegimeve të bashkëshortit gjatë kësaj kohe ka bërë punë të ndryshme, duke menaxhuar ambiente lokale, por këto aktivitete nuk kanë qenë të regjistruara në organet tatimore.*

*Kodi i Familjes përcakton se çdo pasuri e fituar nga bashkëshortët gjatë martesës i nënshtrohet regjimit të bashkësisë ligjore (neni 74 I Kodit të Familjes), përfshi këtu edhe të ardhurat e secilit bashkëshort nëse nuk janë konsumuar deri në mbarimin e bashkëpronësisë. Nga ana tjetër, Kodi i Familjes përcakton edhe kuptimin e asaj pasurie që nuk i përket bashkësisë dhe që konsiderohet 'pasuri vetjake'. Si e tillë, në germën 'a' të nenit 77 përcaktohet edhe pasuria e cila përpara lidhjes së martesës ishte në bashkëpronësi të bashkëshortit me persona të tjerë ose kundrejt së cilës ai ishte titullar i një të drejte reale".*

**8.5** Bazuar në ekstraktin e QKB-së<sup>22</sup> shoqëria "\*\*\*\*" është krijuar në vitin 2004, ku 40% të aksioneve të shoqërisë në vlerën 4,000,000 lekë zotërohen nga bashkëshorti i subjektit.

**8.6** Bazuar në shkresën nr. \*\*\* prot., datë 1.11.2021, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, rezultoi se kjo shoqëri është regjistruar në datën 14.5.2004 dhe aktualisht është me status "pasiv" nga data 6.5.2016.

**8.7** Po sipas DRT-së Tiranë rezultoi se kjo shoqëri përveç vitit 2006 ka qenë me humbje dhe deklaruar pa aktivitet. Subjekti nuk ka deklaruar shuma të përfituara nga shoqëria "\*\*\*\*" dhe as pasuri të krijuar me burim nga të ardhurat e kësaj shoqërie.

<sup>22</sup>Shihni përgjigjet e QKB-së në dosjen e ILDKPKI-s1 dhe në dosjen e Komisionit.



**8.8** Komisioni pyeti subjektin e rivlerësimit për të provuar ligjshmërinë e burimit të kapitalit të shoqërive “\*\*\*” dhe “\*\*\*”, ku bashkëshorti i saj ka qenë ortak dhe administrator në këto shoqëri.

**8.9** Në përgjigje të pyetësorit<sup>23</sup>, subjekti deklaroi: “Shoqëria ‘\*\*\*’ sh.a. është themeluar në datën 14.5.2004, me kapital themeltar 10,000,000 lekë, nga të cilat 400 aksione me një vlerën nominale 4,000,000 lekë kanë qenë në zotërim të bashkëshortit tim. Investimi nga ana e bashkëshortit tim në këtë shoqëri e ka burimin nga të ardhurat familjare të tij, të realizuara nga emigracioni i babait të tij. Në lidhje me të ardhurat e krijuara nga emigracioni nga vjehri im T.M, gjendem në pamundësi për të siguruar dokumentacion. Kjo jo vetëm për faktin se ka kaluar një kohë shumë e gjatë, 20 vjet më parë (vitet 1992 - 1998), por edhe për shkak të faktit se shteti grek vetëm në vitin 1998 u krijoi mundësinë emigrantëve të legalizonin qëndrimin e tyre në Greqi, duke miratuar legjislacionin përkatës.

Kjo pasuri është krijuar përpara martesë nga bashkëshorti im (vitin 2004) dhe që nga momenti i lidhjes së martesës 29.1.2008 dhe në vijim unë nuk kam përfituar asnjë të ardhur nga kjo pasuri dhe mendoj se nuk mund të jap shpjegime në lidhje me veprime juridike në të cilat nuk kam qenë pjesë apo pasuri mbi të cilat unë nuk kam të drejta, nuk kam përfituar dhe nuk do të përfitoj ndonjëherë, kjo edhe sipas ligjit nr. 84/2016, ‘Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë’, i cili ka për objekt verifikimin e pasurive në pronësi, në përdorim ose në posedim të subjektit të rivlerësimit.

Ky është një investim jo vetëm i krijuar në një kohë që z. E.M nuk njihej nga ana ime, por që nuk ka sjell asnjë përfitim për bashkëshortin tim, si para martesë, ashtu edhe gjatë martesës dhe çfarë është më e rëndësishme nuk ka mundësi të sjell asnjë përfitim edhe në të ardhmen për bashkësinë ligjore (regjimi pasuror martesor sipas Kodit të Familjes)”.

#### **8.10 Konkluzione të Komisionit në rezultatet e hetimit**

- Pavarësisht statusit pasiv të kësaj shoqërie, krijimit të aksioneve para martesë nga bashkëshorti i subjektit apo para fillimit të detyrës si magjistrate, si dhe mospërfitimit të të ardhurave nga kjo shoqëri, subjekti dhe bashkëshorti kanë pasur detyrimin për deklarimin në deklaratën Vetting të kuotës prej 40% të aksioneve në shoqërinë “\*\*\*”.
- Subjekti nuk arriti të provojë mundësitë financiare të bashkëshortit për krijimin e kapitalit si ortak i shoqërisë “\*\*\*”, në vlerën 4,000,000 lekë.

**8.11** Për sa më sipër, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet dhe për të paraqitur provat për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**8.12** Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti parashtrroi<sup>24</sup>: “Është një pasuri e krijuar shumë kohë përpara martesës time me z. E.M dhe që në momentin e lidhjes së martesës ka qenë vetëm një titull.

Është një pasuri prej së cilës nuk është krijuar asnjë e ardhur për familjen tonë.

Mosdeklarimi në deklaratën Vetting prej bashkëshortit në cilësinë e personit të lidhur, i 40% të kuotave të aksioneve në shoqërinë \*\*\* (në emër të bashkëshortit tim) ka ardhur prej kuptimit që unë i kam bërë tagrave të disponimit në lidhje me këtë pasuri dhe nuk kam pasur si qëllim fshehjen e tyre, pasur parasysh që kjo shoqëri është deklaruar në DPV prej tij.

<sup>23</sup>Shihni përgjigjet e subjektit mbi pyetësorin nr. \*\*\* në dosjen e Komisionit.

<sup>24</sup>Shihni parashtrimet e subjektit lidhur me këtë pasuri në përgjigje të rezultateve të hetimit.

*Është një pasuri e cila për shkak të deklarimit me humbje në çdo vit ka status pasiv prej datës 6.5.2016 dhe në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, 'Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë', respektivisht nenit 104 të tij, administrata tatimore ka pasur detyrimin ligjor për të kërkuar në gjykatë fillimin e procedurës së falimentimit për këtë shoqëri, pasi sikurse rezulton shoqëria nuk ka kryer aktivitet tregtar për një periudhë prej të paktën 2 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji (neni 104, pikat 'c' dhe 'ç' të ligjit të sipërcituar).*

*Kjo shoqëri nuk ka më as seli, as zyra, as administrator, as punonjës në mënyrë që të mund të kërkonin falimentin apo të kryenin veprime në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Për këtë shkak vijon të mbetet në statusin pasiv deri në kohën që vet administrata tatimore të fillojë procedurat e falimentit të shoqërisë.*

*Kjo pasuri rezulton të jetë përtej kohës së bashkësisë ligjore dhe duke qenë se nuk ka sjellë asnjë përfitim apo shtim të pasurisë bashkëshortore gjatë martesës sime.*

*Nga të ardhurat e mia si subjekt jo vetëm që nuk është kontribuar në krijimin e kësaj pasurie, por as nuk është përfituar asnjë e ardhur.*

*Prej kohës që kam lidhur martesë e në vijim kjo pasuri as që nuk mund të konsiderohet më si e tillë, pasi ka mbetur vetëm një titull, për të cilin nuk disponohet më për arsye objektive të bashkëshortit tim dhe që lidhen me mosushtrimin e veprimtarisë ligjore nga organet e administratës tatimore”.*

## **Vlerësimi i Komisionit**

**8.13** Komisioni, pasi administroi përgjigjet e subjektit dhe provat e paraqitura në përgjigje të rezultateve të hetimit lidhur me këtë pasuri, vlerëson si vijon:

- Shoqëria “\*\*\*” është krijuar në vitin 2004 dhe bashkëshorti i subjektit ka pasur 40% të aksioneve në këtë shoqëri me vlerë 4,000,000 lekë.
- Shoqëria ku janë investuar këto aksione nuk ka pasur aktivitet që prej vitit 2007 dhe nuk ka gjeneruar të ardhura (vetëm viti 2006 ka gjeneruar të ardhura). Sipas konfirmimeve të institucioneve shtetërore<sup>25</sup> kjo shoqëri ka kaluar me status “pasiv” prej vitit 2016. Pavarësisht këtij fakti subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin ligjor (ligji nr. 84/2016) të deklaronte në deklaratën *Vetting* kuotat e bashkëshortit prej 40% në shoqërinë “\*\*\*”.
- Trupi gjykues gjithashtu vlerëson se veprimtaria tregtare e personit të lidhur (bashkëshortit të subjektit) nuk lidhet me subjektin e rivlerësimit dhe as me ushtrimin e detyrës së tij. Bashkëshorti i subjektit ka vepruar si tregtar në mënyrë të pavarur nga subjekti i rivlerësimit që nga momenti i krijimit të kësaj shoqërie në vitin 2004. Veprimet e kryera nga bashkëshorti i subjektit, të cilat, për më tepër, nuk kanë sjellë as përfitime në ekonominë e përbashkët familjare, nuk mund të përbëjnë shkak për marrjen e ndonjë mase disiplinore ndaj subjektit të rivlerësimit.
- Në këtë rast, subjekti i rivlerësimit nuk plotëson kushtet për ta konsideruar mosdeklarimin e transaksionit si fshehje të pasurisë, në kuptim të procesit të rivlerësimit, si dhe asnjë nga kushtet e tjera të parashikuara në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
- Në vlerësimin e trupit gjykues, referuar akteve të administruara në dosjen gjyqësore, veprimet financiare të kryera nga shoqëria ku bashkëshorti ka qenë aksioner, nuk kanë shërbyer për të krijuar të ardhura, pasuri ose detyrime për personin e lidhur, si dhe për vetë subjektin e rivlerësimit, për të cilat si subjekti, ashtu edhe personi i lidhur, të mbartin detyrimin për deklarimin e tyre në deklaratat e interesave privatë periodikë vjetorë, sipas

<sup>25</sup>Shihni të dhënat e konfirmuara nga QKB-ja dhe Drejtoria e Tatimeve në dosjen e Komisionit.

nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar.

- Investimi i kryer nga ana e bashkëshortit të subjektit në këtë shoqëri është deklaruar se e ka burimin nga të ardhurat familjare të tij.
- Subjekti ka deklaruar se në lidhje me të ardhurat e krijuara nga emigracioni gjendet në pamundësi objektive për të siguruar dokumentacion. Kjo jo vetëm për faktin se ka kaluar një kohë shumë e gjatë, 19 vjet më parë (vitet 1992 - 1998), por edhe për shkak të faktit se shteti grek vetëm në vitin 1998 u krijoi mundësinë emigrantëve të legalizonin qëndrimin e tyre në Greqi, duke miratuar legjislacionin përkatës që u njihte emigrantëve të drejtën për të aplikuar për atë që quhej “Kartë e bardhë”<sup>26</sup>.
- Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se në lidhje me burimin e ligjshëm të të ardhurave nga emigracioni jemi në kushtet e zbatimit të nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon se: *“Nëse subjekti i rivlerësimit është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, duhet t’i vërtetohet institucionit të rivlerësimit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër...”*.
- Nisur edhe nga fakti se kontributi i bashkëshortit të subjektit në këtë shoqëri ka qenë në vitin 2004 shumë kohë para martesë me subjektin e rivlerësimit, trupi gjykues nuk mund të penalizojë subjektin e rivlerësimit në kuadrin e procesit të rivlerësimit.

## **Konkluzion i Komisionit**

**8.14** Trupi gjykues vlerëson se problematikat të cilat lidhen me pasuritë e personit të lidhur të krijuara para martesës me subjektin e rivlerësimit nuk konsiderohen se mund të mjaftojnë si shkaqe objektive e proporcionale të vendosura në këtë proces për të ngarkuar drejtpërdrejt me masë disiplinore subjektin e rivlerësimit.

## **9. Gjetje të tjera**

**9.1** Komisioni konstatoi se në vitin 2017 subjekti ka deklaruar blerjen e një pasurie apartament me sip. 127.6 m<sup>2</sup>, në vlerën e 78,800 euro në qytetin e Tiranës. Për të provuar se çmimi i blerjes së kësaj pasurie nuk është çmim preferencial krahasuar me kontrata të ngjashme në të njëjtën zonë dhe nëse subjekti ka pasur ndonjë çështje penale me palën shitëse u pyet subjekti i rivlerësimit.

**9.2** Në përgjigje të pyetësorit<sup>27</sup>, subjekti deklaroi: *“Me kontratën e datës 10.3.2017 është porositur apartamenti në fjalë, ndërkohë kontrata e blerjes së kësaj pasurie është finalizuar sipas kontratës me datë 12.1.2018. Çmimi i blerjes së kësaj pasurie është përcaktuar të jetë 78,870 euro (10,537,032 lekë) dhe nuk është çmim preferencial.*

*Çmimi fiskal për zonën kadastrale nr. \*\*\* në vitin 2018 - 2019 ka qenë 80,000 lekë.*

*Në lidhje me këtë fakt unë po vendos në dispozicion kthim përgjigjen e datës 26.7.2022, të ASHK-së, bashkëlidhur saj janë vënë në dispozicion edhe 5 kontrata me çmim të përafërt me atë të apartamentit të blerë nga ana ime (më i ulët ose i njëjtë, konvertuar në euro dhe lekë sipas kohës kur janë lidhur kontratat).*

<sup>26</sup>Sipas një studimi të bërë në vitin 2004 nga UNECE (United Nations Economic Commission for Europe) nga 372,000 aplikime për t’u pajisur me kartën e bardhë me datë 31.5.1998, në dhjetor të vitit 1998 (pas 7 muajsh) vetëm 38,000 aplikantë e kishin përfutur atë, pra jo më shumë se 12% e aplikantëve.

<sup>27</sup>Shihni përgjigjet e subjektit mbi pyetësorin nr. \*\*\* në dosjen e Komisionit.

*Në përgjigje të pyetësorit nr. \*\*\* ju kam vënë në dispozicion vërtetim nga Prokuroria Tiranë, ku provohet se unë nuk kam trajtuar asnjë çështje me palën shitëse të apartamentit.*

*Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 26.7.2022, informon se nga ana ime në cilësinë e prokurores për periudhën kohore 2016 – 2022 nuk është ndjekur asnjë material kallëzues apo procedim me palët përfituese shitëse të apartamentit, si dhe ato të legalizimit”.*

**9.3** Komisioni konstatoi se çmimi eventual për apartamentin e blerë në Tiranë është preferencial. Provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit tregojnë një çmim referencë prej 80,000 lekësh/m<sup>2</sup>; ndërsa çmimi i aplikuar për subjektin e rivlerësimit është 550 euro/m<sup>2</sup> (78,870 euro për 127.6 m<sup>2</sup> + 15.8 m<sup>2</sup> hapësira të përbashkëta), i konvertuar në 73,150 lekë/m<sup>2</sup>.

### **Konkluzione të Komisionit në rezultatet e hetimit**

**9.4** Subjekti duhet të provojë bindshëm lidhur me këtë çmim preferencial të përfituar për blerjen e pasurisë apartament në qytetin e Tiranës.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**9.5** Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti parashtroi: *“Konstatimi se çmimi i blerjes së apartamentit është preferencial, mendoj se nuk qëndron, pasi në përlllogaritjen e bërë gabimisht është përfshirë edhe sipërfaqja e përbashkët.*

*Kam vënë në dispozicionin tuaj 5 kontrata të administruara nga ASHK-ja me çmim të përafërt me atë të apartamentit të blerë nga ana ime.*

*Sqaroj se si unë edhe bashkëshorti im nuk kemi njohje me palën shitëse të apartamentit dhe as me përfituesit e legalizimit dhe nuk kam ndjekur ndonjë çështje penale me palën shitëse të apartamentit, si dhe palët përfituese të lejes së legalizimit”.*

### **Vlerësimi i Komisionit**

**9.6** Komisioni, pasi administroi përgjigjet e subjektit dhe provat e paraqitura në përgjigje të rezultateve të hetimit lidhur me këtë pasuri, vlerëson si vijon:

- Trupi gjykues, bazuar në përgjigjen e prokurorisë<sup>28</sup>, konstatoi se subjekti nuk ka ndjekur asnjë çështje penale me palë kallëzuese ose të kallëzuar, palët shitëse të apartamentit, si dhe palët përfituese të lejes së legalizimit.
- Çmimi i shitjes së apartamenteve përcaktohet në marrëveshje midis palëve në vullnetin e tyre të lirë.
- Trupi gjykues, bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit në përgjigje të rezultateve të hetimit, konstatoi se çmimi i aplikuar në kontratën për pasurinë e mësipërme nuk është më i vogël se çmimi fiskal i përcaktuar në atë zonë dhe se në atë objekt rezultuan shitje të pasurive të tjera me vlerë të përafërta me çmimin e blerjes nga subjekti.

### **Konkluzion i Komisionit**

**9.7** Në përfundim të sa më sipër, trupi gjykues nuk konstatoi problematika lidhur me pasurinë apartament me sip. 127.6 m<sup>2</sup>, blerë në vlerën 78,800 euro në qytetin e Tiranës.

---

<sup>28</sup>Shihni përgjigjen e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë në dosjen e Komisionit.

## **10. Analiza financiare**

**10.1** Komisioni, bazuar në të dhënat, dokumentacionin dhe provat e administruara në dosjen e tij dhe praktikën e ardhur nga ILDKPKI-ja, hartoi analizën financiare për subjektin Mariola Mërtiri.

**10.2** Nga analiza financiare, për periudhën 2008 – 2016, dukej se subjekti dhe bashkëshorti kishin një pamjaftueshmëri financiare totale në vlerën -1,636,716 lekë për shtimin e pasurisë dhe mbulimin e shpenzimeve të tjera nga fillimi i detyrës deri në fund të periudhës së rivlerësimit. Kjo pamjaftueshmëri erdhi si rezultat i mosnjohjes së dhurimeve të bëra ndaj subjektit deri në këtë fazë hetimi të Komisionit.

**10.3** Në përfundim të hetimit, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet dhe paraqitur provat e saj për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga ana e Komisionit për analizën financiare, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**10.4** Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti parashtroi: *“Bashkëngjitur gjeni analizën financiare.*

*Në këtë analizë financiare, pas argumenteve dhe shpjegimeve të dhëna në lidhje me mundësinë financiare të personave të tjerë të lidhur për dhuratat, janë përfshirë si burime të ligjshme dhuratat, duke besuar që nga ana juaj do të merren në konsideratë.*

*Zërat e tjerë në analizën financiare nuk janë prekur, duke qenë të njëjtë me ato të paraqitura nga ana e Komisionit”.*

### **Vlerësimi i Komisionit**

**10.5** Komisioni hartoi analizën financiare për të gjithë periudhën e rivlerësimit të subjektit Mariola Mërtiri (10.11.2008 – 31.12.2016).

Subjekti i rivlerësimit: MARIOLA J. MËRTIRI										
PËRSHKRIMI	10.11.08 - 31.12.08	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	TOTAL
<b>PASURI</b>	<b>4,948,736</b>	<b>-385</b>	<b>26,213</b>	<b>4,469,179</b>	<b>179,004</b>	<b>317,621</b>	<b>-171,510</b>	<b>1,663,486</b>	<b>141,036</b>	<b>11,573,379</b>
Apartament 83.88 m2, Lagja ***Fier - 2012 - 50%				4,500,000						4,500,000
Automjeti tip Audi **** - 4.800 euro - 2004 - E. M.	608,352									608,352
Automjet tip "Ford Fiesta" - **** - 2008 Mariola Mertiri	400,000									400,000
Zotëroj 40% të aksioneve të shoqërisë "****", - 4.000.000 leke - E.M.	4,000,000									4,000,000
										0
<b>Ndryshim ne likuiditet</b>	<b>-59,616</b>	<b>-385</b>	<b>26,213</b>	<b>-30,821</b>	<b>179,004</b>	<b>317,621</b>	<b>-171,510</b>	<b>1,663,486</b>	<b>141,036</b>	<b>2,065,027</b>
Kredi tek BKT - 2,240,000 leke - 2011				2,211,125	-82,922	-86,218	-88,855	-91,422	-94,087	1,767,621
Kredi e marrë te RBAL - 400.000 leke - 2008	-11,955	-72,018	-92,417	-212,005						-388,394
Kredi e marrë te RBAL, - 59.900 leke - 2011				50,383	-50,383					0
Kredi e marrë te RBAL, - 31.900 leke 2012					26,583	-26,583				0
Kredi pranë Institutit NOA - 350.000 leke - 2011				343,989	-90,550	-116,495	-136,944			0
Kredi e marrë te RBAL - 72.900 leke - 2014							18,461	-18,461		0
<b>DETYRIME</b>	<b>-11,955</b>	<b>-72,018</b>	<b>-92,417</b>	<b>2,393,492</b>	<b>-197,271</b>	<b>-229,297</b>	<b>-207,338</b>	<b>-109,883</b>	<b>-94,087</b>	<b>1,379,227</b>
<b>PASURI NETO (PASURI - DETYRIME)</b>	<b>4,960,691</b>	<b>71,633</b>	<b>118,629</b>	<b>2,075,687</b>	<b>376,275</b>	<b>546,917</b>	<b>35,828</b>	<b>1,773,369</b>	<b>235,123</b>	<b>10,194,152</b>
<b>TE ARDHURA dokumentuar</b>	<b>5,158,222</b>	<b>848,322</b>	<b>1,585,989</b>	<b>3,586,028</b>	<b>2,470,989</b>	<b>2,005,977</b>	<b>2,710,055</b>	<b>2,990,436</b>	<b>2,591,682</b>	<b>23,947,700</b>
Te ardhura nga pagat subjekti	127,207	790,721	1,005,735	1,022,483	1,431,129	1,290,917	1,202,803	1,401,331	1,242,598	9,514,924
Te ardhura nga pagat bashkeshorti		57,601	580,254	303,545	1,039,860	715,060	1,507,252	1,539,006	1,349,084	7,091,662
Te ardhura nga pasuri paramartesore bashkeshorti dhe pasuri para detyre subjekti	5,031,015									5,031,015
Të ardhura nga shitja për skrap të mjeteve Ford me targë .****								50,099		50,099
Dhurim nga babai i bashkeshortit T. M. - 2011				1,260,000						1,260,000
Dhurim nga vëllai i bashkeshortit M.M.- 2011				1,000,000						1,000,000
<b>SHPENZIME</b>	<b>165,566</b>	<b>450,842</b>	<b>635,522</b>	<b>887,057</b>	<b>846,216</b>	<b>839,854</b>	<b>909,520</b>	<b>1,029,094</b>	<b>1,538,380</b>	<b>7,302,052</b>
Shpenzime interesa kredie pranë BKT				20,980	66,799	64,700	61,011	59,133	54,205	326,828
Shpenzime interesa kredie pranë RBAL vlera e kredise 400.000 leke	11,511	57,602	50,357	22,768						142,239
Shpenzime interesa kredie pranë RBAL vlera e kredise 59.900 leke				1,568	4,743					6,311
Shpenzime interesa kredie pranë RBAL vlera e kredise 72.900 leke							5,083	482		5,565
Shpenzime interesa kredie pranë NOA				16,089	78,650	52,705	18,503			165,947
Shpenzime per arsimimin e fëmijëve				5,792	13,121	17,983	35,702	72,375	135,375	280,348
Shpenzime per elektroshtepiake	99,900		135,000	300,000	170,000		72,900			777,800
Shpenzime qiraje E. M.	20,000	120,000	120,000	110,000					192,000	562,000
Shpenzime jetese	34,155	273,240	330,165	409,860	418,644	423,072	696,660	897,104	940,368	4,423,268
Shpenzime udhëtimi					94,259	281,394	19,661		216,432	611,746
<b>Analiza dokumentuar</b>	<b>31,965</b>	<b>325,847</b>	<b>831,838</b>	<b>623,284</b>	<b>1,248,498</b>	<b>619,205</b>	<b>1,764,707</b>	<b>187,973</b>	<b>818,180</b>	<b>6,451,496</b>
										<b>0</b>
									<b>Pamundësia financiare totale</b>	<b>0</b>

**10.6** Nga analiza financiare rezulton se subjekti dhe bashkeshorti e saj kishin burime të ligjshme të mjaftueshme për shtimin e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, shtimin e likuiditeteve dhe mbulimin e shpenzimeve për periudhën e rivlerësimit (10.11.2008 – 31.12.2016).

## 11. Metodologjia e përdorur nga Komisioni për analizën financiare

Gjatë kësaj analize, Komisioni është bazuar në:

a. Gjendjet e likuiditeteve të subjektit dhe personave të lidhur, të nxjerra nga dokumentet bankare të kërkuara nga bankat e nivelit të dytë: BKT, “Raiffeisen Bank”, “Credins Bank”, “Tirana Bank”, “Intesa Sanpaolo Bank”, si dhe gjendjet *cash* të deklaruara nga subjekti.

b. Të ardhurat e ligjshme, ku përfshihen:

- i) të ardhurat nga pagat e subjektit në Shkollën e Magjistraturës (2006 - 2008), si prokurore në Prokurorinë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier (2008 - 2009) dhe (2012 - 2016), si prokurore në Prokurorinë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë (2009 - 2012), si prokurore në Prokurorinë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (2016), si dhe nga raporte barrëindjeje dhe shpërblim lindjeje (2010 dhe 2014 - 2015);
- ii) të ardhurat nga bashkëshortit të subjektit tek Agjencia e Trajtimit të Pronave (2009 - 2010), tek Ujësjellës-Kanalizime Fier (2010 - 2013), tek shoqëria “\*\*\*\*” (2013 - 2016), si dhe nga vendimi i gjykatës nr. \*\*\*/\*\*\*, datë 3.10.2012 (2012);
- iii) të ardhurat nga pasuri paramartësore nga bashkëshorti dhe pasuri para detyre;
- iv) të ardhura nga shitja për skrap të automjetit tip “\*\*\*\*”, me targa FR \*\*\* (2015);
- v) të ardhurat nga dhurimet e deklaruara nga subjekti në vitin 2011 nga babai i bashkëshortit T.M dhe vëllai i bashkëshortit M.M.

c. Shpenzimet, ku përfshihen:

- i) shpenzimet e jetesës bazuar në shpenzimet mujore për konsum sipas madhësisë së familjes (anketa e buxhetit të familjes nga INSTAT);
- ii) shpenzime për blerje pajisje elektroshtëpiake (2008, 2010 - 2012, 2014), sipas deklarimit të subjektit në përgjigje të pyetësorit standard dhe provave dokumentare të kontratave të kredive;
- iii) shpenzime qiraje për vitet 2008 - 2011 dhe vitin 2016, sipas deklarimit të subjektit në përgjigje të pyetësorit standard;
- iv) shpenzimet e arsimimit të fëmijëve të subjektit (2011 - 2016), sipas deklarimit të subjektit në përgjigje pyetësorit;
- v) shpenzime interesi dhe komisione, si dhe për shlyerje principali për kreditë e marra nga subjekti në BKT, “Raiffeisen Bank” dhe NOA, sipas vërtetimeve dhe *statement*-eve bankare përkatëse;
- vi) shpenzime udhëtimi për të cilat janë marrë të dhëna nga sistemi TIMS. Për përlllogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit është zbatuar vendimi nr. 11/2019(JR), datë 22.5.2019, i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Nuk janë marrë në konsideratë shpenzimet e udhëtimit kur subjekti/bashkëshorti kanë deklaruar dhe dokumentuar udhëtime për qëllime pune dhe ato për të cilat janë dokumentuar qëndrim pranë njerëzve të afërm.

ç. Vlerat e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, bazuar në kontratat e sipërmarrjeve/shitblerjeve të këtyre pasurive<sup>29</sup>.

## B. KONTROLI I FIGURËS

1. DSIK-ja, si institucioni kompetent për kontrollin e figurës, me qëllim përcaktimin nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me krimin e organizuar, pasi ka kryer të gjitha procedurat për kontrollin në përputhje me nenin 4, pika 4 dhe nenet 37 dhe 38 të ligjit nr.

<sup>29</sup>Shihni kontratat e shitjeve për pasuritë e paluajtshme në dosjen e ILDKPKI-së.

84/2016, ka paraqitur pranë Komisionit raportin përfundimtar me nr. \*\*\* prot., datë 31.10.2017, për subjektin Mariola Mërtiri, ku rezulton se:

- formulari i deklaramit është i plotë dhe i plotësuar në përputhje me ligjin nr. 84/2016;
- subjekti i rivlerësimit ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara në deklaratën për kontrollin e figurës;
- për subjektin e rivlerësimit nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose persona të dyshuar të krimit të organizuar;
- konstatohet se subjekti i rivlerësimit Mariola Mërtiri është i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.

Për pastërtinë e figurës nuk ka pasur të dhëna dhe dyshime bazuar në raportin e DSIK-së.

Komisioni, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 1.12.2021, i kërkoi DSIK-së përditësimin dhe deklasifikimin e raportit të figurës për subjektin Mariola Mërtiri.

Në datën 24.1.2022 është paraqitur raporti i deklasifikuar i DSIK-së (deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. \*\*\*, datë 21.1.2022, të KDZH-së), ku konstatohet përshtatshmëria për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Mariola J Mërtiri.

### **Hetimi i Komisionit**

Komisioni, në kuadrin e vlerësimit të figurës së subjektit Mariola Mërtiri, kreu një hetim të plotë administrativ.

Komisioni, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 30.5.2022, i kërkoi Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) informacion lidhur me ndonjë procedim penal të mundshëm ndaj shtetasve M.M dhe S.G (persona të tjerë të lidhur me subjektin edhe si dhurues të shumave financiare). Kjo kërkesë është bërë për të vlerësuar përfshirjen e këtyre personave në veprimtari kriminale, kontaktet e mundshme të subjektit me këto persona, pasi rezulton se z. M.M është edhe kunati i subjektit të rivlerësimit dhe znj. S. G është bashkëjetuesja e z. M. M.

SPAK, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 2.6.2022, ka dërguar informacion, ku rezultoi se:

- Në lidhje me shtetasin M. T. M, i datëlindjes 8.8.1978, pas verifikimeve të kryera në regjistrin e njoftimit të veprave penale të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, nuk rezulton të jetë regjistruar si person nën hetim deri aktualisht.
- Në datën 21.5.2021 është regjistruar emri i shtetasës S.F.G, e datëlindjes 18.1.1980, për veprën penale të parashikuar nga nenet 245 e 25 dhe 287, gërmat “a” dhe “b” të Kodit Penal, e kryer në rrethanën cilësuese “në bashkëpunim”, sipas nenit 287, paragrafi 2 i Kodit Penal. Njoftimi publik i faktit që ka shtetas nën hetim në lidhje me këtë procedim është bërë në datën 14.12.2021.

Komisioni, bazuar në gjetjet e vëzhguesit ndërkombëtar<sup>30</sup> lidhur me kriterin e figurës për subjektin Mariola Mërtiri, konstatoi:

#### **1.1 Mosdeklarimi i kontaktit të papërshtatshëm në formularin e DSIK-së**

- a. Në përgjigjet e saj gjatë hetimit, subjekti ka depozituar informacionin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier për çështje eventuale të lidhura me konfliktin e interesit. Subjekti ka depozituar përgjigjen e Prokurorisë, ku evidentohet se subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në prill të vitit 2015 kërkesën për t’u përjashtuar nga procedimi penal nr. \*\*\*/2012 ndaj

<sup>30</sup>Shihni të plota gjetjet e vëzhguesit ndërkombëtar të datave 15.7.2022 dhe 6.10.2022.



shtetasit V.Z/A.G dhe familjarëve të tij. Subjekti shpjegoi se në vitin 2012, z. Z i ka shitur bashkëshortit të saj apartamentin me sip. 95 m<sup>2</sup> në Fier. Shtetasi V. Z/A. G dhe familjarët e tij po hetoheshin për transaksione të dyshimta dhe veprimtari kriminale jashtë vendit, duke krijuar të ardhura të cilat investoheshin më pas nëpër biznese në Shqipëri. Procedimi penal nr. \*\*\*/2012 u regjistrua mbi akuzën “pastrim të produkteve të veprimtarisë kriminale”, sipas nenit 287 të Kodit Penal.

- i) Sipas vendimit nr. \*\*\* (\*\*\*) të Gjykatës së Lartë, V.Z/A.G është dënuar 3 herë në Itali së paku që prej vitit 2004, për veprat penale “prostitucion” dhe “pjesëmarrje në organizatë kriminale, me qëllim trafikimin e lëndëve narkotike”. Z. Z u arrestua në Fier më 20.1.2014, ndërkohë që ishte në kërkim ndërkombëtar. Sipas të njëjtit vendim të Gjykatës së Lartë, z. Z u ekstradua në Itali më 3.7.2014.
  - ii) Subjekti nuk e ka deklaruar kontaktin e saj me z. Z në formularin e DSIK-së që u depozitua në funksion të procesit të rivlerësimit.
- b. Për më tepër, aktet e procedimit penal nr. \*\*\*/2012 i referohen pjesëtarëve të tjerë të familjes së shtetasit A.G/Z, si persona të përfshirë në këtë çështje (periudha e referimit 2009 – 2012), si vijon:
- i) shtetasi R. G, i dënuar në Belgjikë në vitin 2009 për “shfrytëzim prostitucioni”, “pjesëmarrje në krimin e organizuar”, etj.;
  - ii) shtetasi O.G, vëllai i shtetasit R.G, që ka llogari bankare të dyshimta dhe të pajustificuara me këtë të fundit dhe shtetasin E. B, si dhe pasuri të pashpjeguara;
  - iii) shtetasi E.B (kunati i shtetasit A.G/Z), i cili ka nënshkruar kontratën e sipërmarrjes me bashkëshortin e subjektit në vitin 2011 për apartamentin me sip. 95 m<sup>2</sup>.
- c. Subjekti ka deklaruar se ajo ka marrë një apartament me qira nga shtetasi M. B në harkun kohor nëntor 2008 – dhjetor 2011.

## 1.2 Kontakte të papërshtatshme faktike

**1.2.1** Subjekti dhe bashkëshorti i saj kanë lidhje të hershme familjare dhe biznesi – direkte ose të tërthorta me anë të familjarëve ose krushqisë (M.M, M.M, T. M) – me shtetasit S.G, K.Z dhe A.M, së paku që prej vitit 2004, vitit 2007, vitit 2010 dhe më pas.

- Shtetasit S.G, K.Z dhe A.M dhe shoqëritë e themeluara/në pronësi/në administrim të tyre që prej vitit 2014, si: “\*\*\*\*” sh.p.k., “\*\*\*\*” (\*\*\*) sh.p.k., “\*\*\*\*” (\*\*\*) Fier) sh.p.k., po hetohen nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK) që prej korrikut dhe nëntorit të vitit 2020 në kuadër të së ashtuquajturës “afëra e inceneratorëve” (shihni shtojcën bashkëlidhur). Kjo përfshirje është denoncuar nga deputetët dhe mediat të paktën që në vitin 2018<sup>31</sup> dhe ka marrë vlefshmëri edhe më të madhe që prej qershorit të vitit 2020 kur këto subjekte janë kallëzuar penalisht<sup>32</sup> për përfshirje në veprimtari të paligjshme të lidhura me inceneratorët dhe të hetuar zyrtarisht nga SPAK që në maj-dhjetor 2021. Më konkretisht:

- Shtetasja S.G është person tjetër i lidhur me subjektin që i ka dhënë hua subjektit shumën 1,000,000 lekë në vitin 2011 nëpërmjet kunatit të saj M.M. Është deklaruar se të ardhurat e kësaj huaje vijnë nga punësimi në disa shoqëri të themeluara/me pronar dhe/ose me administrator shtetasit S.G, M.M dhe E.M, përfshirë shitjen e aksioneve të shoqërisë “\*\*\*\*”

<sup>31</sup>Shihni *linkun*: (\*\*\*) Deputetja T akuza Ministrisë së Energjetikës për inceneratorët – YouTube, fjalimi i deputetes në shkurt të vitit 2018 gjatë seancës plenare për aferën e inceneratorëve në përgjithësi, përfshirë edhe inceneratorët e Fierit dhe Elbasanit, si dhe K.Z dhe shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k.; shihni edhe *linkun*: PD thërret Gj në interpelancë: kompania e inceneratorëve e regjistruar në Parajsat Fiskale - Lapsi.al, e botuar në shkurt të vitit 2018.

<sup>32</sup>Shihni *linkun*: Nisma “\*\*\*\*” kallëzim penal në SPAK për inceneratorin e Fierit - \*\*\* (\*\*\*.com), e datës 24.6.2020; Nisma “\*\*\*\*” kallëzon në SPAK aferën për inceneratorët – \*\*\* e datës 24.6.2020; Nisma “\*\*\*\*” kallëzim në SPAK për koncesionin e inceneratorit të Fierit - \*\*\* Shpjegon Shqipërinë; Nisma “\*\*\*\*” kallëzim në SPAK; qeveria e kompromentuar në falsifikimin e dokumenteve - Gazeta \*\*\* Online, e datës 24.6.2020.

sh.p.k. nga S.G në vitin 2007. Bashkëshorti i znj. S.G është z. M.M<sup>33</sup>, por çka është më e rëndësishme është se të dy kanë zhvilluar marrëdhënie të ngushta biznesi me anë të themelimit, administrimit, punësimit ose ndërveprimit përmes disa shoqërive të përfshira drejtpërdrejt ose tërthorazi me shoqëritë e inceneratorëve, përkatësisht: “\*\*\*\*” sh.p.k.; “\*\*\*\*” sh.p.k.; “\*\*\*\*” sh.p.k.<sup>34</sup>; dhe “\*\*\*\*” sh.p.k.

- Shtetasit S.G, M.M dhe E.M kanë bashkëthemeluar dhe bashkadministruar disa shoqëri në kuadrin kohor 2003 – 2012 (si: “\*\*\*\*” sh.a., “\*\*\*\*” sh.a., “\*\*\*\*” sh.p.k. – shihni shtojcën).

- Shtetasi A.M ka qenë në vijueshmëri ortak me shtetasit S.G, M.M dhe K. Z, kryesisht tek “\*\*\*\*” sh.p.k.<sup>35</sup> (që prej vitit 2007) dhe tek “\*\*\*\*” sh.p.k. (që prej tetorit të vitit 2016), ku ka qenë administrator i shoqërisë<sup>36</sup>.

- Konstatohet se shtetasi K.Z është:

- ortak i ngushtë biznesi me shtetasit M. M, S.G (nëpërmjet “\*\*\*\*” sh.p.k., “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe “\*\*\*\*” sh.p.k., “\*\*\*\*” sh.p.k.) dhe A.M (nëpërmjet “\*\*\*\*” sh.p.k., etj.);
- punëdhënës i vjehrrit T.M në periudhën 2011 – 2014 nëpërmjet shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe i kunatit tjetër M.M në periudhën shtator 2016 – qershor 2013<sup>37</sup>;
- i përfshirë aktivisht tek shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe (tek shoqëria holandeze) “\*\*\*\*”<sup>38</sup> (kompania mëmë e “\*\*\*\*” sh.p.k.), si vijon:
  - “\*\*\*\*” sh.p.k. në pronësi 100% të shtetasit K. Z dhe i menaxhuar nga shtetasi M.M në periudhën shtator 2016 – janar 2022<sup>39</sup> shfaqet si një nga ortakët e “\*\*\*\*”;
  - “\*\*\*\*” sh.p.k. duket se është një nga subjektet e para që i paraqesin propozimin autoriteteve shqiptare për sa i përket projektit të menaxhimit të mbetjeve në Tiranë<sup>41</sup>;
  - “\*\*\*\*” sh.p.k. është shoqëria zbatuese/nënkontraktor i “\*\*\*\*” sh.p.k. bashkë me “\*\*\*\*” sh.p.k.<sup>42</sup>;
  - bashkëshorti i subjektit është i punësuar nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. prej vitit 2018, në dukje në një nga nivelet më të larta drejtuese të shoqërisë<sup>43</sup>.

<sup>33</sup>Subjekti ka deklaruar se shtetasit G dhe M.M janë martuar në kishë.

<sup>34</sup>Sipas dëshmisë së administratores të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. shtetasja A.K, para komisionit parlamentar për “afërën e inceneratorëve”, S.G and “\*\*\*\*” sh.p.k. u nënkontraktuan nga shoqëria. Me tej, mediat raportojnë se shtetasi M. M ka prezantuar dhe negociuar për “\*\*\*\*”, kompaninë mëmë të “\*\*\*\*” sh.p.k., në periudhën prill 2019 – dhjetor 2021 për bizneset jashtë vendit:

[Ekskluzive-Tentakulat e inceneratorëve nuk ndalen/K.Z shfaqet në Irak. Shqipëria shitet si “sukses” - Denoncim \(cna.al\)](#)

<sup>35</sup>Shtetasi A.M ka blerë aksione nga shtetasja S.G për rreth 13,000,000 lekë (shihni dosjen e hetimit të Komisionit).

<sup>36</sup>Janë konstatuar lidhje të tjera midis shtetasve A.M, M.M and K.Z, nëpërmjet: (i) “\*\*\*\*” sh.p.k., me pronësi 30% nga “\*\*\*\*” sh.p.k. (përfshirë M.M); 24% nga “\*\*\*\*” sh.p.k.; 35% nga shtetasja E.M (bashkëshortja e A.M); “\*\*\*\*” sh.p.k. administrohet nga shtetasi P.A, anëtar i bordit drejtues të “\*\*\*\*” sh.a.; (ii) shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. e themeluar nga shtetasi K.Z, i cili i shet aksionet e veta shtetasit A.M në vitin 2013. Shoqëria “\*\*\*\*” zotëron 30% të aksioneve të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., kjo e fundit e themeluar nga shtetasi K.Z në vitin 2011.

<sup>37</sup>M.M ka punuar edhe për: (i) “\*\*\*\*” sh.p.k. (sot “\*\*\*\*” sh.p.k.) në periudhën maj 2014 – shtator 2016. Kjo shoqëri u themelua më 5.2.2014 nga shtetasja I.Z, bashkëshortja e shtetasit K. Z; (ii) “\*\*\*\*”, në periudhën prill 2016 – korrik 2016. Kjo shoqëri u themelua në prill të vitit 2016. Shtetasja S.G kishte 40% të aksioneve, ndërsa shtetasi M.M ishte administrator i shoqërisë.

<sup>38</sup>Shihni [linkun](#) ku shtetasi K.Z shfaqet si drejtor i shoqërisë “\*\*\*\*” (sot “\*\*\*\*”) në periudhën gusht 2016 – mars 2018: [1639488056m\\_merged.png \(1897x1588\) \(opencorporates.al\)](#). Sipas këtyre të dhënave, shoqëria “\*\*\*\*” është regjistruar në Holandë më 19.8.2016, në të njëjtën datë kur shtetasi K. Z mori detyrën si drejtor i shoqërisë.

<sup>39</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 21.6.2022, të ISSH-së dhe ekstraktin historik të shoqërisë. Të dhënat e ISSH-së shfaqin një pagë shumë të lartë të shtetasit M. M, prej 454,505 lekësh/muaj, në krahasim me pagën mesatare të referencës, që tregon një pozicion të caktuar brenda shoqërisë.

<sup>40</sup>Shihni [linkun](#) për shkresën së “\*\*\*\*” drejtuar Ministrisë të Mjedisit në datën 31.8.2016: [\\*\\*\\*INCENERATORI I TIRANES DOSJA \\*\\*\\* \(dragged\) \\*\\*\\*.pdf \(opencorporates.al\)](#)

<sup>41</sup>Shihni [linkun](#): [\\*\\*\\*INCENERATORI I TIRANES DOSIA 1 \(dragged\) 8.pdf fonencorporates.al](#)

<sup>42</sup>Shihni dëshminë e shtetasit A.K para Komisionit Hetimor Parlamentar për afërën e inceneratorëve.

<sup>43</sup>Të dhënat e ISSH-së tregojnë një pagë të lartë të bashkëshortit tek shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., rreth 390,000 lekë/muaj. Në periudhën 2018 - 2019 ai ka qenë i punësuar edhe tek shoqëria shtetërore “\*\*\*\*” sh.a. Më tej, sipas mediave, në mars të vitit 2022 SPAK nxori urdhër-arrestin për shtetasin A.K, në cilësinë e saj si administratore e shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe për shtetasin F.M, i raportuar si drejtor i “\*\*\*\*” sh.a., i përfshirë në komisionin e prokurimit për inceneratorin e Fierit: [Arrestimet për afërën e Inceneratorëve/ Kush është A.K dhe pse dëshmia e saj nuk e bindi SPAK-un - G Sh Online](#).

- Për më tepër:

- Sipas të dhënave të Institutit të Sigurimeve Shoqërore (SII), shtetasja S.G ka qenë e punësuar nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. në periudhën prill 2013 – mars 2015, ndërkohë që drejtonte shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k. që në nëntor të vitit 2014.
- SPAK referon se shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., përveçse aksionerja më e madhe e “\*\*\*\*” sh.p.k. (me 70% të aksioneve), është (gjithashtu) shoqëria zbatuese/nënkontraktore e saj<sup>44</sup>.
- SPAK referon se shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. është shoqëria zbatuese/nënkontraktore e shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.
- Sipas të dhënave nga sistemi TIMS, shtetasit S.G, K.Z dhe A.M janë deklaruar në kërkim nga policia, në kuadër të hetimit të SPAK-ut.
- Të dhënat nga sistemi TIMS tregojnë se shtetasi M.M është larguar nga Shqipëria në shkurt të vitit 2022, ndërsa shtetasja S.G është larguar në tetor të vitit 2021.

**1.2.2** Përveç angazhimit të hershëm, të ngushtë e të vazhdueshëm me personat dhe shoqëritë e përmendura më lart në aktivitete biznesi, subjekti dhe bashkëshorti i saj kanë përdorur automjetet e shtetasve A. M dhe K. Z gjatë viteve 2019 - 2020, përkatësisht automjetin me targa AA \*\*\*, në pronësi të shtetasit A.M në datën 23.1.2019 dhe automjetin me targa TR \*\*\*, në pronësi të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. në datën 27.12.2020<sup>45</sup>.

Sipas të dhënave nga sistemi TIMS rezultoi se subjekti dhe bashkëshorti i saj kanë përdorur për udhëtime jashtë vendit automjetet me targa AA \*\*\* dhe TR \*\*\*.

Për këtë konstatim u pyet subjekti lidhur me qëllimin e përdorimit të këtyre automjeteve, si dhe lidhjen me pronarët e këtyre pasurive.

Në përgjigje të pyetësorit<sup>46</sup>, subjekti deklaroi: *“Në datën 23.1.2019, unë, së bashku me shtetaset S.L, prokurore në Tiranë dhe A.A, punonjëse në Ministrinë e Jashtme, kemi udhëtuar në drejtim të Malit të Zi, me qëllim për të marrë pjesë në aktivitetin e zhvilluar në datat 24-25 janar 2019 nga \*\*\*, në Podgoricë, me temë ‘\*\*\*\*’. Në drejtim të Malit të Zi kemi udhëtuar me mjetin me targa AA \*\*\*, mjet i cili i përkiste të njohurit të bashkëshortit tim, shtetasit D.Y. Sqaroj se unë nuk e kam përdorur personalisht në asnjë rast mjetin e sipërcituar, por vetëm kam udhëtuar si pasagjere, në datën 23.1.2019.*

*Mjeti me targa TR \*\*\* ka qenë në përdorim nga kompania ‘\*\*\*\*’ sh.p.k., ku bashkëshorti ka qenë i punësuar. Unë nuk kam dijeni dhe nuk e njoh pronarin e mjetit. Jam në dijeni që mjeti është përdorur nga bashkëshorti si mjet pune, i dhënë nga kompania ‘\*\*\*\*’ sh.p.k., Tiranë. Në lidhje me këtë fakt, unë po ju vë në dispozicion vërtetimin me nr. \*\*\* prot., datë 25.7.2022, të lëshuar nga kjo kompani, nëpërmjet të cilit vërtetohet se si rrjedhojë e marrëdhënies së nënkontraktimit me kompaninë ‘\*\*\*\*’ sh.p.k., kompania ‘\*\*\*\*’ sh.p.k., krahas të tjerash, ka pasur në përdorim nga shoqëria ‘\*\*\*\*’ sh.p.k. prej datës 1.11.2017 deri në datën 29.3.2022, edhe mjetin e llojit ‘\*\*\*\*’, modeli \*\*\*, me targa TR \*\*\*”.*

<sup>44</sup>Shihni *linkun*: NJOFTIM-Spak.al, datë 29.3.2022. SPAK njofton se hetimi konstatoi se shoqëritë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe “\*\*\*\*” sh.p.k. kanë prerë mandatpagesat për punimet që nuk ishin kryer. Z. Z (punime zbatimi për kontratën koncesionare të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe z. M (administrator i “\*\*\*\*” sh.p.k.) kanë përdorur një skemë fiktive pagesash për të mbuluar natyrën dhe origjinën e vërtetë të parave të paligjshme. Shihni gjithashtu NJOFTIM-Spak.al, datë 14.12.2021. Sipas këtij njoftimi, hetimi i SPAK-ut konkludoi se shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. (shoqëria fituese e kontratës koncesionare) dhe shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. (zbatuesja e punimeve për ndërtimin e fabrikës) kanë prerë dhe pranuar mandatpagesa për punime që realisht nuk janë kryer, me anë të përdorimit të një skeme fiktive pagesash për të mbuluar natyrën e vërtetë dhe origjinën e shumave të paligjshme të parave.

<sup>45</sup>Shihni të dhënat nga sistemi TIMS në dosjen hetimore të Komisionit.

<sup>46</sup>Shihni përgjigjet e subjektit mbi pyetësorin nr. \*\*\* në dosjen e Komisionit.

Bazuar në *email*-in e datës 11.12.2018, të drejtorit A. Xh., në Prokurorinë e Përgjithshme, konfirmohet aktiviteti i subjektit në datat 24-25 janar në Podgoricë, Mal i Zi.

Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 25.7.2022, shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. ka lëshuar një vërtetim ku deklaron se i ka lënë në përdorim automjetet.

### 1.2.3 Të dhëna të rëndësishme dhe kuadri ligjor në lidhje me vlerësimin e figurës

#### a. Rrethanat faktike në lidhje me këtë çështje

- Lidhjet e hershme dhe të ngushta të biznesit dhe ato familjare të subjektit dhe bashkëshortit të saj me shtetasit S.G, K.Z dhe A.M, të drejtpërdrejta ose nëpërmjet anëtarëve të afërt të familjes/krushqisë<sup>47</sup> (M.M, T.M, M.M), që prej vitit 2004.
- Punësimi i shtetasit E.M që prej vitit 2018 deri në maj të vitit 2022 nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. në një pozicion të rëndësishëm – kjo e fundit kishte lidhje të ngushtë dhe aktive me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe shtetasin K. Z (partner aktiv, përfaqësues i..., shoqëri zbatuese/nënkontraktore e...).
- Përdorimi i automjeteve në emër të shtetasve K.Z dhe A.M nga subjekti dhe bashkëshorti i saj në vitet 2019 - 2020 (mbani parasysht se automjeti në emër të shtetasit A.M është përdorur shpesh nga shtetasit S.G dhe M. M), ndërkohë që afera dhe përfshirja e këtyre subjekteve dhe kompanive u trajtua (në detaj) nga media dhe deputetët që në vitin 2018 dhe rasti u denoncua zyrtarisht në SPAK në qershor të vitit 2020<sup>48</sup>.

#### b. Kuadri ligjor që lidhet me vlerësimin e figurës

Kuadri ligjor në fuqi parashikon elementet përkatës si vijon:

- Disa vepra penale (korrupsioni aktiv, pastrimi i të produkteve të krimit) janë në juridiksionin e SPAK-ut dhe duhen shqyrtuar në kuadër të krimit të organizuar.
- Hetimi nga SPAK, si një fazë procedurale e përfshirë në objektin e ligjit të *Vetting*-ut, me qëllim përcaktimin e pjesëmarrjes/përfshirjes në krimin e organizuar.
- Kontakti i papërshtatshëm real, siç përcaktohet në nenin 34 të ligjit të *Vetting*-ut: “...objekti i kontrollit të figurës është verifikimi i deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin e atyre subjekteve që kanë kontakte...”; si dhe në qasjen standarde të Komisionit ndaj informacionit të përditësuar nga DSIK-ja gjatë kryerjes së procedurave individuale të rivlerësimit, në përputhje me formulimin e nenit 34 të ligjit 84/2016.
- Komunikimi/komunikimet jo të rastësishme të subjektit të rivlerësimit ose personit të lidhur me të (germa “b” e pikës 4 të nenit 38 të ligjit të *Vetting*-ut) me një person (ose disa persona) të përfshirë në krimin e organizuar.
- Rrethana që subjekti ose një person i lidhur me të kanë shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person (ose disa persona) të përfshirë në krimin e organizuar (germa “c” e së njëjtës dispozitë).
- Rrethana që subjekti ka lidhje të ngushta me një person (ose disa persona) të përfshirë në krimin e organizuar (germa “ç” e së njëjtës dispozitë).
- Mungesa e rrethanave lehtësuese, sipas nenit 38, pika 5 e ligjit të *Vetting*-ut.

<sup>47</sup>Sipas formularit të DSIK-së, anëtarët e familjes në kontakt të mundshëm, të papërshtatshëm me anëtarë të krimit të organizuar, përfshijnë krushqinë deri në nivel të dytë (vjehtëri dhe kunati/kunata).

<sup>48</sup>Shihni *linkun*: Inceneratori i Fierit/Nisma \*\*\*, kallëzim në SPAK: Oeveria e kompromentuar në falsifikimin e dokumenteve, veprimtaria nga grupi i K.Z dhe M.M - Gazeta \*\*\*.

**1.3** ONM-ja ka marrë informacion nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për statusin në të cilin ka vepruar z. K.Z në kuadër të kontratës koncesionare për menaxhimin e integruar të mbetjeve në Tiranë.

**1.3.1** Sipas dosjeve të dorëzuara, z. K. Z vepronte si përfaqësues i shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. (me seli në Amsterdam), shoqëri amë e “\*\*\*\*” sh.p.k. Kompania mëmë ka aplikuar dhe ka fituar kontratën koncesionare, ndërsa kompania bijë “\*\*\*\*” sh.p.k. është ajo që ka nënshkruar dhe zbatuar kontratën koncesionare. Nga aktet e paraqitura rezulton gjithashtu se shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. në pronësi 100% nga z. K.Z, së bashku me dy shoqëri të tjera, janë aksionerët themelues të “\*\*\*\*” sh.p.k.<sup>49</sup>. Për më tepër, sipas statutit të shoqërisë bijë “\*\*\*\*” sh.p.k. me firmën e z. K.Z, shoqëria mëmë “\*\*\*\*” sh.p.k. është ajo që drejton dhe administron shoqërinë bijë “\*\*\*\*” sh.p.k., si dhe ajo që përfiton nga aktivitetet e saj.

Sa më sipër, duket relevante dhe Komisioni do t’i vlerësojë së bashku me të dhëna të tjera të trajtuar më sipër lidhjet e subjektit të rivlerësimit dhe/ose bashkëshortit të saj me z. K.Z, nisur nga punësimi i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit që prej vitit 2018 në shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k. që prej vitit 2018, në nivel shumë të lartë drejtues<sup>50</sup>.

**1.3.2** Për më tepër, të dhënat e sistemit TIMS tregojnë se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kanë udhëtuar drejt/nga Vjena me shtetasen S.G në datat 1.1.2016 dhe 4.1.2016.

#### **1.4 Gjetjet në lidhje me kriterin e vlerësimit të figurës**

Në lidhje me sa më lart, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit, si vijon:

- Mosdeklarimi nga ana e subjektit në formularin e DSIK-së të një kontakti të papërshtatshëm të vitit 2012.

- Në lidhje me marrëdhëniet e vazhdueshme shoqërore, familjare e të biznesit të subjektit të rivlerësimit, bashkëshortit të saj dhe krushqisë së nivelit të dytë, me personat dhe shoqëritë e hetuara nga SPAK, përfshirë personat e shpallur në kërkim nga autoritetet<sup>51</sup>.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**1.5** Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti parashtroi<sup>52</sup>:

##### ***“1.5.1 Mosdeklarim i kontaktit të papërshtatshëm në formularin e DSIK-së***

*Bashkëshorti im ka lidhur një kontratë shitjeje sendi në të ardhmen para noterit me investitorin/shitësin E.B, për blerjen e një apartamenti. Për të finalizuar shitjen përfundimtare të apartamentit, në datën 17.4.2012 është përpiluar kontrata e shitblerjes nga ana e noterit D.L., i cili ka njoftuar bashkëshortin se kontrata e shitblerjes së apartamentit ishte gati dhe se mund të kalonte edhe ta nënshkruante. Në po të njëjtën ditë bashkëshorti është paraqitur para noterit, ku ka konstatuar se pala tjetër, përfaqësuesi me prokurë i shitësve M.G dhe E.G (shtetasi V.Z) e kishte nënshkruar më herët kontratën. Në kohën që kam plotësuar formularin e DSIK-së për efekt të ligjit nr. 84/2016, ‘Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve’, kam qenë në dijeni të plotë të faktit se bashkëshorti im nuk kishte pasur asnjë kontakt me shtetasin V.Z. Për të provuar këtë rrethanë, jam përpjekur të kontaktoj me noterin në mënyrë që të konfirmohej edhe prej tij ky fakt, por kam mësuar se ai kishte ndërruar jetë në datën 24.8.2022.*

<sup>49</sup>Shihni dosjet nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.

<sup>50</sup>Sipas të dhënave nga ISSH-ja për pagën e bashkëshortit.

<sup>51</sup>Shihni gjetjet e IMO-s së datave 15 korrik dhe 6 tetor 2022 dhe shtojcën e gjetjes për subjektin e rivlerësimit Mariola Mërtiri.

<sup>52</sup>Shihni shpjegimet e subjektit në rezultatet e hetimit.

*E gjithë vlera e çmimit të apartamentit të blerë i është shlyer tërësisht shtetasit E.B dhe, për pasojë, lidhja e kontratës së shitblerjes ishte vetëm një formalitet, i cili do të na jepte mundësinë që të regjistronim pranë ZVRPP-së apartamentin. Sqaroj se bashkëshorti im nuk ka pasur asnjë komunikim, kontakt apo takim me shtetasin V. Z (përfaqësues me prokurë i palës shitëse). As unë dhe as bashkëshorti im nuk e njohim shtetasin V. Z, nuk kemi pasur takime, komunikime apo kontakte me këtë person dhe, për këtë arsye, në kuptim të ligjit nuk është bërë pasqyrimi në deklaratën për kontrollin e figurës.*

*Në kërkesën për heqje dorë në një çështje penale si shkak kam parashtruar atë të lidhjes së kontratës përfundimtare të shitjes me shtetasin V.Z dhe kam pasur parasysh evitimin e një konflikti në dukje interesi.*

*Edhe nëse ky do të konsiderohej kontakt në kuptim të ligjit, nga ana ime deklarami i tij nuk do të sillte asnjë problem, duke qenë se edhe nëse do të kishte ekzistuar ai do të përbënte një kontakt rastësor të personit tim të lidhur, për shkak të kësaj marrëdhënieje kontraktuale dhe jo njohje e familjes time”.*

### **Vlerësimi i Komisionit**

- Shtetasi V. Z. ka qenë përfaqësues me prokurë i palës shitëse të apartamentit në qytetin e Fierit (M.G dhe E.G). Kontrata e shitjes është firmosur nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit dhe shtetasit V. Z. si përfaqësues i palës shitëse. Është konstatuar se vlera e çmimit të apartamentit të blerë nga subjekti dhe bashkëshorti i është shlyer tërësisht palës shitëse. Subjekti ka sqaruar se bashkëshorti i saj nuk ka pasur asnjë kontakt me shtetasin V. Z. si përfaqësues i palës shitëse dhe as te noteri ku është lidhur kontrata e shitjes. Për shkak se noteri ka ndërruar jetë ky fakt është i pamundur për t’u vërtetuar. Trupi gjykues nuk konstatoi ndonjë fakt apo rrethanë tjetër për ndonjë kontakt të mundshëm të subjektit ose bashkëshortit me shtetasin V. Z. Edhe nëse do të ketë pasur ndonjë kontakt bashkëshorti i subjektit me këtë shtetas në lidhjen e kontratës, ky rast do të konsiderohet i izoluar dhe vetëm për qëllim finalizimin e një marrëdhënieje kontraktuale rastësore, pasi shtetasi V. Z. është caktuar nga pala shitëse si përfaqësues me prokurë për të firmosur kontratën e shitblerjes.

- Neni 3 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, parashikon se: “*Kontakt i papërshtatshëm është një takim, komunikim elektronik ose çfarëdolloj mënyre tjetër takimi i qëllimshëm, që nuk është në pajtim me ushtrimin e detyrës nga subjekti i rivlerësimit, pavarësisht nëse vendosen marrëdhënie biznesi, në kuptim të pikës 9 të këtij neni, ose ndonjë marrëdhënie tjetër*”. Trupi gjykues nuk konstatoi ndonjë takim, komunikim elektronik apo të çdo lloji tjetër, duke përfshirë edhe takime/komunikime që nuk janë në pajtim me ushtrimin e detyrës së subjektit.

- Në lidhje me shtetasin E. B, bazuar në shkresën nr. \*\*\* prot., datë 7.11.2022, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, nuk rezultoi të ketë pasur procedime penale të regjistruara në ngarkim të këtij shtetasi.

### **1.5.2 Shpjegimet në lidhje me pikën 1.2 “Kontakte të papërshtatshme faktike”**

#### **a. Në lidhje me lidhjet familjare dhe të biznesit**

Subjekti ka deklaruar se: “*Lidhja e vetme e imja dhe bashkëshortit tim ndërmjet personave të cituar S. G., K. Z. dhe A. M. është ajo me shtetasen S. G. Sikurse kam sqaruar në përgjigje të pyetësorit standard, shtetasja S. G. është bashkëjetuesja e kunatit tim (vëllait të bashkëshortit) dhe bashkëjetojnë prej vitit 2004. Bashkëshorti im nuk ka asnjë lidhje biznesi me shtetasit S.G., K. Z. dhe A. M. E vetmja lidhje biznesi e bashkëshortit tim i ka fillesat në vitin 2004 dhe që ka të bëjë me investimin në shoqërinë ‘\*\*\*’ është me vëllain e tij (kuantin tim) dhe me asnjë nga këta shtetas.*

*Bashkëshorti im ka qenë administrator në shoqërinë ‘\*\*\*’ sh.a., për periudhën prill 2003 – shkurt 2006 dhe punonjës në shoqërinë ‘\*\*\*’ sh.p.k. (me administratore shtetasen S. G.) për periudhën prill – dhjetor 2007. Bashkëshorti im (prej momentit të cituar më sipër dhe marrëdhënies me vëllain e tij) nuk ka zhvilluar asnjë aktivitet tregtar.*

*Nga hetimi i kryer prej jush rezulton qartësisht që shtetasit K. Z. dhe A. M. janë lidhje biznesi apo njohje të kunatit tim dhe të bashkëjetueses së tij. Nuk janë lidhje as biznesi dhe as shoqërore të bashkëshortit tim dhe kurrsesi të miat.*

*Sqaroj me përgjegjësi të plotë ligjore se lidhja ime e vetme ka qenë me shtetasen S. G. për shkak të marrëdhënies familjare dhe kjo lidhje është ndërprerë plotësisht prej momentit kur unë kam rënë në dijeni se ndaj saj ishin zhvilluar hetime dhe ishte nxjerrë një masë sigurimi. Vlen të përmend faktin se çdo hetim, e për tepër ato hetime që konsiderohen sensitive, mbahen sekrete sipas nenit 279 të Kodit të Procedurës Penale, për rrjedhojë unë kam marrë informacion publik vetëm në muajin dhjetor 2021. Ngjarjet e ndodhur në dhjetor të vitit 2021 apo aktualisht nuk mund të afektojnë kriterin e figurës sime. Edhe në raportin e përditësuar nga DSJK-ja, janar 2022, nuk është konstatuar asnjë kontakt i papërshtatshëm gjatë ushtrimit të detyrës sime”.*

### **Vlerësimi i Komisionit**

- Trupi gjykues konstatoi se subjekti i rivlerësimit, për shkak të marrëdhënieve familjare, ka lidhje me shtetasin M. M (kunati i subjektit) dhe bashkëjetueses së tij S. G.
- Referuar shkresës nr. \*\*\* prot., datë 2.6.2022, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar ka informuar se lidhur me shtetasin M. M, i datëlindjes 8.8.1978, pas verifikimeve të kryera në regjistrin e njoftimit të veprave penale, nuk rezulton i regjistruar si person nën hetim deri aktualisht. Në datën 21.5.2021 është regjistruar emri i shtetasen S.F G, e datëlindjes 18.1.1980, për veprën penale të parashikuar nga nenet 245 e 25 dhe 287 germat “a” dhe “b” të Kodit Penal, e kryer në rrethanën cilësuese “në bashkëpunim”, sipas nenit 287, paragrafi 2 i Kodit Penal. Më pas kjo Prokurori, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 30.11.2022, informon se në kuadër të hetimeve në datën 3.11.2022 është regjistruar emri i shtetasit M. M, për veprat penale të parashikuara nga nenet 245 e 25 dhe 287, germat “a” dhe “b” të Kodit Penal, të kryera në rrethanën cilësuese “në bashkëpunim”, sipas nenit 287, paragrafi 2 i Kodit Penal. Regjistrimi i procedimit penal nr. \*\*\* është bërë në datën 13.11.2020. Bazuar në sistemin TIMS rezultoi se subjekti ka udhëtuar jashtë vendit me shtetasit M. M. dhe S. G. vetëm vitin 2016.
- Në momentin e plotësimit të formularit të dekriminalizimit nga subjekti në zbatim të ligjit nr. 84/2016, shtetasit M. M. dhe S. G. nuk kanë qenë të dënuar apo proceduar për ndonjë nga veprat penale në pikën 1 të nenit 3 të ligjit nr. 10 192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimin të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të ndryshuar.
- Ligji nr. 84/2016 përcakton se kontakt i papërshtatshëm është çdo kontakt i subjektit apo personave të lidhur me persona të cilët ka filluar procedimi penal ose janë dënuar me vendim të formës së prerë për vepra penale të parashikuara po në këtë ligj. Pra fillimi dhe kontrolli i këtij kontakti të papërshtatshëm të subjektit të rivlerësimit fillon në momentin që ndaj personave të proceduar ka filluar ndjekja penale ose është regjistruar emri në procedimin penal.
- Trupi gjykues nuk konstatoi ndonjë kontakt të subjektit të rivlerësimit apo bashkëshortit me shtetasit M. M. dhe S. G. pas regjistrimit nga SPAK-u të veprave penale ndaj tyre.
- Bashkëshorti i subjektit ka qenë ortak me vëllain e tij (M. M) në vitin 2004 me krijimin e shoqërisë “\*\*\*\*”. Më pas bashkëshorti i subjekti ka qenë i punësuar në kompani dhe institucione të ndryshme.

- Gjatë hetimit trupi gjykues nuk konstatoi ndonjë marrëdhënie biznesi, punësimi apo kontakte të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të tij me shtetasit K. Z. dhe A. M.

**b. Në lidhje me punësimin e bashkëshortit**

Subjekti ka deklaruar se: *“Prezumimi se pozicioni i punës së mbajtur nga ana e bashkëshortit tim në shoqërinë “\*\*\*” është ‘në një nga nivelet më të larta drejtuese të shoqërisë’, pra në një pozicion të rëndësishëm vetëm duke iu referuar pagës së tij, nuk qëndron. Bashkëshorti im, shtetasi E. M, ka qenë i punësuar pranë shoqërisë ‘\*\*\*’ në pozicionin e drejtorit të sigurisë. Ky pozicion pune nuk ka funksione drejtuese, pasi nuk gëzon asnjë kompetencë vendimmarrëse në drejtim të administrimit të shoqërisë.*

*Punësimi i bashkëshortit tim te kjo shoqëri nuk është kryer nga shtetasi K. Z.”.*

**Vlerësimi i Komisionit**

- Trupi gjykues vlerëson se subjekti ka deklaruar saktë dhe provuar pozicionin e bashkëshortit dhe marrëdhëniet e tij të punës. Bashkëshorti i subjektit prej vitit 2018 ka qenë i punësuar nga shoqëria “\*\*\*” sh.p.k., me funksion drejtor. Nuk rezultoi se bashkëshorti i subjektit të kishte funksione drejtuese dhe vendimmarrëse në drejtim të administrimit të kësaj shoqërie.

- Nuk u konstatua që bashkëshorti i subjektit të ketë pasur kontakte me personin K. Z. apo të ketë qenë në marrëdhënie pune apo biznesi me këtë shtetas.

**c. Në lidhje me përdorimin e automjeteve**

Subjekti ka deklaruar se: *“Në datën 23.1.2019, unë, së bashku me shtetaset S. L., prokurore në Tiranë dhe A. A., punonjëse në Ministrinë e Jashtme kemi udhëtuar në drejtim të Malit të Zi, me qëllim për të marrë pjesë në aktivitetin e zhvilluar në datat 24-25 janar 2019, në Podgoricë. Në drejtim të Malit të Zi kemi udhëtuar me mjetin me targa AA \*\*\*, mjet i cili i përkiste të njohurit të bashkëshortit tim, shtetasit D.Y. Sqaroj se unë nuk e kam përdorur personalisht në asnjë rast mjetin e sipërcituar, por vetëm kam udhëtuar si pasagjere në datën 23.1.2019. Ndërkohë, në datën 25.1.2019, pas përfundimit të aktivitetit, unë dhe dy shtetaset e tjera jemi larguar nga Mali i Zi me automjetin me targa AA \*\*\*, me drejtues mjeti shtetasin F. H. (bashkëjetuesi i znj. S.L). Automjeti me targa TR \*\*\*ka qenë në përdorim nga kompania ‘\*\*\*’ sh.p.k., ku bashkëshorti ka qenë i punësuar. Unë nuk kam dijeni dhe nuk e njoh pronarin e mjetit. Jam në dijeni që mjeti është përdorur nga bashkëshorti si mjet pune, i dhënë nga kompania ‘\*\*\*’ sh.p.k., Tiranë. Në muajin dhjetor të vitit 2020 së bashku me bashkëshortin dhe fëmijët kemi udhëtuar për Krishtlindje në drejtim të qytetit të Pejës, Kosovë, ku kemi qëndruar për rreth 2 netë. Mbaj mend që koha nuk ishte e mirë dhe për shkak të dëborës së rënë bashkëshorti ka vendosur të përdorë makinën e punës (\*\*\* me targa TR \*\*\*) për arsye sigurie, pasi mjeti që ne posedonim ishte autoveturë dhe menduam se nuk ishte e sigurt për udhëtime në rrugë me dëborë.*

*Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka konfirmuar se shtetasi M. M, i datëlindjes 8.8.1978, nuk rezulton i regjistruar si person nën hetim deri aktualisht. Në datën 21.5.2021 është regjistruar emri i shtetases S.F.G, e datëlindjes 18.1.1980, për veprën penale të parashikuar nga nenet 245 e 25 dhe 287, germat ‘a’ dhe ‘b’ të Kodit Penal, e kryer në rrethanën cilësuese ‘në bashkëpunim’, sipas nenit 287, paragrafi 2 i Kodit Penal. Njoftimi publik i faktit që ka shtetas nën hetim në lidhje me këtë procedim është bërë në datën 14.12.2021.*

*Në referim të të dhënave publike të kësaj Prokurorie, rezulton se shtetasi K. Z. është person nën hetim për veprat penale të parashikuara nga nenet 245 e 25 dhe 287, germat ‘a’ dhe ‘b’, në datën 14.12.2021. Ndërkohë, referuar të dhënave publike të Prokurorisë së Posaçme,*



rezulton se shtetasi A. M. është person nën hetim për veprën penale të parashikuar nga neni 287, geramat 'a' dhe 'b' të Kodit Penal, në datën 29.3.2022.

Nga verifikimi i veprave penale të parashikuara në pikën 1 të nenit 3 të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, 'Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë', i ndryshuar, vërehet se nenet 245 e 25 dhe 287 të Kodit Penal, bazuar në pikën 15 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, 'Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve', shtetasit S. G., K. Z. dhe A. M. konsiderohen persona të përfshirë në krimin e organizuar. Këtë cilësi këta persona e kanë marrë në datat 14.12.2021 dhe 29.3.2022, referuar njoftimeve publike dhe prej këtij momenti konsiderohen kontakt i papërshtatshëm për efekt të ligjit të rivlerësimit kalimtar.

Sikurse rezulton nga të dhënat e administruara nga ana juaj, mjetet me targa AA \*\*\* dhe TR \*\*\* janë përdorur në vitet 2019 dhe 2020 vetëm një herë, shumë kohë përpara kohës së procedimeve të këtyre personave.

Ritheksoj se personalisht me shtetasit K. Z. dhe A. M. unë nuk kam pasur asnjëherë asnjë lloj njohjeje dhe kontakti. Ndërkohë që me shtetasit S. G. dhe M. M. kam një periudhë shumë të gjatë pa kontakte dhe komunikime të çfarëdolloj forme. Kontaktet e mia të mëparshme me shtetasit S. G. dhe M. M. kanë qenë vetëm për shkak të marrëdhënies familjare”.

### **Vlerësimi i Komisionit**

- Deklarimet e subjektit lidhur me përdorimin e automjeteve me targa AA \*\*\* dhe TR \*\*\* janë të sakta. Bazuar në vërtetimin me nr. \*\*\* prot., datë 25.7.2022, kompania “\*\*\*\*” sh.p.k. (kompani ku bashkëshorti i subjektit ka qenë i punësuar) ka pasur në përdorim prej datës 1.11.2017 deri më 29.3.2022 automjetin me targa TR \*\*\*.

- Nuk rezultoi se subjekti dhe bashkëshorti të kenë përdorur këtë periudhë automjete në pronësi të personave për të cilët kishte filluar procedim penal apo kanë qenë të dënuar për vepra penale të parashikuara nga pika 1 e nenit 3 të ligjit nr. 10 192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

### **1.6 Vlerësimi i Komisionit në tërësi për kriterin e figurës**

Trupi gjykues, në përfundim konstaton se:

- Subjekti i rivlerësimit, për shkak të marrëdhënieve familjare, ka lidhje me shtetasin M. M (kunati i subjektit) dhe bashkëjetuesen e tij S. G. Në asnjë rast apo rrethanë nuk u konstatua që subjekti apo bashkëshorti i saj kanë pasur kontakte me këto persona pas regjistrimit të procedimit penal ndaj tyre.

- Gjithashtu në asnjë rast të vetëm nuk u konstatuan kontakte të papërshtatshme të subjektit apo bashkëshortit të saj me personat V. Z., K. Z. dhe A. M.

- Nenet 34 - 39 të ligjit nr. 84/2016 përcaktojnë procedurën e ndjekur për kontrollin e figurës nëpërmjet verifikimit të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin e atyre subjekteve që kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

Neni DH i Aneksit të Kushtetutës parashikon se:

“1. Subjektet e rivlerësimit dorëzojnë një deklaratë dhe i nënshtrohen një kontrolli të figurës, me qëllim identifikimin e atyre që kanë kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Kontrolli i figurës për lidhje me personat e përfshirë në krimin e organizuar bazohet në deklaratën për figurën dhe prova të tjera, përfshirë vendimet e gjykatave shqiptare ose të huaja.

2. Subjektet e rivlerësimit plotësojnë dhe i dorëzojnë Komisionit një deklaratë të detajuar për figurën e tyre, që mbulon periudhën nga 1 janari i vitit 2012 deri në ditën e deklaramit, sipas ligjit.

3. Nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën.

4. Nëse subjekti i rivlerësimit nuk e dorëzon në kohë deklaratën për figurën sipas ligjit, ai shkarkohet. Nëse subjekti i rivlerësimit përpiqet të bëjë deklaramit të pasakta ose të fshehtë kontaktet me persona të përfshirë në krimin e organizuar, zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën.

Enetit 36 dhe 37 të ligjit nr. 84/2016 përcaktojnë strukturën përgjegjëse për kontrollin e figurës. Nga institucionet e angazhuara për verifikimin e figurës nuk ka pasur as edhe një informacion që subjekti të ketë pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar”.

Komisioni nuk konstatoi gjatë hetimit ndonjë kontakt të subjektit apo bashkëshortit me personat e përfshirë në krimin e organizuar, në kuptim të nenit DH të Aneksit të Kushtetutës, si dhe ligjit nr. 84.2016.

### C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Raporti i vlerësimit profesional për subjektin Mariola Mërtiri, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është përgatitur bazuar në ligjin nr. 84/2016. Ky raport i ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të mëposhtme të vlerësimit:

- a) aftësitë profesionale;
- b) aftësitë organizative;
- c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale;
- ç) aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

Ky raport është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit, të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit; (ii) pesë dosjeve penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iii) të dhënave nga 23 prokuroritë e rretheve gjyqësore dhe Prokuroria e Përgjithshme.

#### 1. Formulari i vetëdeklarimit dhe dokumentet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit

Subjekti i rivlerësimit, prokurorja Mariola Mërtiri, ka paraqitur formularin e vetëdeklarimit, dhe 35 fletë dokumente shoqëruese të formularit.

Nga analiza e dokumentacionit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, konstatohet si vijon:

- Formulari paraqitet i nënshkruar dhe i plotësuar sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016.
- Me Dekretin Nr. 5925, datë 6.11.2008, të Presidentit të Republikës, Mariola Mërtiri është emëruar prokurore në stazh në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.
- Me Dekretin Nr. 6294, datë 12.10.2009, të Presidentit të Republikës, Mariola Mërtiri është emëruar prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.
- Me urdhrin nr. \*\*\*, datë 28.10.2009, të Prokurorit të Përgjithshëm, prokurorja Mariola Mërtiri komandohet në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.
- Me Dekretin Nr. 7404, datë 17.4.2012, të Presidentit të Republikës, Mariola Mërtiri është emëruar prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

- Me Dekretin Nr. 9523, datë 18.4.2016, të Presidentit të Republikës, Mariola Mërtiri është emëruar prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

### **Tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit**

Gjatë periudhës së vlerësimit, subjekti i rivlerësimit, prokurorja Mariola Mërtiri, ka përzgjedhur dhe ka paraqitur tri dokumente ligjore, konkretisht:

1. Kërkesë për gjykimin e çështjes penale nr. \*\*\*, viti 2014, me të pandehur R.H, akuzuar për veprën penale “korrupsion aktiv të personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 244 i Kodit Penal, akt i datës 17.3.2014.
2. Kërkesë për gjykimin e çështjes penale nr. \*\*\*, viti 2011, me të pandehur M.H, Ç.A dhe K. L, akuzuar për veprën penale “pastrim i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, akt i datës 27.7.2015.
3. Kërkesë për gjykimin e çështjes penale nr. \*\*\*, viti 2015, me të pandehur R.K, akuzuar për veprën penale “vjedhje duke shpërdoruar detyrën”, parashikuar nga neni 135 i Kodit Penal, akt i datës 18.2.2015.

Trupi gjykues nuk konstatoi problematika lidhur me tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit.

Subjekti i rivlerësimit, në periudhën e rivlerësimit, ka trajtuar dhe përfunduar gjithsej 306 çështje. Ky fakt konfirmohet nga lista e çështjeve të përgatitura për short.

### **2. Përshkrimi i pesë dosjeve të përzgjedhura me short**

**Dosja nr. 1** – gjetjet në dokumentin ligjor “Vendim për mosfillimin e procedimit penal nr. \*\*\* të vitit 2015”, akt i datës 7.10.2015, si dhe në kallëzimin penal nr. \*\*\* të vitit 2015, të regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier

Akti është i datës 7.10.2015, përpiluar dhe nënshkruar nga znj. Mariola Mërtiri, me cilësinë e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

Me anë të këtij akti, prokurorja, pasi ka konstatuar se për të njëjtin fakt është referuar dy herë në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Fier, ka vendosur mosfillimin e procedimit pasi çështja është në gjykim.

Në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Fier, mbi bazën e materialit kallëzues të referuar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Fier, është regjistruar kallëzimi penal nr. \*\*\*, datë 1.10.2015.

### **Rrethanat e faktit**

Drejtoria e Policisë së Qarkut Fier është informuar nga Komisariati i Policisë Fier se nga kontrollet e ushtruara prej oficerëve të policisë gjyqësore të komisarariatit janë konstatuar persona që ushtrojnë aktivitetet të palicencuar të lojërave të fatit, vepër kjo e parashikuar nga neni 197 i Kodit Penal. Duke qenë se referimet e këtyre veprave penale janë bërë nga Komisariati i Policisë Fier dhe se dyshohet se prej këtyre shtetasve janë konsumuar edhe elemente të veprës penale “fshehje të të ardhurave”, parashikuar nga neni 180/1 i Kodit Penal, është bërë referimi sërish në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Fier të kryer nga i njëjti person, në të njëjtën periudhë kohore.

Në datën 14.5.2015, nga ana e punonjësve të policisë gjyqësore të Drejtorisë së Policisë së Qarkut Fier, në bazë të një plankontrolli, me qëllim evidentimin e personave që ushtronin veprimtari të palicencuar, u ushtrua kontroll në disa lokale dhe ambiente ku organizoheshin lotari dhe lojëra fati në fshatin P, komuna M e rrethit Fier.

Nga kontrolli i ushtruar në lokalitetin e shtetasit E.Ç, i cili ndodhet në fshatin P, Fier, u konstatua një kompjuter i ndezur dhe tre televizorë, me logo të kompanisë “\*\*\*”, të cilat u sekuestruan në cilësinë e provës materiale.

Nga verifikimet e kryera rezultoi se ky material i është përcjellë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier dhe është regjistruar procedimi penal nr. \*\*\*, viti 2015, në ngarkim të shtetasit E.Ç.

Në këto rrethana rezultoi që për të njëjtin fakt kriminal të jetë regjistruar një procedim penal dhe të jenë zhvilluar hetime në lidhje me këtë fakt.

Prokurorja konkludon se ndodhet para një “gjëje të gjykuar”, e njohur në doktrinë si parimi *ne bis in idem*, pasi për të njëjtin fakt kriminal është vendosur dërgimi i çështjes në gjyq dhe pritet vendimmarrja nga ana e gjykatës. Nëse në bazë të këtij kallëzimi rihapet një procedim i ri për të njëjtin fakt kriminal, atëherë do të ishim në shkelje të këtij parimi të së drejtës.

Mbështetur në nenin 290, pika 1, germa “e”, si dhe nenin 291 të Kodit të Procedurës Penale, vendosi:

1. *Mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin nr. \*\*\*, datë 1.10.2015.*
2. *Më këtë vendim të njohë Drejtorinë e Policisë së Qarkut Fier.*
3. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier brenda pesë ditëve nga njoftimi i vendimit.*

Nga shkresa nr. \*\*\* prot., datë 23.12.2020, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, me lëndë “Dërgohet informacion”, rezultoi se ndaj vendimit të mosfillimit të kallëzimit penal nr. \*\*\* të vitit 2015 nuk është ushtruar ankim.

Nuk u konstatuan problematika lidhur me këtë çështje penale të ndjekur nga subjekti i rivlerësimit.

**Dosja nr. 2** – gjetjet në dokumentin ligjor “Vendim për pushimin e procedimit penal nr. \*\*\*, viti 2015”, akt i datës 10.7.2015, si dhe në procedimin penal nr. \*\*\* të vitit 2015, të regjistruar në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier

Akti është i datës 10.7.2015, përpiluar dhe nënshkruar nga znj. Mariola Mërtiri, me cilësinë e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

Me anë të këtij akti prokurorja argumenton se fakti që ka rezultuar nga hetimi nuk parashikohet nga ligji si vepër penale dhe për këtë arsye duhet të pushohet.

Në datën 6.1.2015, mbi bazën e materialeve të referuara nga ILDKPKI-ja është regjistruar procedimin penal nr. \*\*\*, për veprën penale “refuzim për deklaram, mosdeklaram, fshehje ose deklaram i rremë i pasurisë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë”, parashikuar nga neni 257/a, paragrafi i parë i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit J.Gj.

Nga hetimet e kryera në funksion të këtij procedimi penal ka rezultuar se:

- Shtetasi J.Gj ka filluar detyrën si inspektor hetimi tatimor në Drejtorinë Rajonale Tatimore Fier për periudhën 6.3.2010 – 28.9.2012. Bazuar në kërkesat e nenit 3/c të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, ky shtetas është subjekt që mbart detyrimin për deklaram të interesave private në ILDKPKI.

- Me vendimin nr. \*\*\* datë 28.9.2012, të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, shtetasit J.Gj i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës. Kështu që, pas datës 28.9.2012 shtetasi J.Gj nuk ka ushtruar më detyrën si inspektor tatimor në Drejtorinë Rajonale Tatimore Fier. Ai nuk ka dorëzuar deklaramtën “Periodik 2012”, pranë ILDKPKI-së.

Në respektim dhe zbatim të nenit 7 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, subjekti deklarues J. Gj detyrohej të paraqiste DIPP/2012 brenda datës 31.3.2013, në ILDKPKI ose pranë strukturës përgjegjëse të institucionit publik, në zbatim të nenit 41, pika 2/b e ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005.

Në kundërshtim me kërkesat e ligjit, subjekti deklarues J.Gj nuk ka përmbushur këtë detyrim ligjor. Për këtë arsye, Inspektori i Përgjithshëm, bazuar në nenin 40/1, germa “a” dhe nenin 40/2 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” i ndryshuar, me vendimin nr. 20, datë 2.10.2013, ka vendosur ndaj tij masën administrative “gjobë”, në shumën 50,000 lekë, për mosdeklarim në afat dhe pa shkaqe të arsyeshme të DIPP/2012.

Për këtë detyrim ligjor dhe për pasojat në rast mosdeklarimi, subjekti është njoftuar vetëm përmes lajmërimit publik të botuar në datën 6.10.2014 në faqen zyrtare të ILDKPKI-së dhe në bazë të nenit 41 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar, vendimi i Inspektoratit të Lartë ka marrë formë të prerë dhe është shndërruar në titull ekzekutiv.

Shtetasi J. Gj, i pyetur si person nën hetim, ka shpjeguar se nuk ka qenë në dijeni të masës administrative që kishte marrë ILDKPKI-ja në ngarkim të tij. Kjo pasi, ai nuk ka marrë njoftim nga ILDKPKI-ja dhe se është liruar nga detyra prej Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier në datën 28.9.2012. Ai ka shpjeguar se në deklaratën periodike të plotësuar ndër vite ka lënë adresën e tij të banimit, në të cilën banon edhe aktualisht dhe prej ILDKPKI-së nuk është njoftuar në atë adresë.

Në këtë pjesë të aktit të titulluar “Kuatridhe ligjor” prokurorja ka analizuar nenet përkatëse të Kodit të Procedurave Administrative, ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” të ndryshuar, si dhe ligjit nr. 9367 datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.

Pas përmendjes së bazës ligjore në këtë pjesë të aktit të titulluar “Analiza ligjore” prokurorja ka bërë analizën konkrete të verimeve dhe mosveprimeve të të kallëzuarit në lidhje me ligjet e përmendura më lart.

Ligjvënësi ka parashikuar një mbrojtje të posaçme për marrëdhënie juridike të rëndësishme, të vendosura nga shteti për të siguruar funksionimin normal të institucioneve shtetërore apo publike, që rrezikohet nga konflikti i interesit apo mosdeklarimit të interesave private të personave që janë zgjedhur apo emëruar të ushtrijnë funksione publike në këto institucione. Cenimi i kësaj marrëdhënieje nga shtetasit përbëjnë vepër penale dhe pasjellin përgjegjësi penale. Sipas paragrafit të parë të nenit 257/a të Kodit Penal, që të ekzistojë vepra penale e parashikuar nga ky nen duhet që nga ana objektive personi nën hetim me veprime aktive, apo me mosveprime të kundërligjshme, të refuzojë të deklarojë apo të mos deklarojë pasuritë dhe interesat e tij private dhe personi nën hetim të veprojë apo mos të veprojë me dashje apo edhe nga pakujdesia.

Në rastin konkret, siç rezultoi, shtetasi J.Gj nuk ka bërë në kohë deklarinimin e interesave të tij private, megjithëse ka pasur detyrimin për të bërë një deklaratë të tillë, në bazë të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” dhe ligjit nr. 9367, datë 7.4.005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”. Për këtë arsye ILDKPKI-ja ka marrë masën administrative ndaj shtetasit J.Gj, duke e gjobitur.

Rezulton se ky shtetas nuk ka marrë njoftim në lidhje me aktin administrativ të gjobës të vendosur nga Inspektori i Përgjithshëm, pasi njoftimi i aktit nuk rezultoi të jetë kryer sipas

rregullave të përcaktuara nga Kodi i Procedurave Administrative. Njoftimi nuk është bërë as personalisht, por as në banesën e banimit, ndonëse rezulton se ky i fundit në deklaratat periodike ka deklaruar adresën e banimit të tij te ILDKPKI-ja.

Në materialin kallëzues IDLKPKI-ja konfirmon faktin se njoftimi i këtij shtetasi për vënien në dijeni të vendimit nr. \*\*\*, datë 2.10.2013, “Për vendosjen e gjobës për mosdeklarim të interesave private periodike, në afatin e caktuar”, është bërë nëpërmjet lajmërimit publik të botuar në faqen zyrtare të IDLKPKI-së në datën 6.10.2014, pra nga ana e Inspektoratit nuk rezulton që në emër të shtetasit J.Gj të jetë dërguar “njoftim për marrje dijeni”, lidhur me daljen e aktit administrativ.

Në kuptim të nenit 257/a/l të Kodit Penal, ligjvënësi ka pasur parasysh faktin se refuzimi për deklarim ose mosdeklarim i pasurisë së personave të zgjedhur ose nëpunësve publikë përbën kundërvajtje penale, kur më parë janë marrë masa administrative, kur deklarimi i interesave private të mos jetë kryer me dashje nga subjekti deklarues, ndonëse ky i fundit ka dijeni në lidhje me këtë fakt. Kushtëzimi i masës administrative nga ana e ligjvënësit është bërë pikërisht për të përcaktuar anën subjektive të veprës, dashjen në mosdeklarimin e pasurisë. Personi nën hetim nuk ka dijeni në lidhje me masën administrative të vendosur ndaj tij dhe prokurorja argumenton se nga ky fakt mosdeklarimi nuk është bërë me dashje. Shtetasi J.Gj e ka kryer deklaratën e interesave private dhe e ka paguar gjobën në favor të ILDKPKI-së, pasi ka rënë në dijeni në lidhje me këtë fakt në momentin që është pyetur në cilësinë e personit nën hetim.

Sa më sipër, rezulton se mungon dashja në moskryerjen e deklarimit të pasurisë nga ana e subjektit deklarues J.Gj dhe, për rrjedhojë, mungon ana subjektive e veprës penale.

Bazuar në nenin 328, paragrafi i parë, germa “b” dhe nenin 329/1 të Kodit të Procedurës Penale, vendosi:

- 1. Të pushojë procedimin penal nr. \*\*\*, datë 6.1.2015.*
- 2. Të njoftojë ILDKPKI-në në lidhje me këtë vendim.*
- 3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier brenda 10 ditëve nga marrja dijeni.*

Nga shkresa nr. \*\*\* prot., datë 23.12.2020, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, me lëndë “Dërgohet informacion”, rezulton se ndaj vendimit të pushimit të procedimit penal nr. \*\*\* të vitit 2015 nuk është ushtruar ankim.

Nuk u konstatuan problematika lidhur me këtë çështje penale të ndjekur nga subjekti i rivlerësimit.

**Dojsa nr. 3** – gjetjet në dokumentin ligjor “Vendim për pushimin e procedimit penal nr. \*\*\*, viti 2013”, akt i datës 30.10.2013, si dhe në procedimin penal nr. \*\*\* të vitit 2013, të regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier

Akti është i datës 30.10.2013, përpiluar dhe nënshkruar nga znj. Mariola Mërtiri, me cilësinë e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

Me anë të këtij akti prokurorja, pasi ka studiuar materialin e përcjellë nga Prokuroria e Përgjithshme, të autoriteteve të drejtësisë sllovene, ka arritur në përfunduar se deri në mbërritjen e letërporosisë nga autoritetet e huaja, hetimet duhen të pushohen.

### **Rrethanat e faktit**

Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 4.9.2013, të Prokurorisë së Përgjithshme, Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier i janë përcjellë për kompetencë materialet procedurale të autoriteteve sllovene, për veprat penale “falsifikim i dokumenteve” dhe “përvetësim i parave ose mallrave që rrjedhin nga vepra penale ose veprimtaria kriminale”. Mbi këtë bazë Prokuroria

e Rrethit Gjyqësor Fier ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal për këto vepra penale, në ngarkim të shtetasit M.L.

Nga materiali bashkëngjitur kallëzimit rezulton se në datën 16.12.2012 shtetasi shqiptar M.L është ndaluar nga autoritetet sllovene si i dyshuar për veprat penale “falsifikim i dokumenteve” dhe “përvetësim i parave ose mallrave që rrjedhin nga vepra penale ose veprimtaria kriminale”. Gjatë kontrollit personal të ushtruar nga autoritetet sllovene, në portofolin e këtij shtetasi është gjetur një leje drejtimi e autoriteteve shqiptare tërësisht e falsifikuar. Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 17.9.2013, të Drejtorisë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor Fier, konfirmohet fakti se shtetasi M. L nuk është i pajisur me leje drejtimi.

Duke qenë se shtetasit M. L iu gjet në portofol leja e drejtimit e falsifikuar, nga autoritetet sllovene u krye kontrolli i bagazhit personal që ky i fundit dispononte. Gjatë kontrollit të ushtruar në mjetin e këtij shtetasi i janë gjetur dhe sekuestruar nga autoritetet sllovene pajisje elektronike të përshkruara nga ana e prokurores hollësisht në akt.

Shtetasi shqiptar M.L nuk dispononte asnjë dokumentacion blerjeje mbi këto sende, por sipas informacionit të oficerit të kontaktit gjerman i punësuar në SPK G, dyshohet se sendet e gjetura në mjetin e shtetasit M.L kanë qenë të vjedhura me dhunë në hyrjen e një qendre tregtare në D, Gjermani, në datën 7.12.2012, ora 03.00, si të tilla, nga autoritetet sllovene është urdhëruar kthimi i pajisjeve që i janë sekuestruar shtetasit shqiptar, pronarit të ligjshëm autoriteteve gjermane.

Pajisjet e përmendura në akt që janë gjetur në bagazhet e tij në datën 16.12.2012, dyshohen të jenë të vjedhura në datën 7.12.2012 në Gjermani dhe ka lindur e nevojshme marrja e informacionit dhe kërkimi i provave nga autoritetet gjermane. Për këtë kërkohet informacion në lidhje me autorësinë e vjedhjes së qendrës tregtare në Gjermani dhe hetimet e zhvilluara nga ana e tyre në ngarkim të shtetasit shqiptar M. L.

Për këtë qëllim organi i akuzës i ka kërkuar ndihmë juridike në fushën penale autoriteteve gjermane. Me anë të kësaj letërporosie është kërkuar që nga ana e autoriteteve proceduese gjermane t'i vihet në dispozicion Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier materiali kallëzues dhe provat e tjera që e shoqërojnë atë, që lidhen me ngjarjen e ndodhur në datën 7.12.2012 në qendrën tregtare në D, Gjermani. Vetëm pas administrimit të këtij dokumentacioni nga ana e organit të akuzës do të bëhet e mundur të konkludohet në lidhje me ecurinë e mëtejshme të hetimit të këtij procedimi penal, kualifikimin ligjor të veprës, si dhe përgjegjësinë penale të personave të implikuar.

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier konkludon se nuk arrihet të provohet që nga ana e të dyshuarit M. L të jenë konsumuar elementet e veprës penale “përvetësim i parave ose mallrave që rrjedhin nga një vepër penale ose veprimtari kriminale”, parashikuar nga neni 287/b i Kodit Penal.

Në vazhdim të këtij arsyetimi, si dhe për të provuar fajësinë e të dyshuarit, organi i akuzës i kërkoi prova autoriteteve gjyqësore gjermane, në zbatim të konventave ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë për të formësuar në tërësi elementet e anës subjektive në ngarkim të të dyshuarit M.L. Administrimi i të dhënave/provave apo *indiceve*, të përmendura në akt, përbën një moment të rëndësishëm procedural për hetimin e natyrës së kësaj vepre penale, për të cilën janë zhvilluar hetime, kjo edhe për faktin se të gjitha mallrat që i janë gjetur shtetasit shqiptar M.L dyshohet se i përkasin autoritetit gjerman.

Në kushtet kur këto të dhëna nuk janë administruar për shkaqe të pavarura nga organi procedues, si dhe në analizë të rrethanave konkrete, e provave të mundshme të administruara, duke marrë parasysh edhe respektimin e afateve procedurale hetimore, hetimet në ngarkim të

shtetasit M. L duhet të pushohen deri në momentin e mbërritjes së letërporosisë nga autoritetet gjermane.

Mbështetur në nenin 328, paragrafi i parë, germa “dh” e Kodit të Procedurës Penale, vendosi:

1. *Të pushojë procedimin penal nr. \*\*\*, datë 6.9.2013, në lidhje me veprën penale “falsifikim i dokumenteve” dhe “përvetësim i parave ose mallrave që rrjedhin nga vepra penale ose veprimtaria kriminale”, parashikuar nga nenet 186/1 dhe 287/b të Kodit Penal.*
2. *Të njoftojë me këtë vendim të interesuarit, të cilët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier brenda 10 ditëve nga marrja dijani.*

Nga shkresa nr. \*\*\* prot., datë 23.12.2020, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, me lëndë “Dërgohet informacion”, rezulton se ndaj vendimit të pushimit të procedimit penal nr. \*\*\*/2013 nuk është ushtruar ankim.

Subjektit të rivlerësimit iu kërkua të japë shpjegime pse është vendosur pushimi i procedimit penal, si është ndjekur procedura më pas me paraqitjen e letërporosisë nga autoritetet gjermane, si dhe pse nuk ka vazhduar hetimi për veprën penale “falsifikim i dokumenteve”.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti parashtroi: “*Procedimi penal nr. \*\*\*, datë 6.9.2013, është regjistruar mbi bazën e materialit të ardhur nga Prokuroria e Përgjithshme me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 4.9.2013, në të cilën urdhërohet regjistrimi i procedimit penal në ngarkim të shtetasit M. L.*

*Mbi këtë bazë është urdhëruar regjistrimi i procedimit penal për veprat penale ‘falsifikim i dokumenteve’ dhe “përvetësim i sendeve të vjedhura”, parashikuar përkatësisht nga nenet 186/1 dhe 287/b të Kodit Penal.*

*Nga rrethanat e faktit dhe provat e administruara gjatë hetimit rezultonte se në datën 16.12.2012 shtetasi M.L është ndaluar nga autoritetet sllovene si i dyshuar për veprat penale ‘falsifikim i dokumenteve’ dhe ‘përvetësim i sendeve që rrjedhin nga një krim’. Kjo pasi nga kontrolli personal i ushtruar nga autoritetet sllovene, në portofolin e këtij shtetasi është gjetur një leje drejtimi e autoriteteve shqiptare tërësisht e falsifikuar. Nga aktet e kryera nga autoritetet sllovene rezulton se shtetasi shqiptar M. L nuk dispononte asnjë dokumentacion blerjeje mbi këto sende, por sipas informacionit të oficerit të kontaktit gjerman i punësuar në \*\*\* G, dyshohet se sendet e përshkruara më lart kanë qenë të vjedhura me dhunë në hyrjen e një qendre tregtare në D, Gjermani, në datën 7.12.2012.*

*Mbi këtë bazë, nga ana ime në cilësinë e prokurores së çështjes, është kërkuar marrja e provave nga autoritetet gjermane me letërporosi.*

*Në lidhje me lejen e drejtimit që i është gjetur në portofol gjatë kontrollit personal shtetasit M.L, nga ana ime është kërkuar informacion Drejtorisë Rajonale të Shërbimit dhe Transportit Rrugor Fier nëse shtetasi M.L, i biri i A dhe B, i datëlindjes 5.2.1991, a ishte i pajisur apo jo me leje drejtimi. Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 17.9.2013, DRSHTR-ja ka informuar se ky shtetas nuk ishte i pajisur me leje drejtimi.*

*Nisur nga fakti se procedimi penal ishte me autor të njohur, me vendimin e datës 30.10.2013 kam vendosur pushimin e procedimit penal deri në momentin e mbërritjes së akteve me letërporosinë e kërkuar. Nga ana ime është konkluduar me vendim pushimi, me qëllim respektimin e afateve procedurale, e diktuar nga rrethanat se procedimi penal ishte regjistruar me autor dhe nuk mund të vendosja pezullimin deri në pritje të letërporosisë. Për këtë shkak veprimet hetimore janë kryer në më pak se dy muaj dhe vendimi i pushimit nuk është*



*përfundimtar në këtë rast, por ka pasur si shkak ligjor pritjen e akteve me letërporosi, pasi në gjendjen që ishin provat nuk mund të ngrihej një akuzë.*

*Dërgimi i letërporosisë nga ana ime ka pasur si qëllim edhe respektimin e nenit 6 të Kodit Penal.*

*Nëse nga gjykata e huaj shtetasi M. L do të kishte marrë një vendim fajësie të formës së prerë, atëherë në respektim të dispozitës së sipërcituar organi procedues nuk mund të ngrinte ndaj këtij personi një akuzë, në respektim të parashikimit ligjor të mësipërm.*

*Në datën 3.6.2014 Drejtuesi i Prokurorisë Fier ka vendosur të rifillojë hetimet për procedimin penal nr. \*\*\* të vitit 2014, pasi në datën 28.5.2014, Prokuroria e Përgjithshme ka vënë në dispozicion materialet e përcjella nga Ministria e Drejtësisë.*

*Sqaroj se prej datës 28.8.2014 unë kam qenë me leje lindjeje e, për rrjedhojë, me vendimin e datës 8.9.2014, Drejtuesi i Prokurorisë ka vendosur zëvendësimin tim në ndjekjen e këtij hetimi dhe vijimin e hetimeve nga një tjetër prokuror, E. R.*

*Ky procedim penal është dorëzuar në momentin që unë kam marrë lejen e lindjes në fazë hetimi. Vendimmarrja e pushimit e marrë përpara rifillimit të çështjes, sikurse sqarova më sipër, ka qenë një fazë procedurale për të respektuar afatet e hetimit meqenëse gjitha ngjarja dyshohet të ishte zhvilluar jashtë Shqipërisë dhe të gjitha provat do të merreshin me letërporosi sipas nenit 509 e vijues të Kodit të Procedurës Penale. Nuk ka qenë vendim përfundimtar.*

*Sqaroj se, në rastet e tjera, në kushtet kur procedimi penal ka qenë pa autor dhe nga prokuroria kërkohet të merreshin prova me letërporosi, procedohej me vendim për pezullimin e hetimeve deri në mbërritjen e akteve të kërkuara me letërporosi.*

*Procedimi penal është regjistruar për dy vepra penale, atë të falsifikimit të dokumenteve, dhe përvetësimin të sendeve që rrjedhin nga një krim, parashikuar respektivisht nga nenet 186/1 dhe 287/b të Kodit Penal. Sikurse sqarova më sipër, kam verifikuar nëse ky shtetas ishte i pajisur apo jo me leje drejtimi. Ndërkohë që për të provuar falsifikimin e atij dokumenti duhej detyrimisht dokumenti fizik në mënyrë që t'i nënshtrohej ekzaminimeve shkencore mbi mënyrën e falsifikimit, llojin, mjetet e përdorura.*

*Një qëndrim i tillë është mbajtur në vazhdimësi nga praktika gjyqësore, vendimi nr. \*\*\*, datë 24.10.2012, Gjykata e Lartë”.*

### **Vlerësimi i Komisionit**

- Trupi gjykues i konsideroi bindëse përgjigjet dhe shpjegimet e subjektit dhe nuk konstatoi ndonjë problematikë që lidhet me kriterin profesional të subjektit të rivlerësimit në këtë çështje.
- Subjekti ka ndjekur hapat procedurale lidhur me këtë procedim penal dhe zgjidhjen e çështjes e ka dhënë bazuar në dispozitat ligjore në fuqi dhe nga praktika gjyqësore.

**Dosja nr. 4** – gjetjet në dokumentin ligjor “Kërkesë për gjykimin e çështjes penale nr. \*\*\*, viti 2012”, akt i datës 29.7.2014, si dhe në procedimin penal nr. \*\*\* të vitit 2012, të regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier

Akti është i datës 29.7.2014, përpiluar dhe nënshkruar nga znj. Mariola Mërtiri, me cilësinë e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

Me anë të këtij akti prokurorja, pasi ka përfunduar hetimet, ka konkluduar se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar, provat në ngarkim të tij janë të plota dhe se duhet të gjykohet nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

Në fillim të aktit paraqitet i pandehuri M.B, akuzuar për veprën penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga nenet 248 e 50/h të Kodit Penal.

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier ka regjistruar procedimin penal nr. \*\*\* të vitit 2012, për veprën penale “shkatërrim i rrugëve”, parashikuar nga neni 155 i Kodit Penal.

Ky procedim penal është regjistruar mbi bazën e kallëzimit të depozituar nga Autoriteti Rrugor Shqiptar. Duke qenë se gjatë hetimit u konstatuan elemente të veprës penale “shpërdorim detyre”, në regjistrin e veprave penale u shënua edhe vepra penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

### **Rrethanat e faktit**

I pandehuri M.B ka qenë në detyrën e sekretarit të KRRT-ës në komunën M, për periudhën 2010 – 2012. Gjatë kësaj kohe nga hetimi ka rezultuar se janë miratuar leje ndërtimi në superstradën Fier-Lushnjë, pa marrë më parë miratimin paraprak të Entit Rrugor Shqiptar dhe në të njëjtën kohë në shkelje të kondicioneve urbane. Konkretisht ka rezultuar se ndërtimet e kryera përgjatë superstradës Fier-Lushnjë të dhëna nga pushteti lokal kanë cenuar standardet dhe cilësinë e qarkullimit, duke u bërë shkas i aksidenteve të ndodhura. Kjo ka ardhur si pasojë e mosrespektimit të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë dhe Vendimit Nr. 153, datë 7.4.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores së Kodit Rrugor në Republikën e Shqipërisë”. Gjatë hetimeve të kryera rezultoi se pjesa e superstradës Fier, kufiri ndarës me Lushnjën, shtrihet përgjatë komunës M. Nga ana e kësaj komune janë dhënë leje ndërtimi përgjatë superstradës për objektet e ndërtuara nga subjektet “\*\*\*”, “\*\*\*”, “\*\*\*”, E. K, J.S, “\*\*\*”, L.M, Xh.B, V.F, A.C, I.G, R.L, F.V, D.S, M.A, J.I, Sh.L dhe D.L.

Në lidhje me objektet e ndërtuara nga këta subjekte janë bërë këqyrje e këtyre objekteve, duke u kryer matjet dhe distancat që kanë nga superstrada dhe në varësi të tyre është kryer aktekspertimi teknik i ndërtimit.

Nga aktekspertimi teknik ka rezultuar se:

- Të gjitha objektet e ndërtuara përgjatë superstradës Fier-kufiri ndarës Lushnjë, me përjashtim të objektit shtesë anësore e fabrikës së miellit “\*\*\*”, i cili është në tokë truall, janë dhënë në tokë arë jashtë vijës kufizuese të ndërtimeve të zonave të banuara.

- Nga hetimi është evidentuar se të gjitha lejet e ndërtimit të dhëna në superstradën Fier-Lushnjë, me përjashtim të lejes së dhënë subjektit “\*\*\*” sh.a., janë dhënë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 80 datë 21.8.2006, të Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, “Për përcaktimin dhe disiplinimin e zonave të shërbimit, hyrje-dalje apo degëzime, si pjesë e rrugës kombëtare”. Në këtë udhëzim, si dhe në VKM-në Nr. 153, datë 7.4.2000, “Për miratimin e zbatimin e Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, është e përcaktuar shprehimisht se subjektet që ndërtojnë përgjatë superstradës duhet të jenë të pajisur me leje për hyrje-dalje të miratuara nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës përpara se të marrin lejen për shesh dhe leje ndërtimi nga pushteti lokal.

Nga hetimet e kryera ka rezultuar se detyrën e sekretarit të KRRT-ës gjatë periudhës 2010 – qershor 2011 e ka ushtruar shtetasi M. B, i cili nuk duhej të kalonte për shqyrtim dhe miratim kërkesat e subjekteve të mësipërme për ndërtime të objekteve përgjatë superstradës, pasi ishin në kundërshtim me ligjin. Nga ana e shtetasit M.B, në detyrën e sekretarit të KRRT-ës, komuna M, është konsumuar plotësisht vepra penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, pasi ai me dashje ka kryer veprime në kundërshtim me ligjin të cilat kanë sjellë si pasojë cenimin e interesave të shtetit, fakt për të cilin ky i fundit ka marrë cilësinë e të pandehurit.

Në bazë të nenit 331 të Kodit të Procedurës Penale, i kërkoi gjykatës: *Gjykimin e çështjes penale nr. \*\*\* të vitit 2012, me të pandehur M.B, i akuzuar për veprën penale “shpërdorim detyre”, të parashikuar nga nenet 248 e 50/h të Kodit Penal.*

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. \*\*\*, datë 1.6.2015, ka vendosur deklarinimin e pafajshëm të të pandehurit M.B për veprën penale “shpërdorim detyre”, lënë në fuqi me vendimin nr. \*\*\*, datë 27.9.2018, të Gjykatës së Apelit Vlorë.

Nuk u konstatuan problematika lidhur me këtë çështje penale të ndjekur nga subjekti i rivlerësimit.

**Dosja nr. 5** – gjetjet në dokumentin ligjor “Kërkesë për gjykimin e çështjes penale nr. \*\*\*, viti 2015”, akt i datës 26.11.2015, si dhe në procedimin penal nr. \*\*\* të vitit 2012, të regjistruar në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier

Akti është i datës 26.11.2015, përpiluar dhe nënshkruar nga znj. Mariola Mërtiri, me cilësinë e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

Me anë të këtij akti prokurorja, pasi ka përfunduar hetimet, ka konkluduar se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar, provat në ngarkim të tij janë të plota dhe se duhet të gjykohet nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

Në fillim të aktit paraqitet e pandehura H. M, akuzuar për veprën penale “kallëzim i rremë”, parashikuar nga neni 305 i Kodit Penal.

Në datën 30.4.2015 Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, mbi bazën e materialit hetimor të referuar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Fier, ka regjistruar procedimin penal nr. \*\*\*, për veprat penale “falsifikim i dokumenteve” dhe “shpërdorim detyre”, të parashikuara nga nenet 186 dhe 248 të Kodit Penal.

### **Rrethanat e faktit**

Në datën 24.4.2015 e pandehura H.M është paraqitur në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Fier dhe ka pretenduar se vajza e saj L.R, në bashkëpunim me noterin A.H, ka falsifikuar një prokurë, në të cilin pasqyrohet fakti inekzistent sipas kallëzueses se ajo autorizon vajzën e saj të tërheqë shumën 200,000 lekë pranë “Raiffeisen Bank”. Kjo shumë parash është përfituar prej saj si rezultat i shpërbllimit për shpronësim nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.

Duke qenë se dyshohej se prokura e posaçme ishte plotësuar nga shtetasja L.R në emër të shtetasës H.M, në bashkëpunim me noterin A.H, organi i akuzës ka shënuar në regjistër emrin e personave nën hetim L.R dhe A. H si të dyshuar përkatësisht për veprat penale “falsifikim i dokumenteve” dhe “shpërdorim detyre”, të parashikuara nga nenet 186 dhe 248 të Kodit Penal.

E pyetur si person nën hetim, shtetasja L.R ka pranuar të ketë tërhequr shumën 200,000 lekë pranë “Raiffeisen Bank”, por ka mohuar të ketë nënshkruar në emrin e nënës së saj. Ajo ka shpjeguar se është njoftuar nga noteri se nëna e saj H. M ka hartuar një prokurë ku e autorizon atë të tërheqë shumën 200,000 lekë, të cilat sipas saj i takojnë si pjesë e familjes bujqësore. Më tej, shtetasja L.R ka shpjeguar se pasi ka tërhequr paratë i ka thënë nënës që i kishte marrë ato dhe kjo e fundit i ka thënë: “*Mos bëra gabim që t’i dhashë pa pyetur djalin*”. Shtetasi A.H ka shpjeguar se prokura e posaçme nr. \*\*\*, datë 22.4.2015, është përpiluar prej tij në zyrën noteriale në Ballsh. Ai shpjegon se ka shkuar shtetasja H.M e shoqëruar nga djali i saj dhe nusja e tij dhe ka kërkuar redaktimin e kësaj prokure. Ai ka hartuar prokurën në tri kopje dhe një kopje ia ka dhënë vajzës së znj. H.M, shtetasës L. R, duke qenë se në prokurë kjo e fundit ishte e autorizuar e shtetasës H.M. Nga këqyrja e regjistrimit noterial figuron e regjistruar si veprim noterial përpilimi i prokurës së sipërcituar.

Në vijim, me qëllim verifikimin e faktit, pasi i janë marrë dorëshkrime shtetasës H.M, shtetasja L.R, me qëllim përcaktimin e faktit nëse prokura nr. \*\*\*, datë 22.4.2015, është nënshkruar nga shtetasja H.M apo jo dhe nëse kjo prokurë është nënshkruar nga shtetasja L.R, është urdhëruar kryerja e ekspertimit grafik të shkrimit.

Nga aktekspertimi grafik nr. \*\*\*, datë 10.11.2015, ka rezultuar se:

- Shkrimi emër/mbiemër tek dokumenti “Prokurë e posaçme me nr. \*\*\*, datë 22.4.2015, në rubrikën ‘porositësi’”, është shkruar nga shtetasja H.M krahasuar me modelet e paraqitura në emrin e saj.

- Rezulton se shtetasja H. M, përkundrejt thënieve të kallëzuara, ka shkuar në zyrën e noterit A.H dhe ka përpiluar prokurën e posaçme nr. \*\*\*, datë 22.4.2015, duke autorizuar vajzën e saj L.R për të tërhequr shumën 200,000 lekë.

Në kallëzim, shtetasja H.M mohon qëllimisht se shuma e dëmshpërblyer prej 1,596,532 lekësh i përket të gjithë anëtarëve të familjes bujqësore dhe shtetases L.R, me qëllim mbajtjen e sasisë së të gjithë parave. Po ashtu, shtetasja H.M ka kallëzuar faktin e paqenë që nuk ka shkuar te zyra e noterit A.H dhe se nuk e ka shkruar ajo prokurën e posaçme ku të ketë autorizuar vajzën e saj, kur në fakt rezulton se prokura është shkruar nga shtetasja H.M.

Nga provat e administruara rezulton se shtetasja H.M ka konsumuar elementet e veprës penale “kallëzim i rremë”, parashikuar nga neni 305 i Kodit Penal.

Në këtë pjesë të aktit prokurorja parqet provat në të cilat mbështet akuzën dhe i kërkon gjykatës të merren në shqyrtim nga ana e saj.

Në përfundim, bazuar në nenin 331 të Kodit të Procedurës Penale, i ka kërkuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier: “*Gjykimin e çështjes penale nr. \*\*\*, datë 30.4.2015, me të pandehur H. M, akuzuar për veprën penale të ‘kallëzim i rremë’, parashikuar nga neni 305 i Kodit Penal*”.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. \*\*\*, datë 8.3.2016, ka vendosur deklarinin fajtoresh të të pandehurës H.M, për veprën penale “kallëzim i rremë”, parashikuar nga neni 305 i Kodit Penal, vendim i cili ka marrë formë të prerë pa ankim.

Nuk u konstatuan problematika lidhur me këtë çështje penale të ndjekur nga subjekti i rivlerësimit.

### **3. Të dhënat arkivore**

Nga verifikimi në arkivën e Prokurorisë së Përgjithshme dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë rezulton që ndaj prokurores Mariola Mërtiri nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

Në arkivën e Prokurorisë së Përgjithshme u gjetën vlerësimet e Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin Mariola Mërtiri, që i përkasin punës së saj për vitet 2012, 2013, 2014, 2015 dhe 2016, vlerësuar “shumë mirë”.

Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 29.10.2020, informon se në regjistrin e njoftimit të veprave penale të kësaj Prokurorie nuk rezulton që në emër të shtetases Mariola J Mërtiri të jetë regjistruar ndonjë procedim penal.

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 5.10.2020, rezulton të jetë regjistruar kallëzimi penal nr. \*\*\*/2014, mosfilluar, ku përmendet subjekti i rivlerësimit Mariola J Mërtiri.

Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier është administruar kallëzimi penal nr. \*\*\* i vitit 2011, ku është vendosur “Mosfillimin e hetimeve për materialin kallëzues të ardhur prej shtetasit L. H.”.

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 6.10.2020, informon se ka regjistruar procedimin penal nr. \*\*\*, për veprën penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 3.11.2017, ka vendosur shfuqizimin e vendimit për mosfillimin e

procedimit penal për kallëzimin e shtetasit L.H kundër prokurores së Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, Mariola Mërtiri.

Në arkivën e Prokurorisë së Përgjithshme janë administruar disa ankesa ose kërkesa në të cilat përmendet prokurorja Mariola Mërtiri nga shtetasit I. A., M. K. dhe R. K.

Subjekti i rivlerësimit, për ankesën e shtetasit R. K., iu kërkua të japë shpjegime lidhur me ndjekjen dhe respektimin e afateve të hetimit për procedimin penal nr. \*\*\*/2020.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti parashtroi: *“Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është dërguar për kompetencë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, me shkresën nr. \*\*\*/ prot. (E.L), datë 30.12.2019, fashikulli i procedimit penal nr. \*\*\*, viti 2018, pasi me vendimin e datës 12.12.2019 është vendosur shpallja e moskompetencës lëndore për veprat penale ‘falsifikim i dokumenteve’ dhe ‘shpërdorim detyre’, të parashikuara nga nenet 186 dhe 248 të Kodit Penal dhe kalimi i akteve të këtij procedimi penal Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.*

*Ky fashikull është protokolluar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 30.12.2019, me nr. protokollit \*\*\*.*

*Sipas akteve të këtij procedimi, ka rezultuar se në Prokurorinë e Përgjithshme, në datën 8.2.2018, nga ana e shtetasve P.Rr, M.Th, Gj.M, P.P dhe R.K është depozituar një kallëzim penal, pa identifikuar persona konkretë. Nga përmbajtja e kallëzimit rezulton se këta shtetas kërkojnë të hetohen të gjithë zyrtarët e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shkodër, Agjencisë së KKP-së Tiranë dhe Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike Tiranë. Ky kallëzim, me shkresën nr. \*\*\*/ prot., datë 7.8.2018, i është dërguar për kompetencë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër.*

*Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër në datën 12.10.2018 ka regjistruar procedimin penal nr. \*\*\*/2018, bazuar në kallëzimin e shtetasve P. Rr, M.Th, Gj.M, P. P dhe R.K për veprat penale ‘falsifikim i dokumenteve’ dhe ‘shpërdorim detyre’, të parashikuara nga nenet 186 dhe 248 të Kodit Penal.*

*Referuar formularit për trajtimin e procedimit penal nr. \*\*\*/2018, datë 13.1.2020, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kjo dosje penale më ka kaluar për ndjekje sipas shortit manual të mbajtur në të njëjtën ditë, duke u caktuar edhe oficeri i policisë gjyqësore I. M.*

*Në datën 5.2.2020 kam marrë vendimin ‘Për pranimin e akteve dhe regjistrimin e çështjes nr. \*\*\*, datë 5.2.2020’ dhe po në të njëjtën datë kam urdhëruar kryerjen e veprimeve hetimore nga OPGJ I.M.*

*Me anë të shkresës nr. \*\*\*/ prot., datë 6.3.2020, është dërguar për kompetencë nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë kallëzimi penal nr. \*\*\*, datë 25.3.2020, i paraqitur nga shtetasit P.Rr, M. Th, Gj.M, P.P dhe R.K.*

*Në datën 16.4.2020 prokurori Y.P ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal nr. \*\*\*, datë 26.4.2020, për veprën penale ‘shpërdorim detyre’, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, mbi bazën e akteve të kallëzimit penal nr. \*\*\*, datë 25.3.2020, të përcjellë për kompetencë nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.*

*Në datën 18.6.2020, duke qenë se faktet e trajtuara në të dy procedimet penale ishin të njëjta, kam marrë vendim ‘Për bashkimin e procedimeve’ nr. \*\*\*/ dhe nr. \*\*\*/ të vitit 2020 dhe vazhdimin e hetimeve në një procedim penal të vetëm me nr. \*\*\*/ të vitit 2020.*

*Në vijim kam kryer disa veprimet hetimore, duke mbajtur edhe procesverbalet përkatëse<sup>53</sup>.*

*Në fund të relacionit 'Përfundimi i veprimeve hetimore të procedimit penal nr. \*\*\*, viti 2020', OPGJ I.M sugjeron si vijon: 'Pushimin e hetimeve të procedimit penal nr. \*\*\* të vitit 2020 për punonjësit e Ministrisë së Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës dhe të Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronës Publike pranë Ministrisë së Financave. Për punonjësit e Bashkisë Shkodër dhe ato të ZVRPP-së Shkodër është kompetencë e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër të gjykojë se kanë kryer ose jo vepër penale'.*

*Rezulton se hetimi është kryer në një kohë të shpejtë dhe nga ana ime është ushtruar kontroll mbi veprimet e oficerit në mënyrë që çështja mos të kishte zvarritje, si dhe kërkesa për pushim është argumentuar sipas shkaqeve ligjore të sipërcituara.*

*Sqaroj se në lidhje me veprimtarinë time në kuadër të këtij procedimi penal është bërë ankim edhe tek Inspektori i Lartë i Drejtësisë (ILD), ankesa nr. \*\*\* prot., datë 18.2.2021, i shtetasve P.Rr, M.Th. Gj. M, P. P dhe R.K.*

*Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka vendosur të arkivojë ankesat e këtyre shtetasve bazuar në nenin 122, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, 'Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë'".*

#### **Vlerësimi i Komisionit**

Trupi gjykues vlerësoi përgjigjet e subjektit lidhur me këtë çështje dhe i konsideroi veprimet e saj në përputhje me ligjin, të verifikuar edhe nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

#### **4. Analiza e gjetjeve**

Nga analiza e tri dokumenteve ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit dhe vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të shortuara, rezulton se prokurorja Mariola Mërtiri, sa i përket periudhës së rivlerësimit, shfaq aftësi në drejtim të zbatimit të ligjit.

Prokurorja Mariola Mërtiri shfaq aftësi shumë të mira në kuptimin dhe interpretimin e drejtë të legjislacionit në fuqi. Ajo përdor arsyetim të qartë dhe lidh drejt normën ligjore me zbatimin e saj në rastin konkret hetimi. Subjekti ka njohuri të plota rreth instituteve të së drejtës penale. Ajo shfaq njohuri të mira edhe në drejtim të kuptimit dhe zbatimit të normave të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale.

Nga dosjet e vëzhguara konstatohet se e ka të qartë drejtimin e hetimit që do të kryejë në rastin konkret për procedimet të cilat janë ndjekur nga prokurorja. Kështu, menjëherë pasi urdhëron regjistrimin e procedimit, subjekti i rivlerësimit përcakton detyrat me shkrim për oficerin e policisë gjyqësore, duke i përshkruar konkretisht se çfarë duhet të kryejë dhe duke i vendosur afatin e kryerjes së tyre.

Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara është konstatuar se ajo identifikon saktë normën ligjore të zbatueshme.

Nga analiza e tri dokumenteve ligjore të paraqitura nga prokurorja dhe vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të shortuara evidentohet se subjekti i rivlerësimit Mariola Mërtiri shfaq aftësi në arsyetim ligjor.

Vendimet e marra dhe aktet e kryera prej saj kanë shtjellim të kuptueshëm. Subjekti organizon aktin në përputhje me standardet e pranuar për aktet përkatëse dhe tregon kujdes që konkluzionet e saj të përfaqësojnë një lidhje koherente mes fakteve të parashtruara në akt dhe bazës ligjore të përdorur gjatë arsyetimeve.

---

<sup>53</sup>Shihni shpjegimet e subjektit mbi rezultatet e hetimit.

Sipas të dhënave rezulton se për periudhën e punës prokurorja ka trajtuar 533 çështje.

Nga gjetjet në dokumentet ligjore të përzgjedhura në shortin e zhvilluar në datën 23.1.2020 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për përzgjedhjen e pesë dokumenteve ligjore për periudhën e vlerësimit tetor 2013 – tetor 2016, rezulton se prokurorja Mariola Mërtiri tregon vëmendje në kryerjen e veprimeve hetimore në dinamikë dhe në respektim të afateve ligjore të kërkuara, duke i dhënë një zgjidhje të shpejtë çështjeve të trajtuara.

Prokurorja Mariola Mërtiri kryen veprime procedurale hetimore dhe veprimet rezultojnë të jenë produktive. Konstatohet që nga ana e subjektit të rivlerësimit veprimet dhe procedurat në kuadër të procedimeve penale dhe materialeve kallëzuese u referohen dispozitave ligjore përkatëse, duke mbledhur provat e aktet e nevojshme dhe konkluduar në një vendimmarrje. Lidhur me njoftimet e vendimmarrjeve konstatohet se është respektuar detyrimi për të kryer njoftimet përkatëse subjekteve.

Gjithashtu vihet re se qëndrimi i prokurores në seancë gjyqësore është korrekt dhe etik, duke shprehur qëndrimin e tij të arsyetuar ligjor lidhur me çështjet objekt gjykimi.

Prokurorja ka treguar aftësi të mira në drejtim të përfundimit të hetimeve, rregullsisë së akteve dhe mbajtjes së tyre sipas një rregulli të mirëpërcaktuar në dosjet përkatëse. Dosjet e vëzhguara janë të rregullta, të plota dhe aktet procedurale të përpiluara janë të strukturuar dhe në respektim të normave të drejtshkrimit.

Nga aktet e përzgjedhura nga vetë prokurorja, si dhe nga dosjet e hedhura në short, ka rezultuar se gjuha e përdorur në përpilimin e akteve është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit. Nuk rezulton të ketë pasur ankesa se nga ana e subjektit të jenë kryer veprime apo mbajtur qëndrime të tilla jo në përputhje me etikën profesionale të prokurores.

Nga tri dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga pesë dosjet e rëna në short nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të prokurores Mariola Mërtiri. Në asnjë prej pesë dosjeve të vëzhguara nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak paanësie të dokumentuar.

Nga tri dokumentet ligjore të vetëpërzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe pesë dosjet e përzgjedhura në short vihet re se komunikimi është në përputhje me etikën e prokurorit dhe i qartë.

Në lidhje me vlerësimin e aftësive për të bashkëpunuar, nga vlerësimet e punës së subjektit Mariola Mërtiri për vitet 2013, 2014, 2015 dhe 2016 të Prokurorit të Përgjithshëm rezulton se është vlerësuar “shumë mirë” për aftësitë e bashkëpunimit.

## **5. Gjetje të tjera lidhur me kriterin e aftësive profesionale**

### **5.1 Lidhur me dy procedime penale**

Komisioni ka administruar dosjet e hetuara nga subjekti i rivlerësimit, që lidhen me dy procedime penale, përkatësisht me nr. \*\*\*/2015 dhe nr. \*\*\*/2012, ndaj shoqërisë “\*\*\*\*” sh.a., ku bashkëshorti i saj ishte i punësuar për periudhën tetor 2013 – 2019.

#### **5.1.1 Procedimi nr. \*\*\*/2015**

Përfaqësues të dy shoqërive (“\*\*\*\*” sh.a. dhe “\*\*\*\*”) iu drejtuan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier në lidhje me dëshirën për të marrë pjesë në një ankand publik të organizuar nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.a. në qershor 2015. Këta përfaqësues pretendonin se ishin penguar të hynin në ambientet e shoqërisë nga rojet e “\*\*\*\*” sh.a. në kohën kur duhej të dorëzonin ofertën e tyre (ora 10:00 e datës 22.6.2015). Supozohej se rojet raportuan se ata vepruan sipas urdhrorit të administratës së shoqërisë. Përfaqësuesit e shoqërive pretenduan se kishin mbërritur në ambientet e shoqërisë përpara kohës së caktuar për dorëzimin e ofertave (ora 9:45), por nuk u lejuan të hynin në ambientet e saj deri në orën 11:00, kur kishte përfunduar ankandi, gjë që çoi

në skualifikimin e tyre. Ndër të tjera, ata pretenduan se i kishin telefonuar në orën 9:58 një punëdhënësi të shoqërisë “\*\*\*” sh.a. për të sqaruar se pse po pengoheshin të hynin në ndërtesë dhe të dorëzonin ofertat e tyre. Kjo thirrje është dorëzuar në prokurori në cilësinë e provës.

Në të njëjtën ditë me ankandin, më 22.6.2015, përfaqësuesit e skualifikuar të shoqërive iu drejtuan prokurorisë me pretendimet e tyre. Çështja është regjistruar nga subjekti i rivlerësimit në datën 14.10.2015, ndërsa disa hetime që kanë të bëjnë me deklaratimet e përfaqësuesve dhe me disa kërkesa për informacion pranë shoqërisë “\*\*\*” sh.a. dhe Komisionit të Prokurimit Publik u zhvilluan gjatë muajve qershor dhe korrik. Procedimi është regjistruar për veprën penale të parashikuar nga neni 258 i Kodit Penal, “shkelje e barazisë së pjesëmarrësve në tendera ose ankandet publike”.

Subjekti i rivlerësimit ka kërkuar informacion dhe ka marrë në pyetje personat e dyshuar për përfshirje në këtë çështje (anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave dhe rojet në shërbim të shoqërisë “\*\*\*” sh.a.) gjatë periudhës janar - shkurt 2016.

Në mars të vitit 2016, subjekti vendosi pushimin e çështjes, për shkak se marrja në pyetje e personave të përfshirë nuk siguroi asnjë provë thelbësore, ndërsa rojet, përveç që nuk pranuan se kishin vepruar siç u pretendua nga përfaqësuesit e kompanive, nuk dukej të ishin objekt i dispozitës penale në fjalë, e cila parashikon se autorë të veprës penale janë subjekte që kanë një funksion publik ose që kryejnë shërbime publike.

Duhet theksuar se dosja hetimore ofron të dhënat e duhura për të vlerësuar aftësinë profesionale të subjektit të rivlerësimit, veçanërisht në lidhje me atë që mund të shihet si një situatë konflikti interesi gjatë hetimit të çështjes.

Hetimi duket se përmban të meta të dukshme procedurale dhe materiale, si: regjistrimi shumë i vonuar i çështjes; mosnxjerrja e vendimeve mbi shtyrjen e veprimeve hetimore çdo tre muaj; mosbërja në kohën e duhur të hetimeve për mbledhjen e informacionit dhe dëshmive sa më të vërteta, të pamanipuluara nga koha apo faktorë të tjerë; mosballafaqimi i deklaratave; mosmbledhja e tabulateve telefonike, të cilat mund të hidhnin dritë mbi komunikimet mes anëtarëve të komisionit apo zyrtarëve të tjerë të lartë të kompanisë me rojet; mungesa e përgjimeve për të kuptuar dinamikën e mundshme të personave të përfshirë; mosmbledhja e dëshmive të pjesëmarrësve të tjerë që mbetën jashtë ankandit (nga 10 pjesëmarrës vetëm një mundi të hynte në ambientet e shoqërisë në kohën e duhur, dhe ky rezultoi fitues) etj.

Hetimi dhe pretendimet mund të përfshinin jo vetëm anëtarët e vlerësimit të ofertave, por, më e rëndësishmja, administratorin e shoqërisë (punëdhënësi dhe eprori i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit) si përfaqësues i autoritetit kontraktor që përcakton rregullat e ankandit dhe si personi që përfundimisht vendos pezullimin ose miratimin e procedurave të ankandit dhe palët fituese, si dhe punëdhënësin/eprorin e rojeve.

Kështu, për këto gjetje (dinamika e hetimit, provat dhe të dhënat e administruara, situata e mundshme e konfliktit të interesit) subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti parashtrori: *“Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 26.6.2015, Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë ka referuar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë për vlerësim kallëzimin e shtetasve N. B dhe A. G. Në kohën e referimit të këtij materiali, sipas nenit 148 të Kushtetutës dhe nenit 24/4 të Kodit të Procedurës Penale, Prokuroria ka qenë organ i centralizuar ku urdhrat dhe udhëzimet e prokurorit më të lartë ishin të detyrueshme për zbatim nga prokurori më i ulët. Drejtuesi i Prokurorisë i ka sigluar materialin zëvendës drejtuesit dhe ky i fundit ka bërë shënimin ‘Znj. Mariola’, për verifikim. Shënimi mban datën 29.6.2015.*



*Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 7.7.2015, nga ana ime, në funksion të verifikimit të pretendimeve të ngritura në kallëzim, i kam kërkuar informacion Agjencisë së Prokurimit Publik Tiranë në lidhje me zhvillimin e këtij ankandi, a ka pasur ankesa, a është ankimuar në APP procedura e ndjekur për shpalljen e fituesit. Nëse po, cila ka qenë vendimmarrja.*

*Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 21.7.2015, në cilësinë e prokurores së çështjes i kam kërkuar informacion Komisionit të Prokurimit Publik, në funksion të verifikimeve të pretendimeve të paraqitura në kallëzim: A kanë depozituar ankesa përfaqësuesit e shoqërisë '\*\*\*' dhe '\*\*\*' në lidhje me procedurat e ndjekura në ankandin e zhvilluar nga '\*\*\*' sh.a., në datën 22.6.2022, ora 10:00. Po ashtu, po në të njëjtën datë, i kam kërkuar informacion shoqërisë '\*\*\*' sh.a., për të verifikuar pretendimet e kallëzuesve.*

*Veprimet e mia janë kryer brenda një jave, duke konsideruar se datat 2 dhe 3 qershor të vitit 2015 kanë qenë ditë e shtunë dhe e diel.*

*Komisioni i Prokurimit Publik, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 27.7.2015, ka informuar se: '...deri në datën 27.7.2015 nuk është regjistruar asnjë ankesë pranë institucionit tonë lidhur me këtë procedurë ankandi'.*

*Pas kryerjes së verifikimeve të mësipërme kam urdhëruar regjistrimin e procedimit penal, duke vlerësuar se duhet të kryheshin hetime të mëtejshme në lidhje me veprën penale 'shkelje e barazisë së pjesëmarrjes në tendera', parashikuar nga neni 258 i Kodit Penal. Procedimi penal është regjistruar në datën 14.10.2015, në regjistrin e veprave penale pa autor.*

*Në datën 14.10.2015 kam urdhëruar kryerjen e veprimeve hetimore<sup>54</sup>.*

*Pas kryerjes së veprimeve hetimore, në analizë të rrethanave të faktit, provave të administruara, në raport këto me elementet e veprës penale 'shkelje e barazisë së pjesëmarrjes në tendera', parashikuar nga neni 258 i Kodit Penal, është vendosur pushimi i procedimit penal nr. \*\*\*, datë 14.10.2015, sipas nenit 328, germa "b" e Kodit të Procedurës Penale.*

*Ky vendim, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 26.4.2016, u është njoftuar palëve kallëzuese, të cilat nuk rezultojnë të kenë paraqitur ankim.*

*Në lidhje me konfliktin e interesit për shkak të marrëdhënieve të punësimit të bashkëshortit të subjektit, sjell në vëmendjen tuaj edhe praktikën gjyqësore të Kolegjit, dhe konkretisht vendimin nr. 15, datë 18.6.2021, ku për situatë të njëjtë për një subjekt tjetër Kolegji ka dhënë argumentet përkatëse".*

### **5.1.2 Procedimi nr. \*\*\*/2012**

*Ky procedim përfshin edhe hetimin nga subjekti i rivlerësimit të punonjësve të shoqërisë "\*\*\*\*\*" sh.a. gjatë viteve 2012 – 2014. Hetimi përfundoi në mars të vitit 2014 dhe subjekti i rivlerësimit dërgoi në gjyq 6 punonjës, anëtarë të një grupi teknik, që kishin shpërdoruar detyrën, duke pranuar një makineri të shtrenjtë në emër të kompanisë, me sa duket pa kontrolluar me kujdes kushtet teknike të saj.*

*Hetimi nuk paraqet ndonjë veçori të rëndësishme, përveç faktit se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka filluar të punojë në këtë shoqëri në tetor të vitit 2013, ndërkohë që hetimet ishin në vazhdim.*

*Komisioni konstatoi se subjekti duket se ka ushtruar hetimin në kushtet e konfliktit të interesit. Për këtë gjetje subjektit iu kërkua të japë shpjegime në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.*

---

<sup>54</sup>Shihni shpjegimet e subjektit në përgjigje të rezultateve të hetimit.

## **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti parashtrroi: “Në datën 12.11.2012, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, mbi bazën e materialit hetimor të referuar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit Tiranë, ka regjistruar procedimin penal nr. \*\*\*, për veprën penale ‘shpërdorim detyre’, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

Në datën 17.3.2014 çështja i është përcjellë gjykatës për gjykim, në ngarkim të shtetasve H.Gj., V. Xh., V. N., G. K., Dh. C. dhe Sh. R. për veprën penale ‘shpërdorim detyre’, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

Fakti penal të cilit i referohej ky procedim lidhet me një ngjarje të ndodhur në vitin 2009, kohë kur bashkëshorti im nuk ka qenë i punësuar në këtë shoqëri.

Në përfundim të hetimit, nga ana ime çështja i është përcjellë për gjykim Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

Kodi i Procedurës Penale e trajton konfliktin e interesit në dispozitat që kanë për objekt heqjen dorë nga prokurori në një çështje të caktuar, konkretisht në nenet 26 dhe 17 të tij.

Në referim të nenit 17 të Kodit të Procedurës Penale nuk rezulton që të kem pasur shkak ligjor për të paraqitur kërkesën për heqje dorë nga hetimi i këtij procedimi penal. Gjithashtu vërtetohet se subjekti i kallëzuar nuk është punëdhënës i bashkëshortit tim as në kohën e ngjarjes dhe as në kohën e procedimit”.

## **Vlerësimi i Komisionit**

- Trupi gjykues i konsideroi bindëse përgjigjet dhe shpjegimet e subjektit dhe nuk konstatoi ndonjë problematikë që lidhet me kriterin profesional të subjektit të rivlerësimit në këto dy çështje.
- Subjekti ka ndjekur hapat proceduralë lidhur me këto procedime penale dhe zgjidhjen e çështjes e ka dhënë bazuar në dispozitat ligjore në fuqi. Veprimet e saj dhe ndjekja e hetimeve është bërë në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale.
- Nuk rezultoi që subjekti të këtë ushtruar detyrën në kushtet e konfliktit të interesit.

### **5.1.3 Procedimi nr. \*\*\*/2020**

Ky procedim u soll në vëmendje nga një denoncim ndaj disa subjekteve të rivlerësimit, ndër të cilët gjyqtari A.B, i kallëzuar penalisht në SPAK pas shkarkimit nga detyra me vendim të Komisionit, me akuza për “mosdeklarim pasurie” dhe “deklarim të rremë”. SPAK ia ka përcjellë dosjet Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Çështja për gjyqtarin B iu caktua subjektit të rivlerësimit Mariola Mërtiri.

Çështja u regjistrua në datën 20.5.2020 për veprën penale “mashttrim” (neni 143 i Kodit Penal), “fshehje e aseteve” (neni 143/a/6), “shpërdorim detyre” (neni 248), “refuzim për deklarim, mosdeklarim, fshehje apo deklarim i rremë i pasurisë dhe i interesave privatë...” (neni 257/a). Në datën 28.2.2020 çështja është pushuar me një vendim mosfillimi.

Subjekti i rivlerësimit iu referua pjesës konkluduese të vendimit të Komisionit.

Pas renditjes së elementeve objektive dhe subjektive për secilën nga veprat penale të përmendura, subjekti i rivlerësimit Mariola Mërtiri konkludoi se kallëzimi penal nuk përmban elemente konkrete, prova apo *indicie* që çojnë në fillimin e hetimit, përfshirë edhe akuzat për “mosdeklarim apo deklarim të rremë, sipas nenit 257/a të Kodit Penal. Subjekti i rivlerësimit argumentoi se, ndërsa hetimi i kryer nga Komisioni është i një natyre administrative që synon të rivendosë besimin e publikut tek organet e drejtësisë, anëtarët e trupit gjykues nuk kanë

paraqitur asnjë kallëzim penal për gjetjet e tyre. Ajo gjithashtu argumentoi se rasti ishte në shqyrtim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit.

Në këto rrethana, sipas subjektit, faktet e kallëzuar nuk ishin objekt i ndjekjes penale, por duhet të shqyrtohen nga Kolegji në lidhje me përshtatshmërinë e z. B për kriterin e kontrollit të figurës. Ky arsyetim solli marrjen e vendimit të mosfillimit në përputhje me nenin 290/1/ç të Kodit Penal, i cili parashikon se: *“Procedimi penal nuk mund të fillojë kur... fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale ose kur del qartë që fakti nuk ekziston”*.

Sa më sipër, vihet re se subjekti e ka nxjerrë këtë vendim pa kryer asnjë hetim për të vërtetuar bazueshmërinë e akuzave së paku për “mosdeklarim ose fshehje të pasurisë...” sipas nenit 257/a të Kodit Penal, pavarësisht disa elementeve të analizuara dhe të arsyetuara nga Komisioni ose gjetjeve të tjera që mund të dilnin pas analizimit të dosjeve të administruara ose të dokumenteve të tjera. Për më tepër, veprat e parashikuara nga neni 257/a i Kodit Penal nuk mund të ndiqen penalisht për shkak të afatit 5-vjeçar të parashkrimit.

Duhet theksuar gjithashtu se arsyetimi i subjektit për mungesën e një kallëzimi penal nga Komisioni duket se hedh poshtë mundësinë/detyrimin e shtetasve për të bërë kallëzime penale në përputhje me nenin 283 të Kodit Penal “Kallëzimi nga ana e shtetasve”, që parashikon se *çdo person që ka marrë djeni për një vepër penale që ndiqet kryesisht, duhet ta kallëzojë atë, duke çuar kështu në një mungesë të pajustificuar dhe të paligjshme të veprimeve hetimore, të cilat mund të kishin hedhur dritë mbi mundësinë e përgjegjësisë penale nga ana e z. B.*

Në bazë të sa më sipër, për moskryerjen e verifikimeve/hetimeve të nevojshme dhe mungesën e arsyetimit të duhur për mosfillimin e procedimit, i kalon barra e provës subjektit të rivlerësimit.

**Për këtë gjetje subjektit iu kërkua të japë shpjegime në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.**

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti parashitroi: *“Në datën 20.5.2020, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka regjistruar kallëzimin penal nr. \*\*\* mbi bazën e materialeve hetimore të ardhura për kompetencë lëndore nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar Tiranë, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 7.5.2020.*

*Në datën 28.4.2020, shtetasi F.D ka depozituar kallëzim penal në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për 20 gjyqtarë dhe prokurorë, të cilët nuk kanë arritur të kalojnë me sukses procesin e rivlerësimit nga Komisioni, duke i bashkëlidhur kallëzimit penal për secilin subjekt vendimin përkatës të marrë nga Komisioni.*

*Në lidhje me shtetasin A. B, në detyrën e ish-gjyqtarit në Gjykatën e Apelit Durrës, kallëzuesi i është referuar vendimit nr. \*\*\*, akti nr. \*\*\*, vendimi datë 18.11.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe nga konkluzionet e këtij vendimi ai pretendon se prej këtij subjekti janë konsumuar elementet e veprave penale ‘mashtrim’, ‘fshehje e pronësisë’, ‘shpërdorim detyre’ dhe “refuzim për deklarim, mosdeklarim, fshehje ose deklarim i rremë i pasurive interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim”, vepra këto të parashikuara respektivisht nga nenet 143, 143/a/6, 248 dhe 257/a të Kodit Penal.*

*Duke gjykuar elementet e veprës penale të mashtrimit, parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal, në raport këto me materialin kallëzues dhe specifikisht konkluzionet e marra nga Komisioni në*

*vendimin e shkarkimit të subjektit të rivlerësimit A.B, konkludohet qartësisht se fakti i pretenduar nga kallëzuesi nuk përmban elemente të kësaj veprë penale<sup>55</sup>.*

*Në vendimin e mosfillimit kam arsyetuar secilin nga elementet e veprës penale, për të cilin kallëzuesi ka kërkuar ushtrimin e ndjekjes penale”.*

### **Vlerësimi i Komisionit**

- Trupi gjykues vlerëson se kjo çështje ka në themel vendimmarrjen e magjistratit bazuar në provat e mbledhura dhe arsyetimin e tij bazuar në bindjen e brendshme. Magjistrati ushtron funksionet e tij në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin, në mënyrë të pavarur, duke vlerësuar faktet dhe interpretuar ligjin, sipas bindjes së tij të brendshme, i lirë nga çdo ndikim i drejtpërdrejtë ose i tërthortë nga çdo palë dhe për çdo arsye.

- Pika 4 e nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale të prokurorit, parashikon se: *“Vlerësuesi çmon aftësitë profesionale të prokurorit pa gjykuar mbi korrektesinë dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e prokurorit që vlerësohet”.*

### **5.2 Mbi disa procedime penale**

Komisioni, bazuar në praktikën e dërguar nga ONM-ja, ka administruar disa dosje profesionale nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier, mbi procedimet penale dhe/ose hetimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit, ku përfshihet Bashkia Fier, në kuadër të përmbushjes së kriterëve nga ana e subjektit të rivlerësimit nga Bashkia për kredinë e butë në vitin 2011.

#### **5.2.1 Procedimi penal nr. \*\*\*/2011**

Në datën 19.12.2011, subjekti i rivlerësimit ka pushuar procedimin penal nr. \*\*\*/2011, filluar pas kallëzimit penal të kryetarit të Bashkisë Fier, bazuar në dyshimet për shpërdorim detyre nga disa këshilltarë bashkiakë, duke thirrur një mbledhje dhe kryerjen e veprimeve në kundërshtim me ligjin. Në të njëjtën kohë, kryebashkiaku ka depozituar padi në gjykatën civile për të trajtuar çështjen. Në shqyrtimin e rrethanave të çështjes, subjekti i rivlerësimit në thelb ka arsyetuar se nuk ka elemente të ndonjë veprë penale, pasi pasojat dhe efektet janë pezulluar/ndrequr nga gjykata, duke e çuar subjektin e rivlerësimit në marrjen e vendimit për pushimin e procedimit penal.

Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur paraprakisht një kërkesë për heqje dorë për arsye të konfliktit të mundshëm të interesit lidhur me marrjen e një kredie të butë nga bashkia. Shefi i zyrës e autorizoi atë për vazhdimin e hetimeve me anë të një shënimi me shkrim dore mbi kërkesën e paraqitur.

#### **5.2.2 Kallëzimi penal nr. \*\*\*/2013**

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier në datën 18.4.2013 ka regjistruar kallëzimin nr. \*\*\* pas kallëzimit nga Sektori kundër Krimin Financiar Fier mbi: (i) dyshime për veprime të paligjshme nga zyrtarë publikë të Bashkisë Fier në kuadër të projektit për ndërtimin e Pallatit të Sportit gjatë viteve 2011 – 2012; dhe (ii) për përdorimin e fondeve nga bashkia gjatë viteve 2011 – 2012.

Në këtë rast nuk është paraqitur asnjë kërkesë për heqje dorë nga subjekti i rivlerësimit.

#### **5.2.3 Kallëzimi penal nr. \*\*\*/2014**

Në datën 21.5.2014, shtetasi A. K ka bërë kallëzim penal për akuzat “shpërdorim detyre” dhe “falsifikim i dokumenteve”, lidhur me lejen e ndërtimit (nr. \*\*\*/2008) dhe lejen e sheshit të ndërtimit (nr. \*\*\*/2008), lëshuar nga Këshilli i Rregullimit të Territorit të Bashkisë Fier, në

<sup>55</sup>Shihni shpjegimet e subjektit mbi rezultatet e hetimit.

favor të një kompanie ndërtimi, duke shkelur të drejtat e tij pronësore dhe jo në përputhje me ligjin. Z. K ka paraqitur padi në gjykatat administrative edhe në vitet 2009 dhe 2011. Ndërsa Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier ka rrëzuar pretendimet e z. K, Gjykata e Apelit ka urdhëruar shfuqizimin e dy lejeve të dhëna nga Këshilli i Rregullimit të Territorit dhe detyrimin e Këshillit për ndryshimin e tyre në përputhje me vendimin e gjykatës (vendim i datës 13.12.2011).

Në këtë rast nuk është paraqitur asnjë kërkesë për heqje dorë nga subjekti i rivlerësimit.

#### **5.2.4 Kallëzimi penal nr. \*\*\*/2015**

Në bazë të kallëzimit penal të shtetasit B. Xh, Drejtoria e Policisë së Qarkut Fier ka kallëzuar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Fier dyshimet për veprime të kundërligjshme të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit pranë Bashkisë Fier mbi pasurinë e këtij shtetasi. Z. Xh ka kallëzuar se në datën 7.10.2015 Inspektorati ka prishur një mur rrethues dhe disa pemë të vendosura në një sipërfaqe prej 1.627 m<sup>2</sup>, të regjistruar në emër të tij. Z. Xh pretendoi se nuk kishte marrë asnjë njoftim për shembjen (arsyetuar nga Inspektorati me qëllim të lirimit të hapësirave publike, sipas urdhrorit të datës 2.9.2015), ndërsa për këtë çështje i është drejtuar Bashkisë, pasi trualli ku muri ishte ndërtuar prej dekadash, ishte pronë e tij private dhe e pakualifikuar si hapësirë publike.

Në këtë rast nuk është paraqitur asnjë kërkesë për heqje dorë nga subjekti i rivlerësimit.

#### **5.2.5 Kallëzimi penal nr. \*\*\*/2015**

Subjekti i rivlerësimit ka dhënë vendim për mosfillim të procedimit penal në datën 5.6.2012, pasi i ka gjetur të pabazuara pretendimet e denoncuesit për “shpërdorim detyre” dhe “shkatërrim prone” ndaj kryetarit të Bashkisë B. Z dhe inspektorëve të ndërtimit.

Në këtë rast nuk është paraqitur asnjë kërkesë për heqje dorë nga subjekti i rivlerësimit.

Lidhur me gjetjet për disa procedime penale, subjektit iu kërkua të japë shpjegime në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti parashtrroi shpjegimet<sup>56</sup> e saj për të gjitha këto procedime penale, si vijon:

##### ***“Procedimi penal nr. \*\*\*, viti 2011***

*Procedimi penal i mësipërm është regjistruar në datën 21.9.2011. Duke vlerësuar kohën e afërt nga momenti i përfitimit prej meje të një kredie me kushte lehtësuese, si dhe faktin se objekti i hetimit lidhet me pretendimin mbi vendimmarrjet e konstituimit të Këshillit të ri Bashkiak, kam paraqitur kërkesën për heqje dorë nga hetimi i kësaj çështjeje, me qëllim shmangien e një konflikti në dukje interesi. Drejtuesi i Prokurorisë ka vlerësuar se mungojnë shkaqet ligjore për të pranuar dorëheqjen, duke mos pranuar kërkesën time dhe duke urdhëruar vijimin e hetimeve.*

*Krahas kësaj, sqaroj se vendimmarrja ime ka qenë e paanshme, duke rrëzuar pretendimet e paraqitura nga Bashkia Fier, e cila ka pasur cilësinë e kallëzuesit. Vendimmarrja ime ka qenë objektive, e paanshme dhe e mbështetur në prova dhe ligj.*

##### ***Kallëzimi penal nr. \*\*\*/2013***

*Vendimi i mosfillimit të procedimit penal në lidhje me këtë material kallëzues vjen si rezultat i shqyrtimit të rrethanave të faktit, verifikimit të kryer në raport me ligjin përkatës, që normon*

---

<sup>56</sup>Shihni shpjegimet e subjektit në përgjigje të rezultateve të hetimit.

*në këtë rast veprimtarinë e pushtetit lokal, Bashkisë. Nga ana ime është bërë një hetim shterues në rastin konkret, që do të thotë se kam kryer të gjitha veprimet e nevojshme në kuadër të verifikimit të faktit objekt kallëzimi. Nuk kam vlerësuar kryerjen e ndonjë verifikimi tjetër, pasi nga rrethanat e faktit në raport me elementet e veprës penale dhe ligjit organik kam konkluduar se fakti nuk përmbante elemente të veprës penale.*

*Sqaroj se ligji i kohës i zbatueshëm në marrjen e këtij vendimi parashikonte në nenin 24 e vijues të Kodit të Procedurës Penale se veprimtaria e prokurorit, duke përfshirë edhe vendimmarrjen, është e kontrollueshme nga një prokuror më i lartë, që në kuptim të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale kuptohet prokurori i rrethit. Si rrjedhojë e organizimit të prokurorisë si një organ i centralizuar, çdo prokurori ka pasur zëvendës drejtues dhe Drejtuesin e Prokurorisë, të cilët shqyrtonin çdo vendimmarrje të prokurorëve dhe, në rast se konstatojnë se nevojitet kryerja e veprimeve të tjera hetimore apo nuk ishin dakord mbi mënyrën e zgjidhjes së çështjes, vendosnin 'shfuqizimin e vendimit të prokurorit' si të pabazuar në ligj dhe prova. Nga administrimi i fashikullit penal, më rezultoi se vendimmarrja ime është kontrolluar dhe miratuar nga Drejtuesi i Prokurorisë, duke u gjetur e bazuar në ligj dhe në prova. Po ashtu, kjo vendimmarrje nuk rezultoi të jetë ankimuar nga pala kallëzuese.*

#### **Kallëzimi nr. \*\*\*/2014**

*Pretendimi i kallëzuesit lidhet kryesisht me lejen e ndërtimit dhe ndryshimin e projektit që është pjesë e lejes së ndërtimit. Nga administrimi i dosjes rezultoi që kallëzuesi ka investuar gjykatën në lidhje me padinë për pavlefshmërinë e lejes së ndërtimit.*

*Nga ana ime është marrë vendimi i mosfillimit, duke vlerësuar se në kohën kur është depozituar kallëzimi çështja kishte marrë zgjidhje në rrugë administrative. Nga ana tjetër, kallëzuesi nuk ngrinte pretendim për falsitet të ndonjë akti zyrtar konkret, për të cilin organi procedues të fillonte hetimet. Veç sa sipër, në rastet kur çështja ndjek rrugën gjyqësore, pretendimet për falsitet janë pjesë e shqyrtimit gjyqësor. Në nenin 195 të Kodit të Procedurës Penale është parashikuar konkretisht se: 'Gjykata, kur çmon se një dokument i marrë është fals, pas përfundimit të procedimit njofton prokurorin duke i dërguar dhe dokumentin'.*

*Në rastin konkret, kam vlerësuar se çështja kishte marrë trajtimin gjyqësor dhe nëse gjatë gjykimit do të ishin konstatuar dokumente konkrete të falsifikuara, do të ishte njoftuar prokurori. Kjo zgjidhje bëhet gjithmonë për të mos u bërë palë me asnjë palë ndërgjyqësore, pasi regjistrimi i një procedimi penal do të passillte pezullimin e gjykimit administrativ/gjyqësor e, për rrjedhojë, zvarritje të panevojshme të një procesi gjyqësor administrativ.*

*Nga ana tjetër, sqaroj se vendimi i mosfillimit me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 22.7.2014, i është komunikuar kallëzuesit në adresë dhe, veç kësaj, një kopje e ka marrë kundrejt nënshkrimit. Kallëzuesi nuk ka paraqitur pretendime në lidhje me vendimmarrjen time, si nëpërmjet ankimit të prokurorit më i lartë.*

*Po ashtu, kjo vendimmarrje është kontrolluar dhe miratuar nga Drejtuesi i Prokurorisë si e marrë në mbështetje të ligjit dhe provave.*

#### **Kallëzimi nr. \*\*\*, viti 2015**

*Në datën 29.10.2015, pas materialeve të referuara nga Drejtoria Vendore e Policisë Fier, është regjistruar kallëzimi penal nr. \*\*\*. Nga materialet e këtij kallëzimi rezultoi se në datën 8.10.2015 është paraqitur në ambientet e Drejtorisë së Policisë së Qarkut Fier shtetasi B.Xh, i cili ka pretenduar se nga ana e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit të Bashkisë Fier janë kryer veprime në mospërmbushje të rregullt të detyrës, duke i prishur kallëzuesit objektin e tij.*

Duke vlerësuar se prishja e objektit është bërë mbi bazën e një vendimi për interes publik, sikurse është dhe rehabilitimi i rrugës, kam konkluduar se mungojnë elementet e veprës penale ‘shpërdorim detyrë’, e cila, që të konsiderohet e konsumuar, kërkon domosdoshmërisht kryerjen e veprimeve ose mosveprimeve në kundërshtim me ligjin, me dashje, dhe prej këtyre veprimeve t’i ketë ardhur pasojë shtetit, shtetasve. Prishja e objektit për interes publik nuk lidhet me faktin nëse poseduesi i pronës është pronar me titull pronësie apo e ka objektin pa leje ndërtimi. Në lidhje me faktin se në listën e personave të shpronësuar nuk ka qenë emri i këtij shtetasi, vlerësoj se kjo ka ndodhur në mungesë të dokumentit të pronësisë mbi objektin që do të prishej. Kjo pasi nga vetë lista e Këshillit Bashkiak që ka vendosur vlerën e shpronësimit të banesave që prekeshin nga ky projekt, përbri çdo emri është dhe certifikata e pronësisë.

#### **Kallëzimi penal nr. \*\*\*/2012 (\*\*\*/2015)**

Nuk kam trajtuar asnjë çështje me palë kallëzuese/të kallëzuar Bashkinë Fier prej vitit 2008 kur unë kam filluar detyrën si prokurorë deri në prill të vitit 2011, kur unë kam përfutur kredinë me kushte lehtësuese, fakt i vërtetuar me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 8.11.2022, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier. Në këto kushte nuk ka asnjë dyshim objektivisht të justifikueshëm që të këtë ndikuar detyra ime në vendimmarrjen e Këshillit Bashkiak për përfitimin e kredisë së butë. Kredia e butë është përfutur si familje që plotëson kushtet dhe kriteret ligjore të parashikuara nga ligji dhe Këshilli Bashkiak Fier si organi kompetent për trajtimin e këtyre kërkesave ka pasur detyrimin ligjor për të më mundësuar këtë lloj kredie. Kjo e drejtë ligjore që mua më takonte si e pastrehë, nuk mund të interpretohet si një favorizim. Me vendimmarrjen e Këshillit Bashkiak në datën 30.3.2011, marrëdhënia ime me Këshillin Bashkiak ka përfunduar. Pas kësaj date vijon vetëm marrëdhënia e kredisë bankare, në të cilën banka është palë kreditore dhe unë palë debitore, sipas kushteve të kontratës së nënshkruar. Ndërsa Këshilli Bashkiak nuk ka më asnjë cilësi në këtë marrëdhënie detyrimi me bankën.

Në katër dosjet e tjera, ku unë kam trajtuar materiale kallëzuese me palë Bashkinë Fier, nuk kam depozituar kërkesë për heqje dorë. Referuar subjektit të kallëzuar, duhet te evidentoj se Bashkia (kryetari i Bashkisë), referuar nenit 7 të ligjit nr. 139/2015, ‘Për vetëqeverisjen vendore’, është një organ ekzekutiv me kompetenca të ndara nga Këshilli Bashkiak, si organ ekzekutiv kolegjal i pushtetit vendor dhe në përbërjen e Këshillit Bashkiak kryetari i Bashkisë përfaqëson një votë, ndërsa vendimmarrja është sipas pjesëmarrjes së këshilltarëve në votim.

Në të katërta këto raste, unë nuk kam depozituar kërkesë për heqje dorë, për shkak edhe se rrethanat tashmë kishin ndryshuar thelbësisht:

- i) kishin kaluar mbi 2 vjet nga përfitimi i kredisë;
- ii) përbërja e Këshillit Bashkiak kishte ndryshuar pas zgjedhjeve vendore të datës 8.5.2011, të zhvilluara sipas nenit 7 të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” dhe Kodit Zgjedhor.

Në analizë përfundimtare të fakteve të mësipërme dhe ligjit, përfitimi i kredisë së butë nuk justifikon pretendimin për mundësinë e një qëndrimi paragjykes tim si prokuror në hetimin e të katërta çështjeve sipas nenit 17 e vijues të Kodit të Procedurës Penale, si shkak për konflikt interesi (papajtueshmëri) dhe, në sinkron me të, për të dhënë dorëheqjen”.

#### **Vlerësimi i Komisionit**

- Trupi gjyqësor, pas shpjegimeve të subjektit, vlerëson se ajo nuk është ndodhur në situatën e konfliktit të interesit gjatë shqyrtimit të këtyre pesë çështjeve penale.
- Bazuar në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, konflikt i interesit është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë

ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të tij publike.

- Në asnjë nga rastet e mësipërme nuk u provua që subjekti të ketë ushtruar detyrën në situatën e konfliktit të interesit. Bazuar në ligjin nr. 9232, datë 13.5.2004, “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, dhënia e kredisë së butë është bërë me vendim dhe miratim të Këshillit Bashkiak Fier si organ kolegjal. Në çështjet e ndjekura nga subjekti nuk u provua që ajo të ketë pasur ndonjë çështje penale me ndonjë anëtar të Këshillit Bashkiak Fier.

## DENONCIME

Për subjektin e rivlerësimit janë paraqitur në Komision 6 denoncime, si vijojnë:

### 1. Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 14.7.2020, i shtetas E.H

Kjo ankuesë ankohet për shkelje të etikës profesionale dhe zvarritje në proces nga subjekti i rivlerësimit Mariola Mërtiri. Ankuesja është ankuar edhe për një subjekt tjetër rivlerësimi, por për prokuroren Mariola Mërtiri ajo ankohet se: *“Duke dalë me vendim pushimi procedimi penal ajo nuk ka marrë parasysh kërkesën time për të hetuar për mënyrën se si ish-bashkëshorti ka hyrë në ambientet e mia të banesës”*.

Shtetasja E. H ka bërë kallëzim penal për ngjarjen ndaj ish-bashkëshortit të saj M. B dhe dosja i kalon prokurores Mariola Mërtiri, e cila ka vendosur mosfillimin e procedimit penal. Sipas denoncueses, në këtë vendim nuk merret parasysh kërkesa *“për të hetuar mbi mënyrën se si ish-bashkëshorti im kishte hyrë në ambientet e mia të shtëpisë, ku e kishte marrë çelësin dhe pse pengonte të drejtën për të hyrë në shtëpi bazuar në vendim gjykate”*.

Pas apelimit të vendimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë merr vendim duke pranuar kërkesën e kallëzueses dhe rikthen çështjen për gjykim, specifikisht për veprën penale “vetëgjyqësi”. Prokurorja e ankimon këtë vendim duke përsëritur të njëjtën logjikë të saj, duke mos marrë parasysh kërkesat e denoncueses edhe orientimet e gjykatës nëpërmjet vendimit të saj nr. \*\*\*, datë 19.6.2020.

Sa më sipër, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të japë shpjegime lidhur me ankesën e shtetas E. H., për të gjykuar më qartë nëse subjekti i rivlerësimit në cilësinë e prokurores së çështjes ka respektuar të drejtat procedurale penale të ankueses.

### Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti parashtroi: *“Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, mbi bazën e materialeve të referuara nga Komisariati i Policisë nr. \*\*\*, Tiranë ka regjistruar materialin kallëzues nr. \*\*\*, datë 11.3.2020.*

*Kallëzuesja shpjegon se në kohën që zyra përmbartore ka ekzekutuar vendimin e divorcit, ka mbajtur dhe një procesverbal në lidhje me ambientet që kallëzuesja ka në posedim, duke përshkruar që në ambientin e saj ishte dhe një televizor i markës ‘\*\*\*’ me ngjyrë të zezë 32-polësh. Ajo sqaron se ish-bashkëshorti i saj prej 1 muaji kishte ndërruar bravën e derës kryesore, pasi ajo nuk e hapte dot derën me çelësin e saj. Për këtë arsye, ajo në datën 21.2.2020 i është drejtuar zyrës përmbartore. Kjo e fundit ka shkuar në banesë dhe brenda saj ka gjetur ish-bashkëshortin e kallëzueses. Nga zyra përmbartore është konstatuar mungesa e televizorit.*

*I pyetur në cilësinë e personit që tregon rrethana të dobishme për qëllimet e hetimit, ish-bashkëshorti i kallëzueses, shtetasi M. B, sqaron se: ‘...ka 5 vjet që është divorcuar nga shtetasja E.H, me të cilën ka dy fëmijë. Pas procesit të divorcit, gjykata ka vendosur të jetojmë në të njëjtën banesë, duke përcaktuar dhe ndarë ambientet në posedim të të dyja palëve. Ai shpjegon se banesa dhe orenditë brenda saj janë blerë të gjitha prej tij përpara martese.*



*Kallëzuesja nuk ka hapur gjyq për ndarjen e pasurisë. Ai shpjegon se ish-bashkëshortja e tij dhe fëmijët nuk jetojnë në këtë banesë dhe ai i ka hapur ambientet për t'i ajrosur dhe në kohën kur ka rënë tërmeti. Në lidhje me televizorin, pranon ta ketë marrë ai, por jo ta ketë vjedhur, pasi 'marrja e orendive të tua nuk mund të jetë vjedhje'...*

*Nga ana ime, fakti i kallëzuar është vlerësuar në raport me elementet e veprës penale për të cilën ankuesja ka bërë kallëzim, atë të "vjedhjes", parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal.*

*Në vendimmarrjen time kam vlerësuar faktin se për të pasur një figurë konkrete të veprës penale është e domosdoshme ekzistenca e të gjitha elementeve përbërëse të saj të marra së bashku, të cilët janë: (a) objekti i veprës penale; (b) ana objektive; (c) subjekti; dhe (ç) ana subjektive. Provueshmëria e elementeve objektive dhe subjektive të figurës së veprës penale shërben si bazë për të vënë një person përpara përgjegjësisë penale. Gjithashtu vepra penale paraqet në vetvete një unitet të të gjitha elementeve të figurës së saj. Ajo konsiderohet e kryer në mënyrë të plotë atëherë kur ekzistojnë të katër elementet e saj: objekti, ana objektive, subjekti dhe ana subjektive. Nëse mungon njëri prej këtyre elementeve, vepra penale nuk ekziston. Figura e veprës penale pasqyron formën juridike të veprës penale për rastin konkret.*

*Pas analizimit të elementeve të veprës penale në raport me faktin e kallëzuar, kam konkluduar se materiali kallëzues duhet të mos fillohet, pasi fakti nuk përmban elemente të veprës penale për të cilin është depozituar kallëzimi penal. Në vendimmarrje kam vlerësuar faktin se ndërmjet bashkëshortëve nuk kishte një regjim pasurie të ndarë, si dhe faktin se marrja e sendeve nga anëtarët brenda familjes nuk passjell elemente të veprës penale të vjedhjes në kushtet e një regjimi të përbashkët pasuror.*

*Në këto kushte, me vendimin e datës 25.3.2020, është vendosur mosfillimi i materialit kallëzues, sipas nenit 290/1, germa 'ç' e Kodit të Procedurës Penale.*

*Ky vendim i është komunikuar kallëzueses në cilësinë e personit të dëmtuar, në përputhje me nenin 291 të Kodit Penal. Kallëzuesja, duke mos qenë dakord me këtë vendim, ka ushtruar të drejtën e ankimit. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 19.6.2020, ka vendosur 'Prishjen e vendimit për mosfillimin e procedimit penal duke urdhëruar kryerjen e veprimeve të tjera hetimore... '.*

*Ky vendim është ankimuar në cilësinë e prokurores së çështjes, duke argumentuar qartësisht dhe shkaqet e ankimit dhe është në Gjykatën e Apelit në pritje të shqyrtimit.*

*Vendimmarrja në këtë rast është e mbështetur në ligjin material dhe procedural penal. Vendimi i mosfillimit është marrë në afatin 15-ditor të parashikuar nga neni 291, pika 1 e Kodit të Procedurës Penale".*

## **Vlerësimi i Komisionit**

- Trupi gjykues vlerëson se kjo çështje ka në themel vendimmarrjen e magjistratit bazuar në provat e mbledhura dhe arsyetimin e tij bazuar në bindjen e brendshme.

- Pika 4 e nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale të prokurorit, parashikon se: "Vlerësuesi çmon aftësitë profesionale të prokurorit pa gjykuar mbi korrektësinë dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e prokurorit që vlerësohet".

## **2. Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 5.1.2022, i shtetasit I.Sh**

Ky denoncues ankohet se në lidhje me një denoncim të kryer në datën 18.12.2021, në Komisariatit nr. \*\*\* Tiranë, prokurorja Mariola Mërtiri, më 28.12.2021, ka vendosur mosfillimin e hetimeve, pasi e cilësoi kallëzimin penal jo si vepër penale. "Kallëzimi kishte të bënte me kanosje dhe plagosje të rëndë, si dhe ndotje mjedisi, e kryer nga një grup kriminal i

*strukturuar, ndaj dy personave, mua dhe vajzës sime po i rrezikohet jeta vazhdimisht për shkak të pesë personave që në mënyrë të vazhduar mbysin me gaz helmues ambientet e oborrit të shtëpisë dhe dyqanin”.*

Komisioni vlerëson se kjo çështje i përket mundësisë së ankimit në gjykatë të vendimit të mosfillimit të prokurores brenda afatit ligjor dhe është gjykata që vlerëson nëse duhet të procedohet me hetim të mëtejshëm apo jo.

### **3. Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 25.2.2021, i shtetasit K.G**

Ky shtetas ka bërë kallëzim penal ndaj disa subjekteve të tjera, ndër to edhe për subjektin e rivlerësimit, për të cilën dyshon se mund të ketë ndikuar për të mbuluar një hetim në periudhën 2014 – 2016, kohë në të cilën ishte prokurore në Fier. Në të njëjtën mënyrë ajo ka shmangur edhe hetimet e mëvonshme të periudhës 2017 – 2019 kur drejtonte hetimet për shoqëritë “\*\*\*\*” sh.a. dhe “\*\*\*\*” \*\*\*.

Këto dhe të tjera pretendime listohen për të gjitha subjektet që denoncuesi ka kallëzuar në kallëzimin e tij penal. Ky denoncim i është drejtuar për dijeni Komisionit dhe, si i tillë, ky është objekt shqyrtimi nga organi i prokurorisë.

### **4. Denoncimet nr. \*\*\* prot., datë 11.12.2018 dhe nr. \*\*\* prot., datë 16.1.2019, të shtetasit F. Ç**

Shtetasi F.Ç, me profesion avokat, ka paraqitur kallëzim penal ndaj disa subjekteve, ndër to edhe për subjektin e rivlerësimit Mariola Mërtiri në vitin 2018, ku vë në dijeni edhe Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Gjithashtu, në vitin 2019, shtetasi F. Ç i drejtohet Komisionit, si dhe instancave të tjera, duke kërkuar që të kontrollohet dosja penale e dërguar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës në ngarkim të tij, si dhe të bashkohet me dosjet e ankuara të shtetasit A. E.

Komisioni, pas shqyrtimit të këtyre denoncimeve të paraqitura nga shtetasi F.Ç, vlerësoi se çështjet që ai ngre në ankim janë objekt shqyrtimi gjyqësor dhe, si të tilla, nuk mund të hetohen nga Komisioni.

Ndërsa në lidhje me kallëzimin penal të depozituar nga ai në vitin 2018, është kompetencë e organit të prokurorisë shqyrtimi dhe vendimmarrja sipas objektit të kallëzimit.

### **5. Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 18.2.2021, i shtetasve P.Rr, M.Th, Gj. M, P. P dhe R.K**

Këta denoncues i janë drejtuar Komisionit dhe tregojnë shqetësimin e tyre në lidhje me banesën ku ata jetojnë, ish-shkolla e ndërtimit në Shkodër, banesë shtetërore e dhënë nga Bashkia Shkodër me qira, duke qenë të pastrehë. Ata janë përballur në gjyq me shtetasin Gj. Sh., për shkak se ai e kishte privatizuar banesën ku ata jetonin, sipas denoncuesve, në shkelje të ligjit. Pas përfundimit të procesit gjyqësor në disfavor të paditësve-denoncuesve, ata bëjnë kallëzim penal me pretendimin e falsifikimit të dokumenteve e shpërdorimit të detyrës për të gjitha vendimet gjyqësore, që sipas tyre janë vendime të padrejta. Prokurorja Mariola Mërtiri ka vendosur pushimin e procedimit penal, duke argumentuar se nuk është organi i prokurorisë ai që ndryshon vendimet gjyqësore.

Denoncuesit ankohen pranë Komisionit se prokurorja Mariola Mërtiri nuk ka bërë asnjë hetim mbi pretendimet e tyre, duke kërkuar edhe pushimin e procedimit penal të regjistruar pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Ajo, sipas denoncuesve, ka abuzuar me detyrën dhe për këtë kërkojnë që të shkarkohet si prokurore.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit bashkëlidhur kësaj ankese, Komisioni vlerësoi se nuk kishte *indicie* për hetime të mëtejshme për subjektin e rivlerësimit.

## **6. Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 1.12.2017, i shtetasit N. D**

Ky shtetas ka denoncuar një numër të madh subjektesh, ndër to edhe subjektin e rivlerësimit, për të cilët pretendon se të gjithë prokurorët që ai liston në bashkëpunim me ish-kryetarin e komunës, me komisionin e verifikimit të titujve të pronësisë, me ish-prefektin Xh. B., me ish-drejtorin A. D., me hartografin e zonës, kanë kryer veprime për falsifikim, fshehje e zhdukje të produkteve të veprës penale dhe vazhdojnë të njëjtat veprime me kryetarin e Bashkisë së Roskovecit M. B. Këta prokurorë kanë marrë favore nga kryetarja e Bashkisë këto 2 vitet e fundit.

Nga studimi i dokumentacionit që denoncuesi ka sjellë bashkëlidhur, vërehet se denoncuesi ka bërë një kallëzim penal për disa prokurorë, ndër to edhe për prokuroren Mariola Mërtiri, duke iu referuar akuzave të mësipërme, të cilët kanë marrë vendime pa u bazuar në ligj e prova, duke i shërbyer korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Pas shqyrtimit të vendimit të vitit 2013, të prokurores Mariola Mërtiri, “Për mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin nr. \*\*\*, datë 20.11.2012, për veprat penale ‘falsifikim i dokumenteve’ dhe ‘pushtim i tokës’, të parashikuara përkatësisht nga nenet 186 dhe 200 të Kodit Penal”, Komisioni vlerësoi se nuk ka *indicie* që subjekti i rivlerësimit të mund të hetohej më tej.

## **V. VLERËSIMI TËRËSOR I ÇËSHTJES**

Në vlerësimin tërësor të çështjes, mbështetur në provat, faktet dhe rrethanat që Komisioni disponon për kriterin e vlerësimit të pasurisë, vlerësimit të figurës dhe vlerësimit profesional, si dhe në vlerësim tërësor të procedurave, arrin në përfundimin se:

### **Për vlerësimin e pasurisë**

Komisioni, bazuar në provat që disponon, në vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe bindjen e brendshme, çmon se faktet në lidhje me kriterin e pasurisë të krijojnë bindjen se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë pasuritë dhe ligjshmërinë e burimit të krijimit, për arsyet e përmendura në këtë vendim në kriterin “Vlerësimi i pasurisë”.

Rezultoi se subjekti ka bërë deklaram të saktë të pasurive të saj dhe personave të lidhur dhe se ka pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e pasurive të saj.

Mbështetur në konkluzionet e mësipërme, Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit Mariola Mërtiri ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, në kuptim të germës “a” të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

### **Për vlerësimin e figurës**

Nga hetimi administrativ nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit rezultuan të sakta dhe të vërteta. Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Mariola Mërtiri ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, duke u gjendur në kushtet e përcaktuara nga germa “b” e pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

### **Për vlerësimin e aftësive profesionale**

Në përfundim, lidhur me kriterin profesional për pesë çështjet e shortuara, trupi gjykues, pas vlerësimit të parashtrimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti dhe propozimit të relatorit të çështjes, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel minimal kualifikues, në kuptim të germës “c” të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

Lidhur me denoncimet, trupi gjykues nuk konstatoi shkelje të subjektit të rivlerësimit. Lidhur me kriterin e vlerësimit profesional, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e përcaktuara nga germa “c” e pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

### **KONKLUZION PËRFUNDIMTAR**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, në raportin dhe në rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancën dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara prej saj, konkludon se subjekti i rivlerësimit ka arritur në mënyrë kumulative nivel të besueshëm në të tria kriteret:

- a. arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. arrin nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Willem Brouwer, referuar germës “a” të pikës 1 të nenit 58, si dhe pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

### **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Mariola Mërtiri, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë 30 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik dhe/ose nga subjekti i rivlerësimit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.  
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 21.12.2022.

### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Etleda ÇIFTJA**  
**Kryesuese në pakicë / kundër**

**Roland ILIA**  
**Relator**

**Pamela QIRKO**  
**Anëtare**

*Sekretare gjyqësore*  
*Amela Idrizi*